



Federata Shqiptare e Futbollit

# Rregullore e Veprimtarisë Futbollistike

Sezoni 2017 - 2018

## Futbolli i Femrave

Botim zyrtar 2017

Federata Shqiptare e Futbollit

President:

Armand DUKA

Sekretar i Përgjithshëm:

Ilir SHULKU

Themeluar: 1930

Anëtare e UEFA-s: 1954

Anëtare e FIFA-s: 1930

---

Realizoi botimin: "Reklama"

## Përmbajtja

<b>Kreu I Hyrje .....</b>	<b>9</b>
Neni 1 - Objekti dhe qëllimi i zbatimit .....	9
Neni 2 - Përcaktimet .....	9
Neni 3 - Gjinia dhe numri .....	10
<b>Kreu II Pranimi dhe regjistrimi në garë .....</b>	<b>11</b>
Neni 4 - Kriteret e pranimit .....	11
Neni 5 - Procedura e pranimit .....	12
Neni 6 - Marrëdhënia midis Klubeve dhe FSHF-së .....	12
Neni 7 - Punësimi i Zyrtarëve .....	12
Neni 8 - Përgjegjësia për Zyrtarët .....	13
Neni 9 - Integriteti i garës .....	13
Neni 10 - Përfaqësimi i klubeve .....	14
Neni 11 - Detyrimet e klubeve .....	14
Neni 12 - Lojtaria .....	15
Seksioni 1. Federimi i Lojtarëve .....	16
Neni 13 - Detyrimi për t'u federuar .....	16
Neni 14 - Llojet e federimit .....	18
Neni 15 - Çertifikatat e transferimit/regjistrimit ndërkombëtar .....	18
Neni 16 - Procedura e federimit .....	18
Neni 17 - Federimi i shumëfishtë .....	19
Neni 18 - Përfundimi i federimit .....	19
Neni 19 - Klubet që humbasin antarësimin .....	19
Seksioni 2. Transferimi i të Drejtës së Federimit të Lojtarëve .....	19
Neni 20 - Periudhat e transferimit .....	19
Neni 21 - Transferimi i përkohshëm (huazimi) .....	20
Neni 22 - Tarifa e kompensimit .....	21
Neni 23 - Taksa e transferimit .....	21
Neni 24 - Forma e kontratës .....	22
Neni 25 - Kohëzgjatja e kontratës .....	22

Neni 26 - Shpërblimi i lojtares .....	22
Neni 27 - Këstet kontraktuale .....	23
Neni 28 - Nënshkrimi i kontratës .....	23
Neni 29 - Raportimi i sanksioneve ose gjobave .....	24
Neni 30 - Përfundimi i kontratës me marrëveshje .....	24
Neni 31 - Konfidencialiteti kontraktual .....	24
Neni 32 - Rinegociimi i kontratës .....	24
Neni 33 - Apelimi kundër përfundimit të kontratës .....	25
Neni 34 - Apelimi kundër vendimeve .....	25
Neni 35 - Konfliktet midis klubeve dhe lojtarëve .....	25
Neni 36 Pasoja të përfundimit të kontratës .....	25
<b>Kreu III Trofetë .....</b>	<b>26</b>
Neni 37 - Trofetë .....	26
Neni 38 - Trofeu i Kampionatit Kombëtar të Futbollit të Femrave .....	26
Neni 39 - Trofeu Kupa e Shqipërisë të Futbollit të Femrave .....	28
Neni 40 - Trofeu Superkupa e Shqipërisë Futbollit I Femrave .....	30
<b>Kreu IV Përgjegjësitë .....</b>	<b>33</b>
Neni 41 - Përgjegjësitë e FSHF-së .....	33
Neni 42 - Përgjegjësitë e personave juridikë, shoqatave dhe klubeve ..	34
Neni 43 - Përgjegjësitë e zyrtarëve të ndeshjes .....	35
<b>Kreu V Identifikimi dhe Fanellat e Lojtarëve .....</b>	<b>36</b>
Neni 44 - Identifikimi i lojtarëve .....	36
Neni 45 - Fanellat .....	37
Neni 46 - Fanella e tretë .....	38
Neni 47 - Reklamata në fanella .....	38
<b>Kreu VI Kriteret e Terreneve .....</b>	<b>39</b>
Neni 48 - Çertifikata e sigurisë .....	39
Neni 49 - Pronësia e fushës së lojës dhe ambienteve stërvitore .....	39
Neni 50 - Terreni i përbashkët .....	39
Neni 51 - Regjistrimi i terrenit .....	40
Neni 52 - Vendet e spektatorëve .....	40
Neni 53 - Rregullorja e terrenit .....	40
Neni 54 - Dhomat e zhveshjes .....	40
Neni 55 - Dhoma e kontrollit anti-doping .....	40
Neni 56 - Hapësirat për median .....	41
Neni 57 - Hapësirat për fotografët .....	42

Neni 58 - Siguria .....	42
Neni 59 - Fusha e lojës .....	43
Neni 60 - Mbrojtja e fushës së lojës .....	43
Neni 61 - Fushat artificiale .....	44
Neni 62 - Stoli i rezervave .....	44
Neni 63 - Zona e stolit të rezervave .....	45
Neni 64 - Ndryçimi i fushës së lojës .....	45
Neni 65 - Kushtet sanitare .....	45
Neni 66 - Hapësirat për invalidët .....	46
Neni 67 - Ekranët e stadiumit .....	46
<b>Kreu VII Sistemi i Garës .....</b>	<b>47</b>
Neni 68 - Ligjet e lojës .....	47
Seksioni 1. Kampionati Kombëtar i Futbollit të Femrave .....	47
Neni 69 - Emërtimi i Garës .....	47
Neni 70 - Numri i fazave .....	47
Neni 71 - Numri i klubeve pjesëmarrëse .....	48
Neni 72 - Klasifikimi .....	48
Neni 73 - Fituesi i Kampionatit .....	49
Seksioni 2. Kupa e Shqipërisë e Futbollit të Femrave .....	49
Neni 74 - Emërtimi i Garës .....	49
Neni 75 - Numri i Tureve .....	49
Neni 76 - Klubet pjesëmarrëse dhe skema e ndeshjeve .....	49
Neni 77 - Kualifikimi .....	51
Neni 78 - Pjesëmarrja në garat e UEFA-s .....	51
Neni 79 - Superkupa e Shqipërisë .....	51
<b>Kreu VIII Organizimi dhe Zhvillimi i Ndeshjeve .....</b>	<b>53</b>
Neni 80 - Koha e zhvillimit të ndeshjeve dhe kalendari .....	53
Neni 81 - Ndryshimi i datës së ndeshjeve .....	53
Neni 82 - Ndeshjet miqësore .....	53
Neni 83 - Kampionatet dhe garat e tjera .....	54
Neni 84 - Shtyrja e një ndeshje .....	54
Neni 85 - Dështimi në zhvillimin e ndeshjes .....	54
Neni 86 - Riluatja e një ndeshje .....	55
Neni 87 - Delegati i ndeshjes .....	56
Neni 88 - Ekipi më i mirë .....	56
Neni 89 - Mosha minimale .....	56
Neni 90 - Formulari i Ekipit .....	56

Neni 91 - Lojtarët rezervë .....	57
Neni 92 - Fillimi i ndeshjes .....	57
Neni 93 - Hyrja në fushën e lojës .....	58
Neni 94 - Topi zyrtar .....	58
Neni 95 - Stoli i rezervave .....	58
Neni 96 - Zona e stolit të rezervave .....	58
Neni 97 - Kohëzgjatja e ndeshjes .....	58
Neni 98 - Deklarimi i biletave.....	59
Neni 99 - Sanksione për organizimin dhe zhvillimin e ndeshjeve .....	59
Neni 100 - Standardet për organizimin dhe zhvillimin e ndeshjeve .....	59
Neni 101 - Regjistrimi audio/video i ndeshjeve .....	59
Neni 102 - Lojtarët, trajnerët dhe zyrtarët e pezulluar .....	62
Neni 103 - Ndërprerja e ndeshjes .....	62
Neni 104 - Zhvillimi i ndeshjes pa spektatorë .....	63
Neni 105 - Aktivizimi i lojtarëve të huaj .....	63
Neni 106 - Vuvuzelat .....	63
<b>Kreu IX Zyrtarët e Ndeshjes .....</b>	<b>64</b>
Neni 107 - Emërimi i zyrtarëve të ndeshjes .....	64
Neni 108 - Detyrimet e zyrtarëve të ndeshjes .....	64
Neni 109 - Shpenzimet e zyrtarëve të ndeshjes .....	65
Neni 110 - Procedura përpara fillimit të ndeshjes .....	65
Neni 111 - Zbatimi udhëzimeve .....	66
Neni 112 - Procedura pas ndeshjes .....	67
<b>Kreu X Trajtimi Shëndetësor .....</b>	<b>69</b>
Neni 113 - Emërimi i personelit mjekësor .....	69
Neni 114 - Kualifikimi i personelit mjekësor .....	69
Neni 115 - Zhvillimi profesional i vazhdueshëm .....	69
Neni 116 - Pjesëmarrja e personelit mjekësor .....	70
Neni 117 - Dëmtimet në kokë .....	71
Neni 118 - Të dhënat mjekësore .....	71
Neni 119 - Sigurimi shëndetësor .....	71
<b>Kreu XI Financat .....</b>	<b>72</b>
Neni 120 - Detyrimet financiare të pjesëmarrjes në garë .....	72
Neni 121 - Llogaritë bankare të klubeve .....	72
Neni 122 - Kontabiliteti .....	73
Neni 123 - Fuqia për të ndaluar .....	73

Neni 124 - Pasqyrat financiare të klubeve .....	73
Neni 125 - Planifikimi financiar .....	74
Neni 126 - Detyrimet tatimore .....	75
Neni 127 - E drejta për të inspektuar .....	76
<b>Kreu XII Kontrolli i të Dhënave Personale .....</b>	<b>77</b>
Neni 128 - Detyrimi për deklarimin e të dhënave personale .....	77
Neni 129 - Zyra e deklarimit të të dhënave personale .....	77
Neni 130 - Koordinatori i deklarimit të të dhënave personale .....	77
Neni 131 - Punësimi dhe emërimi i zyrtarëve .....	78
Neni 132 - Monitorimi .....	78
Neni 133 - Ambjentet dhe akomodimi .....	79
Neni 134 - Kriteret e personelit .....	79
Neni 135 - Programi stërvitor dhe edukues .....	80
Neni 136 - Kriteret e trajnimit .....	80
Neni 137 - Mirëqënia dhe mbarëvajtja e lojtarëve .....	81
Neni 138 - Monitorimi i ekipeve të moshave .....	81
<b>Kreu XIII Përcaktimet Përfundimtare .....</b>	<b>82</b>
Neni 139 - Qëllimi i rregullores, mangësitë, dhe precedentët.....	82
Neni 140 - Nënshkrimi i dokumentacionit .....	82
Neni 141 - Zbatimi i sanksioneve .....	82
Neni 142 - Reduktimi i sanksioneve me gjobë .....	83
Neni 143 - Forca madhore .....	83
Neni 144 - Mbartja e pezullimit nga ndeshja .....	83
Neni 145 - Ndryshimet e rregullores .....	84
Neni 146 - Zbatimi i rregullores .....	84
Shtojca I Marrëveshja e Pjesëmarrjes në Garë .....	85
Shtojca II Kontrata Shërbimi e lojtares .....	89
Shtojca III Formularët .....	98
Formulari 101 Lista e Zyrtarëve të Autorizuar për të Nënshkruar .....	98
Formulari 102 Marrëveshja e Transferimit .....	99
Formulari 103 Marrëveshja e Transferimit të Përkohshëm (huazimi)...	100
Formulari 104 Shpërblimet e Lojtares .....	101
Formulari 105 Njoftimi i Numrave të Uniformave .....	102
Formulari 106 Regjistrimi i Uniformave Zyrtare .....	103
Formulari 107 Njoftimi i Uniformës Zyrtare, Klubit Vendas .....	104
Formulari 108 Regjistrimi i Përmasave të Fushës së Lojës .....	105
Formulari 109 Raporti i Delegatit të Ndeshjes .....	106

Formulari 110 Formulari i Ekipit .....	106
Formulari 111 Deklarimi i biletave .....	106
Formulari 112 Raporti i Arbitrit të Ndeshjes .....	106
Formulari 113 Raporti i Zyrtarit të Ndeshjes .....	106
Formulari 114 Deklarimi i Llogarisë Bankare të Klubit .....	106
Formulari 115 Deklarimi i Koordinatorit të të Dhënave Personale .....	106
Formulari 116 Deklarimi i të Dhënave Personale .....	106
Shtojca IV Kalendar i ndeshjeve .....	107
Shtojca V Ekzaminimet Mjekësore ndaj Lojtareve .....	111



## Kreu I Hyrje

---

### Neni 1 Objekti dhe qëllimi i zbatimit

---

1. Kjo rregullore përcakton të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve që marrin pjesë ose janë të përfshira në përgatitjen dhe organizimin e Kampionatit Kombëtar të Futbollit, sezoni 2017 – 2018, për Kampionatin e Femrave.

---

### Neni 2 Përcaktimet

---

1. **Pas ndeshjes** – është koha ndërmjet fishkëllimës finale të arbitrit dhe largimit të ekipeve jashtë rrethimit të stadiumit.
2. **Para ndeshjes** – është koha ndërmjet arritjes së ekipeve në rrethimin e stadiumit dhe fishkëllimës së arbitrit për fillimin e ndeshjes.
3. **Ndeshje miqësore** – është ajo ndeshje e organizuar nga FSHF, ndonjë klub apo person midis ekipeve të ndryshme të përzgjedhura në mënyrë të rastësishme, dhe rezultati ka efekt vetëm për këtë ndeshje apo turne.
4. **Ndeshje zyrtare** – është ajo ndeshje e organizuar nën mbikëqyrjen e FSHF-së, dhe rezultati ka efekt në garat dhe kampionatet e organizuara nga FSHF.
5. **Sezoni futbollistik** – është periudha ndërmjet fillimit të Kampionatit, dhe përfundimit të tij në vitin e ardhshëm.
6. **Zyrtar/ët** – është/janë çdokush, duke përfshirë lojtaret, të cilat kryejnë ndonjë veprimtari për llogari të ndonjë klubi apo për llogari të FSHF-së, pavarësisht pozicionit të punës, dhe llojit të veprimtarisë që kryen (administrative, sportive, apo ndonjë lloj tjetër) si dhe kohëzgjatjes së veprimtarisë; veçanërisht, menaxherët, trajnerët, dhe personeli mbështetës janë zyrtarë.
7. **Zyrtar ndeshje** – është arbitri, ndihmësat e arbitrit, arbitri i katërt, delegati i ndeshjes, vëzhguesi i arbitrave, personi përgjegjës për

sigurinë, dhe çdo person tjetër i cili është caktuar nga FSHF dhe kanë përgjegjësi në lidhje me ndonjë ndeshje.

8. **Rregulloret e FSHF** – janë statutet, rregulloret, udhëzimet dhe qarkoret e FSHF-së, si dhe Ligjet e Lojës të lëshuara nga Bordi i Organizatës Ndërkombëtare të Futbollit.

---

<b>Neni 3</b>	<b>Gjinia dhe numri</b>
---------------	-------------------------

---

1. Përcaktimet të cilat i referohen individëve janë të zbatueshme për të dyja gjinitë. Çdo përcaktim në numrin njënjës zbatohet edhe në numrin shumës, dhe anasjelltas.

## **Kreu II Pranimi dhe regjistrimi në garë**

---

### **Neni 4 Kriteret e pranimi**

---

1. Për të marrë pjesë në garë, një klub duhet të përmbushë kriteret si më poshtë:
  - a) të jetë kualifikuar në kategorinë përkatëse me meritë sportive;
  - b) të plotësojë të gjithë dokumentacionin dhe formularët zyrtarë (të gjithë informacionin e kërkuar nga FSHF), duke i dorëzuar pranë FSHF-së brenda afateve të përcaktuara në këtë rregullore;
  - c) të pranojë zbatimin e përcaktimeve në lidhje me integritetin e garës siç përcaktohet në Neni 9 - Integriteti i Garës, në këtë rregullore;
  - d) të konfirmojë me shkrim se klubi, dhe lojtarët e zyrtarët përkatës të tij do të zbatojnë me përpikmëri të gjitha përcaktimet e kësaj rregulloreje dhe të dokumenteve të përcaktuara në Neni 6 - paragrafin (1) të kësaj rregulloreje;
  - e) nuk duhet të jetë përfshirë drejtpërdrejtë dhe/ose jo drejtpërdrejtë në trukimin dhe/ose influencimin e rezultatit të ndonjë ndeshje futbollit në nivel kombëtar ose ndërkombëtar.
2. Nëse FSHF vendos të mos pranojë në garë ndonjë klub për shkak se ky i fundit është përfshirë në trukimin dhe/ose influencimin e rezultatit të ndonjë ndeshje në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, FSHF do të deklarojë me shkrim për mos pranimin e këtij klubi në garë. Ky paragraf zbatohet pavarësisht zbatimit të përcaktimeve në lidhje me trukimin dhe/ose influencimin e rezultatit të një ndeshje, të përmbajtura në ndonjë rregullore dhe/ose dokument rregullues të FSHF-së.
3. Përveç mos pranimi në garë në zbatim të paragrafit (1), pika (e) në këtë nen, FSHF mund të ndërmarrë masa disiplinore nëpërmjet

komisioneve juridike ndaj klubit në shkelje dhe në përputhje me Kodin e Disiplinës Sportive në fuqi.

---

## **Neni 5                      Procedura e pranimit**

---

1. FSHF i komunikon me shkrim pranimin në garë të gjithë klubeve përkatëse që përmbushin kriteret e pranimit.
2. Ndonjë klub i cili nuk pranohet në garë, zëvendësohet në përputhje me përcaktimet në këtë rregullore, nga një klub tjetër që i plotëson kriteret e pranimit në garë.
3. FSHF mund të kryejë hetime ose verifikime të përmbushjes së kriteve të pranimit në garë në çdo kohë gjatë sezonit futbollistik përkatës, për të garantuar se kriteret e pranimit vazhdojnë të përmbushen nga klubet e pranuar në garë. Nëse verifikohet shkelje e kriteve të pranimit, atëherë klubi përkatës është përgjegjës dhe do të sanksionohet në përputhje me Kodin e Disiplinës Sportive të FSHF-së.

---

## **Neni 6                      Marrëdhënia midis Klubeve dhe FSHF-së**

---

1. Pjesëmarrja në garat e organizuara nga FSHF, është subjekt i marrëveshjes me shkrim të lidhur midis FSHF-së dhe secilit klub, ku palët bien dakort të zbatojnë me përpikmëri:
  - a) ligjet e Lojës;
  - b) statutin dhe rregulloret e tjera të FSHF-së;
  - c) këtë rregullore;
  - d) statutet dhe rregulloret e FIFA-s;
  - e) statutet dhe rregulloret e UEFA-s.
2. Forma dhe përmbajtja e kësaj marrëveshje, si më sipër, është përcaktuar në Shtojca I, të kësaj rregulloreje.
3. Marrëveshja duhet nënshkruar nga palët dhe duhet të hyjë në fuqi përpara fillimit të veprimtarisë futbollistike për sezonin 2017 - 2018.
4. Asnjë klub, vetë ose nëpërmjet zyrtarëve, agjentëve ose lojtareve të vet, nuk ka të drejtë të përhapë fakte të pavërteta, të ofendojë, të shpifë, ose të denigrojë ndonjë klub tjetër, ose FSHF-në, si dhe lojtaret, zyrtarët, agjentët, punonjësit, përfaqësuesit, ose drejtuesit e tyre përkatës.

---

**Neni 7** **Punësimi i Zyrtarëve**

---

1. Çdo klub duhet të punësojë dhe të paraqesë informacionin përkatës pranë FSHF-së, përpara fillimit të veprimtarisë futbolistike, zyrtarët si më poshtë:
  - a) Sekretarin e Klubit;
  - b) Doktorri i ekipit i cili duhet të zotërojë kualifikimin përkatës;
  - c) Fizioterapisti i ekipit i cili duhet të zotëroje kualifikimin përkatës
  - d) Zv.Traineri i cili duhet të ketë liçencën C

---

**Neni 8** **Përgjegjësia për Zyrtarët**

---

1. Çdo klub duhet të detyrojë çdo zyrtar të tij, t'i nënshtrohet zbatimit të Neni 6, paragrafi (1), pikat (a), (b), (c), (d) dhe (e), duke nënshkruar një marrëveshje me zyrtarët përkatës.
2. Çdo klub duhet të detyrojë çdo zyrtar të tij, që të kërkojë lejen paraprake nga klubi përpara se të flasë në media (shtypin e shkruar, televizion, ose radio).

---

**Neni 9** **Integriteti i garës**

---

1. Për të garantuar integritetin e garës së organizuar nga FSHF, zbatohen kriteret si më poshtë:
  - a) asnjë klub që merr pjesë në garat e organizuara nga FSHF, drejtpërdrejtë ose indirekt, nuk mund:
    - (i) të zotërojë ose tregtojë aksione ose të drejta pronësie të ndonjë klubi tjetër pjesëmarrës në veprimtaritë e organizuara nga FSHF,
    - (ii) të jetë anëtar ose zyrtar i ndonjë klubi tjetër pjesëmarrës në veprimtaritë e organizuara nga FSHF;
    - (iii) të përfshihet në ndonjë mënyrë apo pozitë në menaxhimin, administrimin dhe/ose zhvillimin sportiv të ndonjë klubi tjetër pjesëmarrës në veprimtaritë e organizuara nga FSHF,
    - (iv) të ushtrojë fuqi të çfarëdo lloji mbi menaxhimin, administrimin dhe/ose zhvillimin sportiv të ndonjë klubi tjetër pjesëmarrës në veprimtaritë e organizuara nga FSHF;
  - b) askush nuk mund të përfshihet njëkohësisht, drejtpërdrejtë ose

- indirekt, në ushtrimin ose zotërimin e ndonjë pozite ose fuqie për menaxhimin, administrimin dhe/ose zhvillimin sportiv në më shumë se një klub që është pjesëmarrës në veprimtaritë e organizuara nga FSHF;
- c) asnjë individ ose person juridik nuk mund të ketë kontroll ose influencë mbi më shumë se një klub pjesëmarrës në veprimtaritë e organizuara nga FSHF, kontroll ose influencë siç përcaktohet këtu në vijim:
- (i) zotërimi i shumicës së aksioneve ose të drejtave të pronësisë,
  - (ii) ka të drejtën të emërojë ose të shkarkojë shumicën e anëtarëve të këshillit/bordit drejtues, administrues, mbikëqyrës të klubit,
  - (iii) pjesëmarrja si aksioner dhe ndërkohë zotërimi i të drejtës së votës mbi shumicën e aksioneve si rrjedhim i ndonjë marrëveshje përfaqësimi,
  - (iv) mundësia e ushtrimit të një influence vendim-marrëse mbi drejtimin dhe vendim-marrjen e klubit.
2. Në rastin e verifikimit të dy ose më shumë klubeve të cilat nuk përmbushin kriteret e garantimit të integritetit të garës, vetëm njëri prej këtyre klubeve do të pranohet të marrë pjesë në garën përkatëse të organizuar nga FSHF, në përputhje me procedurën si më poshtë:
- a) klubi i cili ka siguruar renditjen më të lartë në garën përkatëse paraardhëse;
  - b) klubet të cilat nuk pranohen, zëvendësohen.

---

## **Neni 10                      Përfaqësimi i klubeve**

---

1. Çdo klub është i detyruar të deklarojë pranë FSHF, emrat e zyrtarëve të cilët janë të autorizuar për të nënshkruar dokumentacionin zyrtar të klubit, dhe përfaqësojnë klubin në marrëdhënien zyrtare me FSHF-në.
2. Deklarimi i zyrtarëve të autorizuar për të nënshkruar dokumentacionin zyrtar të klubit, kryhet duke depozituar pranë FSHF-së, Formulari 101 - Lista e Zyrtarëve të Autorizuar në Emër të Klubit, bashkëngjitur kësaj rregulloreje.
3. Zyrtarët e autorizuar në përputhje me përcaktimet e këtij neni, kanë të drejtë të nënshkruajnë dokumentacionin dhe formularët e përcaktuar në këtë rregullore.

---

**Neni 11****Detyrimet e klubeve**

---

1. Me marrjen pjesë në garë, klubet bien dakort:
  - a) Te gjitha detyrimet financiare që rrjedhin nga pjesëmarrja e tyre në garë , siç përcaktohen në këtë rregullore do të paguhet nga FSHF;
  - b) t'i binden dhe të zbatojnë Ligjet e Lojës të lëshuara nga IFAB;
  - c) të respektojnë parimet e "fair play" siç përcaktohet në rregulloret dhe statutet e FSHF-së;
  - d) të luajnë të gjitha ndeshjet e garës ku marrin pjesë, si dhe të paraqesin në fushën e lojës skuadrën e tyre më të fortë gjatë gjithë zhvillimit të garës;
  - e) të luajnë të gjitha ndeshjet e garës ku marrin pjesë në përputhje me rregulloret në fuqi;
  - f) të luajnë të gjitha ndeshjet brenda territorit të Shqipërisë (brenda njësisë vendore që përfaqëson ose në fushën e lojës që ka regjistruar pranë FSHF-së, për ndeshjet që zhvillohen në fushën e vet), përveç rasteve kur merr vendim me shkrim FSHF;
  - g) të zbatojnë të gjitha vendimet e marra në lidhje me garën përkatëse, nga Komiteti Ekzekutiv i FSHF-së, nga administrata e FSHF-së apo nga çdo organ ose komision i FSHF-së i cili ka kompetencë në lidhje me garën;
  - h) të zbatojë Rregulloren e Ruajtjes dhe Sigurisë të FSHF-së për të gjitha ndeshjet e garës përkatëse;

---

**Neni 12****Lojtaria**

---

1. Lojtaria njihet dhe zbaton të gjitha rregulloret që kanë të bëjnë me aktivitetin futbollistik kombëtar zyrtar ku merr pjesë dhe "Statusin e lojtares".
2. Lojtaret e regjistruara (federuara) me një klub, shoqatë apo shoqëri, nuk kanë të drejtë të zhvillojnë aktivitetet apo veprimtari tjetër sportive gjatë një sezoni në dy kampionate njëkohësisht brenda dhe jashtë vendit.
3. Lojtaria është e detyruar të bëjë kontrollin mjekësor përpara fillimit të aktivitetit
4. Lojtaria mban një kopje të kontratës së lidhur me klubin.
5. Lojtaria në protokoll duhet të mbajë numrin që ka të regjistruar në listën e federimit.

6. Lojtaria nuk duhet të mbajë sende të forta gjatë lojës (varëse, vath, byzylyk, unaza etj).
7. Lojtaria është e detyruar t'i bindet të gjitha urdhërave që jep arbitri para gjatë apo pas ndeshjes.
8. Lojtaria është e detyruar t'i nënshtrohet kontrolleve anti doping, nëse i kërkohet nga personat e ngarkuar për këtë kontroll.
9. Lojtaria që plotëson numrin 3 (tre) të kartonave të verdhë (KV) të marrë, nuk luan një ndeshje në garën përkatëse.
10. Lojtaria nuk lejohet që të mbajë poshtë fanellës shkrime të ndryshme që fyejnë, bëjnë propagandë politike, diskriminim racial, gjinor, krahinor, kombëtar, etj shkrime të kësaj natyre.
11. Lojtaria nuk ka të drejtë të jap intervista ku çënohet personaliteti i zyrtarëve të futbollit si të FSHF-së, kundërshtarit, trajnerë, arbitra, vëzhgues etj.
12. Lojtaria e ndëshkuar me masë disiplinore nga Komisionet Juridike të FSHF-së, e shlyen dënimin në vazhdimësi në Kampionatin ku merr pjesë, në Kupën e Shqipërisë si dhe në Superkupë.
13. Lojtaria do ti kryej të veçuara dënimet e marra në kampionat nga ato në kupë për Karton të Verdhë dhe Karton të Kuq.
14. Kur lojtaria ka një ose dy KV dhe pastaj merr një KK, kryerja e dënimit për KK, nuk eliminon KV.
15. Kur lojtaria merr një karton të kuq, nuk luan në ndeshjen pasardhëse.
16. Kur lojtaria pezullohet me masë disiplinore, pezullimi mbartet edhe për sezonin e ardhshëm.

## **Seksioni 1. Federimi i Lojtareve**

---

### **Neni 13 Detyrimi për t'u federuar**

---

1. Një lojtare nuk mund të luajë në asnjë ndeshje zyrtare për ndonjë klub, nëse lojtaria nuk është e federuar në emër të klubit përkatës të paktën 1 (një) orë përpara fillimit të ndeshjes përkatëse ku do të angazhohet kjo lojtare, dhe përpara se të përfundojë periudha e parë e federimeve.
2. Lojtaria konsiderohet e federuar në emër të një klubi vetëm pasi lëshohet kartoni i federimit nga FSHF.
3. Çdo klub mund të aplikojë:
  - a) për të regjistruar në listën e federimit lojtaret, duke plotësuar të



- dhënat në sistemin online “COMET” të FSHF-së.
- b) për të hequr nga lista e federimit ndonjë lojtarë duhet bërë aplikimi i çregjistrimit online “COMET” duke bashkangjitur dokumentacionin përkatës në sistem.
  - c) për të përfshirë në listën e federimit ndonjë lojtarë duke plotësuar dhe dorëzuar formularin përkatës pranë FSHF-së;
  - d) për të hequr nga lista e federimit ndonjë lojtarë duke plotësuar dhe dorëzuar formularin përkatës pranë FSHF-së.
4. Një lojtarë do të konsiderohet e federuar ose e hequr nga lista e federimit të klubit përkatës vetëm pas marrjes së konfirmimit online “COMET” nga FSHF.
  5. Një lojtarë në proces gjykimi në Organet Juridike të FSHF-së mund të regjistrohet nga një klub në listën e federimit COMET, por pa patur të drejtën e aktivizimit deri në momentin e marrjes së një vendimi përfundimtar nga Organet përkatëse.
  6. Ndryshimet në listën e federimit të lojtarëve të një klubi, mund të kryhen vetëm:
    - a) gjatë periudhave të federimit të miratuara dhe të njoftuara nga FSHF, ose të përcaktuara në këtë rregullore;
    - b) në raste të posaçme me miratim paraprak të FSHF-së; kjo pikë e rregullores zbatohet për të gjitha klubet njëkohësisht.
  7. Federimi i lojtarëve kushtëzohet nga miratimi i aplikimit përkatës për federimin e lojtarës nga FSHF.
  8. Klubet janë të detyruar të federojnë jo më shumë se 5 (pesë) lojtarë të huaja.
  9. Klubet mund të përfshijnë në listën e federimit deri në 25(njëzet e pesë) lojtarë gjithsej.
  10. Klubet mund të përfshijnë në listën e federimit deri në 5(pesë) zyrtarë gjithsej:
    - a) Trainier i Parë
    - b) Zv.trainier
    - c) Mjeku
    - d) Fizioterapisti
    - e) Sekretari i klubit
  11. Klubet mund të punësojnë në ekipet e tyre trainier të licensuar si më poshtë:
    - a) Për Kampionatin e Femrave Trainieri të ketë minimalisht licencë UEFA “B”.

- b) Zv.Traineri licencën UEFA "C".
- c) Në rast se një trainier është i regjistruar në kursin pasardhës UEFA "B" mund të drejtojë një ekipi në sezonin përkatës.
- d) Regjistrimi i zyrtarëve në listën e federimit do të kryhet vetëm në rastet kur ata janë paisur me licensën përkatëse nga FSHF-ja.

---

**Neni 14                    Llojet e federimit**

---

1. Një lojtare mund të federohet në emër të një klubi që merr pjesë në Kampionatin e Femrave vetëm si lojtare amatore.

---

**Neni 15                    Çertifikatat e transferimit/regjistrimit ndërkombëtar**

---

1. Aplikimi për të federuar një lojtare, i cili ka luajtur për herë të fundit me një klub i cili nuk është anëtar i Federatës Shqiptare të Futbollit, duhet të kryhet në përputhje me Rregulloren mbi Statusin dhe Transferimin e Lojtareve.

---

**Neni 16                    Procedura e federimit**

---

1. Në zbatim të kësaj rregulloreje, Federim i Ri i një lojtareje do të konsiderohet federimi i lojtares kur asnjë klub nuk zotëron të drejtën e federimit për shkak se lojtaria përkatëse nuk është federuar asnjëherë tjetër më parë, ose federimi i mëparshëm ka përfunduar, ose federimi i mëparshëm ka skaduar.
2. Federimi i ri i një lojtareje mund të kryhet vetëm pas hedhjes online në COMET.
3. Transferimi i të drejtës së federimit të një lojtareje do të kryhet në përputhje me përcaktimet këtu më poshtë në këtë rregullore.
4. Transferimi i përkohshëm i të drejtës së federimit (huazimi) të një lojtareje do të kryhet në përputhje me përcaktimet këtu më poshtë në këtë rregullore.
5. Afati për pranimin e dokumentacionit të kërkuar nga kjo rregullore për federimin e një lojtareje do të jetë ora 12<sup>o</sup> e ditës së fundit të periudhës përkatëse të transferimit (1 ditë para fillimit të kampionatit), për periudhën e parë të transferimit; (1 ditë para fillimit të fazës së dytë) për periudhën e dytë të transferimit.
6. Një klub i cili transferon ose anulon federimin e një lojtareje nuk ka të

drejtë të kryejë federimin e lojtares përkatës për 1 (një) vit pa marrë më parë miratimin me shkrim nga FSHF.

---

**Neni 17**                    **Federimi i shumëfishtë**

---

1. Një lojtare nuk mund të federohet nga më shumë se një klub, dhe çdo aplikim që bie ndesh me këtë përcaktim do të refuzohet nga FSHF.

---

**Neni 18**                    **Përfundimi i federimit**

---

1. Federimi i një lojtareje do të përfundojë:
  - a) kur përfundon sezoni futbollistik
  - b) në rastin e huazimit, kur përfundon marrëveshja e transfertimit midis klubeve përkatëse.

---

**Neni 19**                    **Klubet që humbasin antarësimin**

---

1. Kur një klub pushon së qëni anëtar i FSHF-së, e drejta e federimit të lojtareve do t'i kalojë FSHF-së, dhe FSHF ka të drejtën të transferojë këtë të drejtë tek çdo palë që e vlerëson të arsyeshme, dhe kompesimi përkatës për transferimin e të drejtës së federimit do të arkëtohet nga FSHF.
2. Kompesimi i përfituar sipas përcaktimeve në paragrafin (1) këtu më sipër në këtë nen, i përket FSHF-së e cila ka të drejtë të shpërndajë këtë vlerë si më poshtë:
  - a) tek çdo klub ndaj të cilit, klubi që pushon së qëni anëtar i FSHF ka patur detyrime në lidhje me transferimin e të drejtës së federimit;
  - b) tek vetë klubi që pushon së qëni anëtar i FSHF.

---

**Seksioni 2.**                **Transferimi i të Drejtës së Federimit të Lojtareve**

---

---

**Neni 20**                    **Periudhat e transferimit**

---

1. Periudhat e transferimit janë 2 (dy) periudha, gjatë të cilave një klub mund të aplikojë për një Federim të Ri të një lojtare, dhe/ose për transferimin e të drejtës së federimit, dhe/ose për transferimin e përkohshëm (huazimin) të së drejtës së federimit.
2. Periudha e parë e transferimit gjatë një viti do të fillojë në mesnatën e

ditës së fundit të sezonit futbollistik dhe do të përfundojë 1 ditë para fillimit të aktivitetit futbollistik zyrtar.

3. Periudha e dytë e transferimit gjatë një viti do të fillojë në mesnatën e datës 31 Dhjetor, 2017, dhe do të përfundojë 1 ditë para fillimit të aktivitetit futbollistik zyrtar të fazës së dytë.

---

## **Neni 21                      Transferimi i përkohshëm (huazimi)**

---

1. Transferimi i përkohshëm (huazimi) i lojtarëve lejohet të kryhet vetëm midis klubeve të antarësuara në FSHF, përveç rasteve kur huazimi kryhet nëpërmjet Rregullores së Transferimit të Lojtarëve (FIFA).
2. Transferimi i përkohshëm kryhet në përputhje me përcaktimet si më poshtë:
  - a) nëse gjatë periudhës së huazimit, klubet bien dakort me shkrim (marrëveshje me shkrim e cila duhet depozituar pranë FSHF-së) për transferimin e përkohshëm të së drejtës së federimit të lojtares përkatëse nga klubi që e transferon tek klubi që e huazon, të dy klubet mund të vendosin që kjo lojtare nuk do të luajë asnjë ndeshje kundër klubit që e transferon gjatë gjithë kohëzgjatjes së sezonit futbollistik në vijim;
  - b) përveç rasteve të lejuara dhe miratuara paraprakisht me shkrim nga FSHF, periudha minimale e transferimit të përkohshëm (huazimit) do të jetë periudha midis dy periudhave të transferimit, dhe periudha e transferimit të përkohshëm (huazimit) nuk mund të zgjasë më shumë se data e përfundimit të aktivitetit zyrtar;
  - c) numri maksimal i transferimeve të përkohshme (huazimeve) për të njëjtin klub nuk mund të jetë më shumë se 6 (gjashtë) huazime brenda të njëjtit sezon futbollistik, dhe në asnjë mënyrë klubi nuk mund të kryejë më shumë se 1 (një) huazim nga i njëjti klub që transferon të drejtën e federimit përveç rasteve kur huazimet transferohen në mënyrë të përhershme;
  - d) nuk mund të kryhen më shumë se 3 (tre) transferime të përkohshme (huazime) nga një klub në të njëjtën kohë, përveç përjashtimit nga përllogaritja e rasteve si më poshtë:
    - i. çdo transferim të përkohshëm (huazim) që shndërrohet në transferim të përhershëm;
    - ii. transferimin e përkohshëm (huazimin) e një portieri që lejohet në rrethana të posaçme nga FSHF nëpërmjet miratimit paraprak me shkrim;

- e) gjatë një sezoni futbollistik, një klub mund të transferojë përkohësisht (të japë në huazim) vetëm një portier tek një klub tjetër, përveç rastit të përcaktuar në pikën (d) këtu më sipër në këtë paragraf;
  - f) ndonjë përcaktim tjetër të vendosur në marrëveshjen me shkrim midis palëve, klubit që transferon dhe klubit që huazon.
3. Transferimi i përkohshëm kryhet duke dorëzuar pranë FSHF, Formulari 103 - Marrëveshja e Transferimit të Përkohshëm, bashkëngjitur kësaj rregulloreje, të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i klubit.
  4. Klubi që mban të drejtën e federimit të një lojtare në pension në përputhje me përcaktimet në paragrafin (2) këtu më poshtë në këtë nen, ka të drejtën e përfitimit të tarifës së kompensimit të transferimit nga klubi që përfiton të drejtën e federimit, nëse lojtari përkatës kërkon të federohet pranë FSHF-së.
  5. Klubi që ka regjistruar pranë FSHF-së të drejtën e federimit për herë të fundit për një lojtare e cila del në pension, konsiderohet se ka të drejtën e federimit për lojtaren përkatëse për një periudhë prej 30 (tridhjetë) muajsh nga data e ndeshjes së fundit që lojtaria përkatëse ka luajtur për këtë klub.

---

## **Neni 22                      Tarifa e kompensimit**

---

1. Tarifa e kompensimit që paguhet nga një klub profesionist që përfiton të drejtën e federimit tek klubi që e transferon, gjatë transferimit të së drejtës së federimit të një lojtareje vetëm me kontratë profesioniste, dhe jo të një lojtareje që nuk ka kontratë por që ka marrëveshje vetëm sezonale në këtë rast klubi nuk ka të drejtën e kompensimit që do të përcaktohet në marrëveshjen e transferimit të nënshkruar nga palët.

---

## **Neni 23                      Taksa e transferimit**

---

1. Përveç rastit të përcaktuar në paragrafin (2) këtu më poshtë në këtë nen, me pagesën e tarifës së kompensimit apo të ndonjë shume tjetër nga klubi që përfiton të drejtën e federimit, në lidhje me transferimin e të drejtës së federimit të një lojtareje me kontratë, klubi përfitues i të drejtës së federimit duhet të paguajë pranë FSHF-së një taksë transferimi me vlerë 5% (pesë përqind) të tarifës së kompensimit dhe/ose shumave të tjera të paguara ndaj klubit transferues, por në çdo rast jo më pak se 30,000 (tridhjetë mijë) lekë.

2. Taksa e transferimit në rastin e lojtareve me kontratë të cilët huazohen, e cila aplikohet mbi tarifën e kompensimit të huazimit, do të jetë me vlerë 5% (pesë përqind), por në çdo rast jo më pak se 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.
3. Në çdo rast taksa e transferimit parapaguhet në llogarinë bankare të FSHF-së, përpara se klubi që përfiton të drejtën e federimit, të kryejë federimin e lojtares përkatëse.

---

**Neni 24            Forma e kontratës**

---

1. Kontratat e lidhura midis klubeve dhe lojtareve duhet të përmbajnë përcaktimet minimale të parashikuara në Shtojca II – Kontratë Shërbimi e Lojtares, bashkëngjitur kësaj rregulloreje.

---

**Neni 25            Kohëzgjatja e kontratës**

---

1. Kontratat në futbollin e femrave për ato klube që i paguajnë lojtaret quhen kontrata profesioniste dhe do siglohen nga zyra juridike e FSHF. Kurse lojtaret që nuk paguhen nga klubi do lidhin një marrëveshje me klubin për një sezon futbollistik.
2. Në kuptim të kësaj rregulloreje një lojtare me kontratë konsiderohet ajo lojtare e cila ka në fuqi një kontratë të lidhur me një klub të antarësuar pranë FSHF në sezonin 2017-2018.

---

**Neni 26            Shpërblimi i lojtares**

---

1. Hollësitë e plota të shpërblimit të lojtareve duke përfshirë të gjitha përfitimet që do të përfitojë lojtaria qoftë me para në dorë apo qoftë në natyrë duhet të përcaktohen në kontratën e saj.
2. Kushtet e kontratës përkatëse të lidhur midis klubit dhe lojtares duhet të respektohen në mënyrë rigoroze.
3. Jo më vonë se data 30 Qershor e çdo viti vijues, çdo klub duhet të dorëzojë pranë FSHF-së, sipas Formulari 104 - Shpërblimet e Lojtares, hollësitë e plota për të gjitha pagesat dhe të gjitha përfitimet e kryera ndaj çdo lojtareje gjatë sezonit futbollistik të mëparshëm.
4. Nëse ndonjë klub shkel përcaktimet e paragrafit (3) këtu më sipër në

këtë nen, përveç zbatimit të sanksioneve të përcaktuara në Kodin e Disiplinës Sportive, FSHF gjithashtu ka të drejtën të refuzojë çdo aplikim nga klubi në kundërvajtje për të federuar ndonjë lojtare derisa klubi të përmbushë përcaktimet në paragrafin (3) këtu më sipër në këtë nen.

---

## **Neni 27**                    **Këstet kontraktuale**

---

1. Në kuptim të kësaj rregulloreje, kësti kontraktual është shuma e parave të paguara ndaj një lojtareje me kontratë, vetëm për të drejtën e federimit që përfiton klubi kontraktues, kur lidh kontratë me lojtaren përkatëse.
2. Një lojtare me kontratë mund të përfitojë këste kontraktuale vetëm nëse ekzistojnë kushtet si më poshtë:
  - a) kontrata përkatëse ka një kohëzgjatje jo më pak se 3 (tre) muaj;
  - b) nuk është një kontratë mujore ose kontratë me kusht.
3. Nëse e drejta e federimit të një lojtareje me kontratë transferohet gjatë kohës që ndonjë pjesë e kësteve kontraktuale është akoma e pa paguar, kësti përkatës apo shuma përkatëse do t'i paguhet menjëherë kësaj lojtareje nga klubi transferues, përveç rasteve kur:
  - a) transferimi i të drejtës së federimit është pasojë e përfundimit në mënyrë të njëanshme të kontratës së lojtares nga ana e klubit transferues me arsyen e shkeljes së kushteve dhe afateve të kontratës nga ana e lojtares me kontratë; ose
  - b) transferimi i të drejtës së federimit është pasojë e përfundimit të kontratës si rrjedhim i kërkesës me shkrim nga vetë lojtaria përkatëse.

---

## **Neni 28**                    **Nënshkrimi i kontratës**

---

1. Kontrata midis një klubi dhe një lojtareje do të nënshkruhet në çdo rast përpara një noteri të liçencuar, nga palët si më poshtë:
  - a) lojtaria;
  - b) prindi i lojtares ose përfaqësuesi ligjor përkatës nëse lojtaria është nën moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç;
  - c) përfaqësuesi ligjor i klubit.
  - d) Ose të firmosen kontratat nga drejtori i zyrës juridike pranë FSHF.
  - e) Ose në qoftë se nuk bëhet kontratë marrëveshja sezonale ndërmjet dy palëve.

---

**Neni 29                      Raportimi i sanksioneve ose gjobave**

---

1. Një kopje e çdo njoftimi për ndërprerjen e kontratës së lojtares, e kryer qoftë nga klubi ose nga lojtaria dhe një kopje e çdo vendimi të marrë nga klubi për të pezulluar një lojtare apo për të vendosur ndonjë sanksion me gjobë ndaj saj, duhet të dorëzohet pranë FSHF-së, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga dita e marrjes së vendimit përkatës.

---

**Neni 30                      Përfundimi i kontratës me marrëveshje**

---

1. Nëse palët e përfshira bien dakort për të përfunduar kontratën e lojtares përpara mbarimit të afatit të përcaktuar në kontratë, atëherë palët duhet të njoftojnë menjëherë, dhe jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pranë FSHF-së.

---

**Neni 31                      Konfidencialiteti kontraktual**

---

1. Kontrata e lidhur midis klubit dhe lojtares do të trajtohet në mënyrë konfidenciale dhe përmbajtja e saj nuk duhet të deklarohet apo shpërndahet, qoftë në mënyrë direkte apo indirekte ndaj asnjë personi, nga secila palë veç e veç, apo edhe të dyja palët së bashku, përveç rasteve si më poshtë:
  - a) pas marrëveshjes paraprake me shkrim nga të dyja palët; ose
  - b) nëse kërkohet nga ndonjë autoritet kompetent në bazë të legjislacionit në fuqi; ose
  - c) në rastin e lojtares, informacion i shpërndarë ndaj agjentit përkatës të lojtares të caktuar në përputhje me rregulloret e FSHF-së; ose
  - d) në rastin e klubit, informacion i shpërndarë ndaj agjentit përkatës të klubit të caktuar në përputhje me rregulloret e FSHF-së, apo ndaj drejtuesve dhe/ose audituesve përkatës të klubit.

---

**Neni 32                      Rinegociimi i kontratës**

---

1. Një klub është i lejuar të rinegociojë në çdo kohë kontratën e lojtares edhe jashtë periudhave të transferimit, për të shtyrë afatin e përfundimit të kontratës. Nëse një marrëveshje e tillë arrihet midis palëve, dhe shpërblimi i ofruar për lojtaren është më i lartë se shpërblimi ekzistues, atëherë afati i kontratës aktuale mund të shtyhet dhe për 1 (një) vit.



---

**Neni 33                    Apeli kundër përfundimit të kontratës**

---

1. Një lojtare mund të apelojë kundër vendimit për përfundimin e kontratës nga ana e klubit, pranë Dhomës së Zgjidhjes së Konfliktëve, në përputhje me rregulloret e FSHF-së në fuqi.
2. Kërkesa përkatëse për ushtrimin e të drejtës së përcaktuar në paragrafin (1) këtu më sipër në këtë nen, duhet paraqitur nga një kopje pranë FSHF-së dhe pranë klubit përkatës.

---

**Neni 34                    Apeli kundër vendimeve**

---

1. Një lojtare mund të apelojë kundër vendimeve të marra nga ana e klubit për pezullimin ose sanksionimin me gjobë të lojtares përkatëse, pranë Dhomës së Zgjidhjes së Konfliktëve, në përputhje me rregulloret e FSHF-së në fuqi.
2. Kërkesa përkatëse për ushtrimin e të drejtës së përcaktuar në paragrafin (1) këtu më sipër në këtë nen, duhet paraqitur nga një kopje pranë FSHF-së dhe pranë klubit përkatës.

---

**Neni 35                    Konfliktet midis klubeve dhe lojtareve**

---

1. Çdo mosmarrëveshje ose konflikt që lind në zbatim në një kontratë të lidhur midis një klubi dhe një lojtareje, që nuk zgjidhet me mirëkuptim nga palët e përfshira në kontratën përkatëse, mund të kërkohet nga secila palë veç e veç, ose nga të dyja palët së bashku të trajtohet nga Dhoma e Zgjidhjes së Konfliktëve, pranë FSHF-së.

---

**Neni 36                    Pasojat e përfundimit të kontratës**

---

1. Pasojat e përfundimit të kontratës përkatëse të lidhur midis një lojtareje dhe një klubi, do të përcaktohen në përputhje përcaktimet e kontratës përkatëse, dhe në përputhje me Rregulloren mbi Statusin dhe Transferimin e Lojtareve.

## **Kreu III      Trofetë**

---

### **Neni 37      Trofetë**

---

1. Në përfundim të sezonit futbollistik 2017 – 2018, të Kampionatit Kombëtar të Femrave, do të shpërndahen trofetë siç përcaktohen në këtë kre këtu më poshtë.

---

### **Neni 38      Trofeu i Kampionatit Kombëtar të Futbollit të Femrave**

---

1. Trofeu i kampionatit Kombëtar të Femrave do të përbëhet si më poshtë:
  - a) Kupa e Kampionatit Kombëtar të Futbollit të Femrave;
  - b) 30 (tridhjetë) medalje për Ekipin Kampion të Femrave;
  - c) një shumë prej 1,000,000 (një milionë) lekë, për klubin përkatës të Ekipit Kampion të Femrave.
2. Kupa e kampionit të Kampionatit të Futbollit të Femrave modelohet dhe prodhohet në metal bronzi, në edicione 10 (dhjetë) vjeçare, duke filluar me edicionin e parë të prodhimit për sezonin futbollistik 2012-2013. Kupa e kampionit të Kampionatit të Femrave shpërndahet për ekipin kampion të kampionatit kombëtar të Futbollit të Femrave në përputhje me përcaktimet si më poshtë:
  - a) Kupa e Kampionatit Kombëtar të Futbollit të Femrave (version original) është pronë e Federatës Shqiptare të Futbollit, e cila këtu më poshtë në këtë nen, emërtohet kupa origjinale;
  - b) pas shpalljes së ekipit Kampion për Femra, FSHF organizon ceremoninë e shpalljes së ekipit Kampion të kampionatit kombëtar të futbollit, për Femra, dhe i dorëzon kupën origjinale ekipit përkatës;
  - c) në përfundim të ceremonisë, klubi i ekipit Kampion ka të drejtë të

- marrë dhe të mbajë në ambjentet e veta kupën origjinale.
- d) pas periudhës 10 (dhjetë) vjeçare të edicionit të Kupës Origjinale, FSHF do të modelojë dhe do të prodhojë një edicion të ri të Kupës Origjinale;
  - e) çdo herë që një ekip shpallet Kampion i Kampionatit Kombëtar të Futbollit, për Femra, emërtimi i këtij ekipi do të shkruhet në pjesën përkatëse në trupin e Kupës Origjinale.
3. 30 (tridhjetë) medaljet e kampionit të Femrave modelohen dhe prodhohen në metal bronzi në edicione 1 (një) vjeçare, duke filluar me edicionin e parë të prodhimit për sezonin futbollistik 2012-2013. Medaljet e kampionit të Kampionatit të Femrave shpërndahen për pjesëtarët e ekipit Kampion të Kampionatit Kombëtar të Futbollit, të Femrave, në përputhje me përcaktimet si më poshtë:
    - a) 30 (tridhjetë) medalje u shpërndahen lojtarëve të ekipit që shpallet Kampion, trajnerëve dhe 4 zyrtarëve të klubit;
    - b) medaljet e kampionit të Futbollit të Femrave shpërndahen gjatë ceremonisë së shpalljes së ekipit Kampion të Kampionatit Kombëtar të Futbollit, të Femrave, të organizuar nga FSHF;
    - c) medaljet e shpërndara mbeten pronë e personave të cilët i përfitojnë këto medalje.
  4. Shuma prej 1,000,000 (një milionë) lekë, për klubin përkatës të Ekipit Kampion të Kampionatit Kombëtar të Futbollit, për Femra, do të shpërndahet në formën e një çeku bankar të pagueshën ndaj klubit të shpallur Kampion jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga dita e shpalljes së ekipit përkatës Kampion i Kampionatit Kombëtar të Futbollit, për Femra. Çeku bankar i dorëzohet përfaqësuesit ligjor të klubit të shpallur kampion gjatë ceremonisë së shpalljes së ekipit kampion të kampionatit kombëtar të futbollit, për Femra, të organizuar nga FSHF.
  5. Trofeu “Golashënuesi më i mirë” në Kampionatin e Futbollit të Femrave do të përbëhet si më poshtë:
    - a) Këpucë bronzi
    - b) Një shumë prej 100.000 (njëqind mijë) lekë për lojtaren përkatës.
    - c) Shuma prej 100,000 (njëqind mijë) ALL, për golashënuesen më të mirë, të Kampionatit Kombëtar të Futbollit, për Femra, do të shpërndahet në formën e një çeku bankar të pagueshën ndaj lojtares të shpallur golashënuesia më e mirë, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga dita e shpalljes. Çeku bankar i dorëzohet lojtares të shpallur golashënuesia më e mirë e Kampionatit Kombëtar të Futbollit, për Femra.

1. Trofeu i Kupës së Shqipërisë të Futbollit të Femrave do të përbëhet si më poshtë:
  - a) Kupa e Shqipërisë të Futbollit të Femrave;
  - b) 30 (tridhjetë) medalje të arta dhe argjenda për Ekipin fitues të Kupës së Shqipërisë;
  - c) 30(tridhjetë) medalje të argjenda për Ekipin finalist të Kupës së Shqipërisë;
  - d) një shumë prej 2000euro (dy mijë) për klubin fitues të Kupës së Shqipërisë
2. Kupa e fituesit të Kupës së Shqipërisë modelohet dhe prodhohet në metal të çmuar, në ar dhe argjend, në edicione 10 (dhjetë) vjeçare, duke filluar me edicionin e parë të prodhimit për sezonin futbollistik 2012-2013. Kupa e fituesit të Kupës së Shqipërisë shpërndahet për ekipin fitues, në përputhje me përcaktimet si më poshtë:
  - a) Kupa e Shqipërisë (version origjinal) është pronë e Federatës Shqiptare të Futbollit, e cila këtu më poshtë në këtë nen, emërtohet kupa origjinale;
  - b) pas shpalljes së ekipit fitues, FSHF organizon ceremoninë e shpalljes së ekipit fituesit të Kupës së Shqipërisë të Futbollit të Femrave, dhe i dorëzon kupën origjinale ekipit përkatës;
  - c) në përfundim të ceremonisë, klubi fitues ka të drejtë të marrë dhe të mbajë në ambjentet e veta kupën origjinale, për një periudhë jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga dita e zhvillimit të ceremonisë së shpalljes së ekipit fitues;
  - d) nëse klubi i ekipit fitues ushtron të drejtën e përcaktuar në pikën (c) këtu më sipër në këtë paragraf, atëherë klubi përkatës merr në dorëzim kupën origjinale të cilën ka përgjegjësi ta ruajë nga dëmtimet dhe humbja;
  - e) para përfundimit të afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh të përcaktuar në pikën (c) këtu më sipër në këtë paragraf, klubi që ka marrë në dorëzim kupën origjinale, duhet ta kthejë këtë kupë origjinale në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm, të FSHF-së;
  - f) nëse klubi që ka marrë në dorëzim kupën origjinale, e humbet ose e dëmton kupën origjinale atëherë klubi përkatës është i detyruar të paguajë vlerën e përgjegjesisë për kupën origjinale, në

- shumën sa 10 (dhjetë) herë shumatorja e kostove të modelimit dhe prodhimit të kupës origjinale përkatëse;
- g) vlera e përgjegjësishë e përcaktuar në pikën (f) këtu më sipër në këtë paragraf, duhet paguar jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga dita e fundit kur klubi që kishte marrë kupën origjinale në dorëzim kishte detyrimin ta kthente pranë FSHF-së në zbatim të pikës (e) këtu më sipër në këtë paragraf;
  - h) me kthimin e kupës origjinale në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të FSHF-së, nga klubi përkatës, ky i fundit do të përfitojë një kupë kopje të modelit të kupës origjinale e cila është e prodhuar nga metal i zakonshëm dhe është e larë në metal të çmuar, në ar (kupa kopje);
  - i) kupa kopje mbetet pronë e klubit i cili e përfiton këtë kupë në zbatim të pikës (h) këtu më sipër në këtë paragraf, përveç rastit të zbatimit të sanksioneve me zbrapsje të trofeve ndaj klubit përkatës, siç përcaktohet në Kodin e Disiplinës Sportive të FSHF-së;
  - j) pas periudhës 10 (dhjetë) vjeçare të edicionit të kupës origjinale, FSHF do të modelojë dhe do të prodhojë një edicion të ri të kupës origjinale;
  - k) çdo herë që një ekip shpallet fitues i Kupës së Shqipërisë, emërtimi i këtij ekipi do të shkruhet në pjesën përkatëse në trupin e kupës origjinale.
3. 30 (tridhjetë) medaljet e ekipit fitues të Kupës së Shqipërisë modelohen dhe prodhohen në metal të çmuar, në ar dhe argjend, në edicione 1 (një) vjeçare, duke filluar me edicionin e parë të prodhimit për sezonin futbollistik 2012-2013. Medaljet e ekipit fitues të Kupës së Shqipërisë shpërndahen për pjesëtarët e ekipit fitues, në përputhje me përcaktimet si më poshtë:
- a) 22 (njëzet e dy) medalje shpërndahen për lojtarët më të mirë të ekipit fitues, 4 (katër) medalje shpërndahen për trajnerët, dhe 4 (katër) medalje shpërndahen përkatësisht për Sekretarin e Klubit, Oficerin e Sigurisë, Zëdhënësin e Shtypit, dhe Presidentin e klubit përkatës (lista e përfituesve të medaljeve paraqitet me shkrim nga klubi që shpallet fitues i Kupës së Shqipërisë të Futbollit të Femrave);
  - b) medaljet e ekipit fitues dhe finalist të Kupës së Shqipërisë të Futbollit të Femrave shpërndahen gjatë ceremonisë së shpalljes së ekipit fitues, të organizuar nga FSHF;

- c) medaljet e shpërndara mbeten pronë e personave të cilët i përfitojnë këto medalje siç përcaktohet në pikën (a) këtu më sipër në këtë paragraf, përveç rastit të zbatimit të sanksioneve me zmbarsje të trofeve ndaj personit përkatës, siç përcaktohet në Kodin e Disiplinës Sportive të FSHF-së.
4. Shuma prej 2000 euro (dy mijë) , për klubin përkatës të Ekipit fitues të Kupës së Shqipërisë të Futbollit të Femrave,do të shpërndahet në formën e një çeku bankar të pagueshën ndaj klubit të shpallur fitues jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga dita e shpalljes së ekipit përkatës fitues i Kupës së Shqipërisë. Çeku bankar i dorëzohet përfaqësuesit ligjor të klubit të shpallur fitues gjatë ceremonisë së shpalljes së ekipit fitues të Kupës së Shqipërisë, të organizuar nga FSHF.

---

**Neni 40                      Trofeu Superkupa e Shqipërisë Futbolli i Femrave**

---

1. Trofeu i Superkupës së Shqipërisë të Futbollit të Femrave do të përbëhet si më poshtë:
- a) Kupa e fitueses të Superkupës së Shqipërisë;
  - b) 30 (tridhjetë) medalje për Ekipin fitues të Superkupës së Shqipërisë;
2. Kupa e fituesit të Superkupës së Shqipërisë modelohet dhe prodhohet në metal të çmuar, në arë dhe argjend, duke filluar me edicionin e parë të prodhimit për sezonin futbollistik 2012-2013. Kupa e fituesit të Superkupës së Shqipërisë shpërndahet për ekipin fitues, në përputhje me përcaktimet si më poshtë:
- a) pas shpalljes së ekipit fitues, FSHF organizon ceremoninë e shpalljes së ekipit fituesit të Superkupës së Shqipërisë të Futbollit të Femrave, dhe i dorëzon kupën ekipit përkatës;
  - b) në përfundim të ceremonisë, klubi i fitues ka të drejtë të marrë dhe të mbajë në ambientet e veta kupën origjinale, për një periudhë jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga dita e zhvillimit të ceremonisë së shpalljes së ekipit fitues;
  - c) nëse klubi i ekipit fitues ushtron të drejtën e përcaktuar në pikën (c) këtu më sipër në këtë paragraf, atëherë klubi përkatës merr në dorëzim kupën origjinale të cilën ka përgjegjësi ta ruajë nga dëmtimet dhe humbja;
  - d) para përfundimit të afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh të përcaktuar në pikën (c) këtu më sipër në këtë paragraf, klubi që ka marrë në

- dorëzim kupën origjinale, duhet ta kthejë këtë kupë origjinale në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm, të FSHF-së;
- e) nëse klubi që ka marrë në dorëzim kupën origjinale, e humbet ose e dëmton kupën origjinale atëherë klubi përkatës është i detyruar të paguajë vlerën e përgjegjësisë për kupën origjinale, në shumën sa 10 (dhjetë) herë shumatorja e kostove të modelimit dhe prodhimit të kupës origjinale përkatëse;
  - f) vlera e përgjegjësisë e përcaktuar në pikën (f) këtu më sipër në këtë paragraf, duhet paguar jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga dita e fundit kur klubi që kishte marrë kupën origjinale në dorëzim kishte detyrimin ta kthente pranë FSHF-së në zbatim të pikës (e) këtu më sipër në këtë paragraf;
  - g) me kthimin e kupës origjinale në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të FSHF-së, nga klubi përkatës, ky i fundit do të përfitojë një kopje kopje të modelit të kupës origjinale e cila është e prodhuar nga metal i zakonshëm dhe është e larë në metal të çmuar, në ar (kupa kopje);
  - h) kupa kopje mbetet pronë e klubit i cili e përfiton këtë kupë në zbatim të pikës (h) këtu më sipër në këtë paragraf, përveç rastit të zbatimit të sanksioneve me zbrapsje të trofeve ndaj klubit përkatës, siç përcaktohet në Kodin e Disiplinës Sportive të FSHF-së;
  - i) pas periudhës 10 (dhjetë) vjeçare të edicionit të kupës origjinale, FSHF do të modelojë dhe do të prodhojë një edicion të ri të kupës origjinale;
3. 30 (tridhjetë) medaljet e ekipit fitues të Superkupës së Shqipërisë të Futbollit të Femrave modelohen dhe prodhohen në metal të çmuar, në ar dhe argjend, duke filluar me edicionin e parë të prodhimit për sezonin futbollistik 2015 - 2016. Medaljet e ekipit fitues të Superkupës së Shqipërisë shpërndahen për pjesëtarët e ekipit fitues, në përputhje me përcaktimet si më poshtë:
- a) 22 (njëzet e dy) medalje shpërndahen për lojtarët më të mirë të ekipit fitues, 4 (katër) medalje shpërndahen për trajnerët, dhe 4 (katër) medalje shpërndahen përkatësisht për Sekretarin e Klubit, Oficerin e Sigurisë, Zëdhënësin e Shtypit, dhe Presidentin e klubit përkatës (lista e përfituesve të medaljeve paraqitet me shkrim nga klubi që shpallet fitues i Superkupës së Shqipërisë);
  - b) medaljet e fitues të Superkupës së Shqipërisë shpërndahen gjatë

- ceremonisë së shpalljes së ekipit fitues, të organizuar nga FSHF;
- c) medaljet e shpërndara mbeten pronë e personave të cilët i përfitojnë këto medalje siç përcaktohet në pikën (a) këtu më sipër në këtë paragraf, përveç rastit të zbatimit të sanksioneve me zbrapsje të trofeve ndaj personit përkatës, siç përcaktohet në Kodin e Disiplinës Sportive të FSHF-së.



## Kreu IV Përgjegjësitë

---

### Neni 41 Përgjegjësitë e FSHF-së

---

1. FSHF mbulon me siguracion të gjitha risqet në lidhje me përgjegjësitë që ka FSHF për organizimin dhe zhvillimin e ndeshjeve zyrtare, siç përcaktohet në këtë rregullore. FSHF ka përgjegjësi për të mbuluar me siguracion:
  - a) aksidentet e shkaktuara ndaj delegatit/ve të ndeshjes jashtë kohëzgjatjes së ndeshjes zyrtare përkatëse.
2. Nëpërmjet organeve të kontrollit të brendshëm, FSHF do të garantojë zbatimin me përpikmëri të përcaktimeve të kësaj rregulloreje nga të gjithë punonjësit, zyrtarët (përfshirë këtu dizajnerin e arbitrave, arbitrat, krye-vëzhguesin e arbitrave, vëzhguesit e arbitrave, delegatët e ndeshjes, dhe çdo person tjetër që përfaqëson FSHF-në, në ndeshjet zyrtare), agjentët, inspektorët ose përfaqësuesit e FSHF-së që ushtrojnë funksione në zbatim të kësaj rregulloreje, duke vënë para përgjegjësisë çdo shkelës ose kundërvajtës. Në zbatim të këtij paragrafi, punonjësit, zyrtarët, agjentët, inspektorët ose përfaqësuesit e FSHF-së që shkelin ndonjë përcaktim të kësaj rregulloreje, me vetëdije ose nga pakujdesia:
  - a) do të shkarkohen nga pozicioni i punës përkatës;
  - b) do të ngarkohen me përgjegjësi materiale për pasojat që shkaktojnë shkeljet ose kundërvajtjet e tyre ndaj klubeve ose të tretëve.
3. FSHF do të garantojë kualifikimin profesional të të gjithë punonjësve, zyrtarëve (përfshirë këtu dizajnerin e arbitrave, arbitrat, krye-vëzhguesin e arbitrave, vëzhguesit e arbitrave, delegatët e ndeshjes, dhe çdo person tjetër që përfaqëson FSHF-në, në ndeshjet zyrtare), agjentëve, inspektorëve ose përfaqësuesëve të FSHF-së që ushtrojnë funksione në zbatim të kësaj rregulloreje, duke kryer trajnime dhe provime

(testime) ndaj personave të përmendur në këtë paragraf, në mënyrë të vazhdueshme, në lidhje me zbatimin e kësaj rregulloreje dhe rregulloreve të tjera të zbatueshme në lidhje me zhvillimin e Kampionatit Kombëtar të Futbollit të Femrave. Në zbatim të këtij paragrafi, FSHF ka përgjegjësi të skualifikojë çdo person që nuk i nënshtrohet provimeve (testimeve) në mënyrë të suksesshme.

---

## **Neni 42 Përgjegjësitë e personave juridikë, shoqatave dhe klubeve**

---

1. Çdo klub është përgjegjës për sjelljen e lojtareve, zyrtarëve, antarëve, tifozëve, përkatës si dhe për sjelljen e çdo personi tjetër që ushtron ndonjë funksion në emër të klubit gjatë ndonjë ndeshje zyrtare.
2. Klubi vendas është përgjegjës për garantimin e rregullit dhe sigurisë para, gjatë dhe pas ndeshjes zyrtare. Klubi vendas mund të konsiderohet përgjegjës për çdo incident të ndodhur gjatë ndeshjes zyrtare përkatëse dhe ndaj tij mund të ndërmerren masa disiplinore në përputhje me përcaktimet e Kodit të Disiplinës Sportive të FSHF-së.
3. Klubi është përgjegjës të luajë të gjitha ndeshjet në shtëpi në fushën e vet të lojës, e cila është e regjistruar pranë FSHF-së në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje.
4. Klubi vendas është përgjegjës për zhvillimin e ndeshjeve në fushën e vet të lojës në përputhje me standardet dhe procedurat e miratuara dhe udhëzuara nga FSHF.
5. Çdo klub vendas duhet të kryejë mbulimin me siguracion nëpërmjet një shoqërie sigurimesh me reputacion me shpenzimet e veta, në lidhje me risqet si më poshtë, dhe në përputhje me përcaktimet më poshtë:
  - a) çdo klub duhet të kryejë sigurimin gjatë gjithë sezonit futbollistik për mbulimin e plotë të risqeve në lidhje me pjesëmarrjen e klubit në garën përkatëse;
  - b) çdo klub vendas duhet të kryejë sigurimin gjatë gjithë sezonit futbollistik për mbulimin e plotë të risqeve në lidhje me organizimin dhe zhvillimin e ndeshjeve në fushën e vet të lojës, dhe mbulimi me siguracion duhet të mbulojë, pa kufizim, përgjegjësinë ndaj palëve të treta (për të gjitha palët e treta që marrin pjesë ose frekuentojnë ndeshjet përkatëse të zhvilluara në fushën e lojës të klubit përkatës) duke përfshirë mbulimin për dëmet ndaj personave, objekteve dhe pronës, si dhe për humbjet ekonomike të pësuar;

- c) edhe nëse klubi vendas nuk është pronar i fushës së lojës të regjistruar si fusha e vet e lojës, klubi duhet të kryejë mbulimin me siguracion në përputhje me përcaktimet në pikën (b) këtu më sipër, në këtë paragraf;
  - d) klubi vendas duhet të garantojë që FSHF të përfshihet në mbulimin me siguracion siç përcaktohet në këtë paragraf, dhe duhet të garantojë që FSHF do të jetë e përjashtuar nga çdo përgjegjësi apo pretendim nga palët e treta në lidhje me organizimin dhe zhvillimin e ndeshjeve në fushën e lojës përkatëse.
6. Çdo klub merr përsipër të paraqitet në fushën e lojës për ndeshjen zyrtare ku merr pjesë jo më vonë se 90 (nëntëdhjetë) minuta përpara fillimit të ndeshjes përkatëse.

---

### **Neni 43                      Përgjegjësitë e zyrtarëve të ndeshjes**

---

1. Zyrtarët e ndeshjes janë përgjegjës për zbatimin e Ligjeve të Lojës, e kësaj rregulloreje dhe dokumenteve të tjera rregulluese të vendosura në zbatim nga FSHF.
2. Zyrtarët e ndeshjes janë përgjegjës të marrin pjesë në të gjitha ndeshjet zyrtare ku caktohen nga organet përkatëse të FSHF-së.
3. Zyrtarët e ndeshjes janë të detyruar të raportojnë pranë organeve juridike të FSHF-së, çdo shkelje të Kodit të Disiplinës Sportive, ose të kësaj rregulloreje, që ata verifikojnë ose janë dëshmitarë para ndeshjes, gjatë ndeshjes, dhe pas ndeshjes përkatëse ku janë emëruar si zyrtarë të ndeshjes.
4. Zyrtarët depozitojnë pranë komisioneve juridike raportet e tyre në çdo rast që verifikojnë shkelje siç përcaktohen në paragrafin (3), këtu më sipër në këtë nen.
5. Mospërbushja e përgjegjësive të përcaktuara këtu në këtë nen nga ana e zyrtarëve të ndeshjes nuk i jep të drejtën ndonjë klubi, lojtari apo kujtdo personi tjetër që të shkelë detyrimet apo të mos përmbushë përgjegjësitë individuale të përcaktuara këtu në këtë rregullore.

## **Kreu V            Identifikimi dhe Uniformat e Lojtareve**

---

### **Neni 44            Identifikimi i lojtareve**

---

1. Përpara fillimit të sezonit futbollistik përkatës çdo klub duhet të përcaktojë numrin e uniformës për secilin nga lojtaret pjesëtare të ekipit të parë përkatës.
2. Klubi duhet të përcaktojë një numër uniforme edhe për çdo lojtare që bëhet pjesë e ekipit të parë gjatë sezonit futbollistik.
3. Numrat e uniformave janë të lirë të vendosen nga numri 1 (një) deri në numrin 99 (nëntëdhjetë e nëntë). Numrat e uniformave mund të jenë vetëm me 1 (një) shifër, ose me 2 (dy) shifra.
4. Ndërkohë që lojtaria është pjesë e klubit, lojtaria duhet të mbajë të njëjtin numër fanelle që i është përcaktuar në fillim të sezonit futbollistik përkatës.
5. Kur një lojtare nuk është më pjesë e klubit, numri i kësaj lojtareje mund të përcaktohet për një lojtare tjetër që nuk ka numër fanelle.
6. Çdo klub duhet të paraqesë pranë FSHF-së numrat e uniformave të lojtareve që ka përcaktuar nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes së Formulari 105 - Njoftimi i Numrave të Uniformave, bashkëngjitur kësaj rregulloreje, përpara fillimit të ndeshjes së parë të sezonit futbollistik përkatës, dhe në çdo rast që shtohet një lojtare e re në listën e federimit.
7. Kur zhvillohen ndeshjet zyrtare, çdo lojtare duhet të mbajë veshur uniformën e cila ka numrin e lojtares të shënuar nga pjesa e kurrizit. Gjithashtu mund të shënohet edhe mbiemri i lojtares mbi numër, ose ndonjë emërtim tjetër i miratuar me shkrim nga FSHF. Përmasat e numrit të shënuar në pjesën e kurrizit të uniformës duhet të jenë si në vijim: lartësia jo më pak se 24 (njëzet e katër) centimetra; dhe gjerësia të jetë përpjestimisht me numrin përkatës në varësi të lartësisë së numrit.

8. Numri i uniformës duhet shënuar edhe në pjesën përpara në këmbën e majtë të pantallonave të uniformës së lojtareve. Përmasat e numrit të shënuar në pjesën përpara në këmbën e majtë të pantallonave të uniformës duhet të jenë si në vijim: lartësia jo më pak se 9 (nëntë) centimetra; dhe gjerësia të jetë përpjestimisht me numrin përkatës në varësi të lartësisë së numrit.
9. Ngjyra dhe modeli i veshjes së portierëve që luajnë në ndeshjet zyrtare duhet të jetë i dukshëm nga uniformat e lojtareve dhe të zyrtarëve të ndeshjes.
10. Kapitenia e parë e çdo klubi që luan në një ndeshje zyrtare duhet të mbajë në krah shiritin e kapitenit gjatë gjithë kohëzgjatjes së ndeshjes përkatëse. Në rast se kapitenia e parë zëvendësohet gjatë ndeshjes, shiritin duhet ta mbajë kapitenia e dytë, ose lojtaria më e vjetër në moshë në fushën e lojës e klubit përkatës.

---

#### **Neni 45                      Uniformat**

---

1. Çdo klub duhet të sigurojë dhe të mbajë në gjendje funksionale dy uniforma të ndryshme, një për ndeshjet në shtëpi (uniforma zyrtare) dhe tjetrën për ndeshjet në transfertë (uniforma rezervë). Uniforma përmban bluzën, pantallonat, dhe getat.
2. Asnjë nga uniformat nuk duhet të jetë e ngjashme si ngjyrë ose model me uniformat e zyrtarëve të ndeshjes.
3. Jo më vonë se 1 (një) javë përpara fillimit të sezonit futbollistik, çdo klub duhet të regjistrojë uniformat përkatëse duke plotësuar dhe dorëzuar pranë FSHF-së, Formulari 106 - Regjistrimi i Fanellave Zyrtare, dhe kopje origjinale të fanellave.
4. Çdo uniformë e paraqitur për regjistrim duhet të përmbajë:
  - a) numrin e uniformës dhe përcaktimet e tjera të kësaj rregulloreje, të shënuara siç kërkohet nga kjo rregullore;
  - b) ndonjë reklamë ose emërtimin e ndonjë sponsori nëse janë të miratuar më parë nga FSHF.
5. Nëse, në zbatim të këtij neni, një klub kërkon të regjistrojë një uniformë që nuk përmbush përcaktimet në këtë rregullore:
  - a) FSHF do të njoftojë me shkrim klubin në shkelje dhe do t'i japë një afat prej 7 (shtatë) ditësh klubit përkatës për të plotësuar mangësitë në uniformën e dorëzuar për regjistrim; dhe
  - b) klubi në shkelje nuk mund të veshë në një ndeshje zyrtare fanellën,

- derisa ajo të plotësohet siç kërkohet dhe të miratohet nga FSHF.
6. Uniformat e regjistruara dhe të miratura duhet të vishen gjatë gjithë sezonit futbollistik dhe nuk duhen ndryshuar në asnjë mënyrë pa miratimin paraprak nga FSHF.
  7. Gjatë ndeshjeve zyrtare lojtarët e secilit klub pjesëmarrës në ndeshje duhet të veshin uniformën zyrtare, përveç rastit kur uniformat zyrtare të klubeve pjesëmarrëse janë të ngjashme dhe sipas opinionit të arbitrit mund të krijojnë konfuzion në fushë. Nëse fanellat zyrtare janë të ngjashme, klubi mik duhet të veshë uniformën rezervë, ose ndonjë kombinim të uniformës zyrtare dhe uniformës rezervë. Në çdo rast vendimi ose urdhëri i arbitrit është përfundimtar në lidhje me uniformat që do të veshin klubet pjesëmarrëse në fushën e lojës.
  8. Të paktën 4 (katër) ditë përpara zhvillimit të ndeshjes zyrtare, klubi mik duhet të njoftojë klubin vendas për uniformën që do të veshë nëpërmjet dërgimit të Formulari 107 - Njoftimi i Uniformës Zyrtare, Klubit Vendas, bashkëngjitur kësaj rregulloreje. Nëse klubi vendas vlerëson se mund të ekzistojë ngjashmëri midis uniformave, atëherë klubi vendas duhet të njoftojë menjëherë FSHF-në.
  9. Asnjë klub nuk mund të luajë ndonjë ndeshje, dhe për asnjë arsye, nëse lojtarët përkatëse nuk veshin ndonjë nga uniformat e miratuara më parë me shkrim nga FSHF.

---

#### **Neni 46                      Uniforma e tretë**

---

1. Çdo klub mund të mbajë edhe një uniformë të tretë në rast se e regjistron pranë FSHF-së në përputhje me këtë rregullore.
2. Për uniformën e tretë zbatohen të njëjtat përcaktime të kësaj rregulloreje si për uniformën zyrtare, dhe fanellën rezervë.

---

#### **Neni 47                      Reklamat në uniforma**

---

1. Vendosja e reklamave në uniforma e klubeve lejohet nëse përmbajtja, forma dhe madhësia janë miratuar më parë nga FSHF dhe shënohen në uniformë në përputhje me përcaktimet në këtë rregullore.

## **Kreu VI            Kriteret e Terreneve**

---

### **Neni 48            Çertifikata e sigurisë**

---

1. Çdo klub duhet të përfitojë Çertifikatën e Sigurisë për terrenin e fushës së lojës përkatës, në përputhje me Standardet e Terreneve Sportive, të FSHF-së.
2. Nëse terreni i fushës së lojës është i përbashkët me një ose disa klube të tjera, atëherë Çertifikatën e Sigurisë duhet ta zotërojnë të gjithë klubet njëkohësisht.

---

### **Neni 49            Pronësia e fushës së lojës dhe ambjenteve stërvitore**

---

1. Çdo klub duhet të zotërojë në pronësi fushën e lojës dhe ambjentet stërvitore ose të zotërojë një marrëveshje shfrytëzimi të lidhur me pronarin e fushës së lojës dhe/ose ambjenteve stërvitore në të cilën klubi gëzon të drejtën e shfrytëzimit deri në përfundim të sezonit futbollistik përkatës.
2. Përveç rasteve kur merret miratimi paraprak me shkrim nga FSHF, ambjentet stërvitore dhe fusha e lojës duhet të ndodhen brenda territorit të njësisë vendore ku është regjistruar klubi përkatës.
3. Dokumentacioni i cili vërteton pronësinë ose të drejtën e shfrytëzimit të fushës së lojës duhet dorëzuar pranë FSHF-së jo më vonë se 18 (tetëmbëdhjetë) ditë përpara fillimit të sezonit futbollistik përkatës.

---

### **Neni 50            Terreni i përbashkët**

---

1. Asnjë klub nuk mund të lidhë një marrëveshje për shfrytëzimin e përbashkët të një terreni të fushës së lojës, nëse marrëveshja përkatëse

nuk përcakton se zhvillimi i ndeshjeve zyrtare të kampionatit kombëtar të futbollit, të Femrave, nuk ka prioritet mbi ndeshjet e tjera që mund të zhvillohen në këtë terren të fushës së lojës.

---

**Neni 51**                    **Regjistrimi i terrenit**

---

1. Çdo klub duhet të regjistrojë terrenin e fushës së lojës dhe ambientet stërvitore pranë FSHF-së, dhe asnjë klub nuk ka të drejtë të luajë në një fushë loje tjetër pa marrë më parë miratimin me shkrim nga FSHF.

---

**Neni 52**                    **Vendet e spektatorëve**

---

1. Spektatorëve duhet t'u jepet mundësia të qëndrojnë në vende për t'u ulur.

---

**Neni 53**                    **Rregullorja e terrenit**

---

1. Klubi duhet të garantojë afishimin e një njoftimi zyrtar të titulluar "Rregullorja e Stadiumit/Terenit" dhe e publikuar nga klubi dhe FSHF, në mënyrë të tillë që të jetë e dukshme përreth të gjitha ambjenteve të terrenit.
2. Rregullorja duhet të përmbajë rregullat thelbësore që duhet të zbatohen të gjithë personat të cilët hyjnë dhe qëndrojnë brenda ambjenteve të terrenit përkatës gjatë zhvillimit të ndeshjes zyrtare.

---

**Neni 54**                    **Dhomat e zhveshjes**

---

1. Çdo klub duhet mbajë në funksionin dhomat e zhveshjes për secilin klub pjesëmarrës në ndeshjen zyrtare, sipërfaqja e secilës (pa përfshirë banjot dhe dushet) duhet të jetë jo më pak se 30 (tridhjetë) metër katror.

---

**Neni 55**                    **Dhoma e kontrollit anti-doping**

---

1. Çdo klub duhet të mbajë në funksionim një dhomë për kryerjen e kontrollit ose analizave anti-doping, e cila duhet të ndodhet pranë dhomave të zhveshjes së lojtarëve dhe dhomës së zyrtarëve të ndeshjes. Dhoma e kontrollit anti-doping nuk duhet të jetë e hapur për gazetarët, median, dhe publikun.



2. Në rast se klubi dështon në garantimin e dhomës së kontrollit anti-doping, atëherë klubi sanksionohet me gjobë me një vlerë prej 200,000 (dyqind mijë) lekë për verifikimin e shkeljes për herë të parë; dhe sanksionohet me gjobë me një vlerë prej 400,000 (katërqind mijë) lekë për verifikimin për çdo rast tjetër.

---

**Neni 56                    Hapësirat për median**

---

1. Gjatë çdo ndeshje zyrtare, klubi vendos duhet të plotësojë standardet minimale për hapësirat në gatishmëri për median, si më poshtë:
  - a) 16 (gjashtëmbëdhjetë) vende qëndrimi të pozicionuara pranë hapësirës për mediat me pamje të mirë dhe të plotë të fushës së lojës;
  - b) çdo vend qëndrimi për median duhet të jetë i pajisur me një tavolinë pune, një prizë e energjisë elektrike, dhe një linjë telefonike funksionale;
  - c) hapësirë për shpalljen e deklaratave të shtypit dhe kryerjen e intervistave, me një sipërfaqe jo më pak se 40 (dyzetë) metra katrorë;
  - d) ujë të pijshëm para ndeshjes, gjatë zhvillimit të ndeshjes, dhe pas ndeshjes.
2. Gjatë çdo ndeshje zyrtare, klubi vendos duhet të plotësojë standardet minimale për hapësirat e transmetimeve drejtpërdrejtë, si më poshtë:
  - a) 2 (dy) vende për komentatorët në një pozicion të përshtatshëm në lidhje me pamjen në fushën e lojës;
  - b) vendet e komentatorëve siç përcaktohet në pikën (a) këtu më sipër duhet të pozicionohen në të njëjtën anë të fushës së lojës siç është vendosur kamera kryesore e transmetimit të drejtpërdrejtë;
  - c) 2 (dy) vende për komentatorët e transmetimit radiofonik të drejtpërdrejtë, në një pozicion të përshtatshëm në lidhje me pamjen në fushëssn e lojës;
  - d) 2 (dy) vende në fushën e lojës për lidhjen e kamerave të cilat transmetojnë drejtpërdrejtë nga fusha e lojës, para ndeshjes, në pushimin e ndeshjes, dhe pas ndeshjes;
  - e) një hapësirë të sigurtë pranë stadiumit me sipërfaqe jo më pak se 100 (njëqind) metër katrorë për parkimin e studiove lëvizëse të operatorëve të transmetimit televiziv të drejtpërdrejtë.
3. Nëse ndonjë klub dështon në përmbushjen e standardeve minimale të

përcaktuara këtu më sipër në këtë nen, atëherë FSHF gëzon të drejtën të mos shpërmdajë të ardhurën nga e drejta televizive për klubin përkatës.

---

### **Neni 57 Hapësirat për fotografët**

---

1. Gjatë çdo ndeshje zyrtare, klubi vendas duhet të plotësojë standardet minimale për hapësirat në gatishmëri të fotografëve, si më poshtë:
  - a) të drejtën e hyrjes përgjatë fushës së lojës për të paktën 10 (dhjetë) fotografë;
  - b) të paktën 10 (dhjetë) jelekë me ngjyrë të dukshme dhe me mbi-shkrimin nga para dhe nga kurrizi “Foto”.

---

### **Neni 58 Siguria**

---

1. Në mënyrë që të garantohet siguria e lojtarëve, drejtuesve dhe zyrtarëve të klubit mik, si dhe siguria e zyrtarëve të ndeshjes që nga momenti i mbërritjes deri në momentin e ikjes nga një ndeshje zyrtare, çdo klub vendas duhet të sigurojë si më poshtë:
  - a) trajneri i klubit mik duhet të parkojë pranë hyrjes së lojtarëve të klubit mik;
  - b) të vendosen pengesa për parandalimin e hyrjes së publikut ose spektatorëve në hapësirën e parkimit dhe hyrjes së lojtarëve të klubit mik;
  - c) garantimi i hapësirave për parkim për drejtuesit dhe zyrtarët e klubit mik, si dhe me zyrtarët e ndeshjes pranë pikave përkatëse të hyrjes në stadium;
  - d) garantimi i hapësirave për parkim për personat e autorizuar nga FSHF, jo më pak se 5 (pesë) vende parkimi pranë pikave përkatëse të hyrjes në stadium;
  - e) garantimi i hapësirave për parkim për median, jo më pak se 8 (tetë) vende parkimi pranë pikave përkatëse të hyrjes në stadium;
  - f) hyrja e lojtarëve në stadium si dhe hapësirat e parkimit duhet të jenë të siguruar nga ruajtje me polici private ose me policinë e rendit.
2. Çdo klub vendas duhet të garantojë hyrjen dhe daljen e sigurtë nga fusha e lojës për lojtarët dhe zyrtarët e ndeshjes përpara fillimit të ndeshjes, gjatë hyrjes dhe daljes në pushim të ndeshjes, si dhe në përfundim të ndeshjes.

---

**Neni 59****Fusha e lojës**

---

1. Në çdo ndeshje zyrtare, fusha e lojës nuk duhet të jetë më e gjatë se 110 (njëqind e dhjetë) metra, më e shkurtër se 100 (njëqind) metra, dhe gjerësia duhet të jetë jo më shumë se 75 (shtatëdhjetë e pesë) metra, dhe jo më pak se 64 (gjashtëdhjetë e katër) metra.
2. Për garat e organizuara nga UEFA, fusha e lojës duhet të jetë 105 (njëqind e pesë) metra e gjatë, dhe 68 (gjashtëdhjetë e tetë) metra e gjerë. Nëse këto përmasa nuk mund të arrihen, atëherë klubi përkatës mund të përftojë një Liçencë Klubi të UEFA-s, nëse fusha është jo më e shkurtër se 100 (njëqind) metra dhe jo më e gjatë se 105 (njëqind e pesë) metra, dhe gjerësia është jo më shumë se 68 (gjashtëdhjetë e tetë) metra, dhe jo më pak se 64 (gjashtëdhjetë e katër) metra.
3. Çdo klub duhet të regjistrojë përmasat e fushës së lojës përpara fillimit të sezonit futbollistik përkatës duke plotësuar dhe njoftuar me shkrim pranë FSHF-së, nëpërmjet Formulari 108 - Regjistrimi i Përmasave të Fushës së Lojës, bashkëngjitur kësaj rregulloreje.
4. FSHF mund të kërkojë në çdo kohë nga ndonjë klub një raport verifikimi të përmasave të fushës së lojës të përpiluar dhe të çertifikuar nga një ekspert i pavarur. Shpenzimet përkatëse janë detyrim i klubit.
5. Asnjë klub nuk mund të ndryshojë përmasat e fushës së lojës përkatëse gjatë sezonit futbollistik pa marrë më parë miratimin me shkrim nga FSHF.
6. Çdo klub është i detyruar të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për mirëmbajtjen e fushës së lojës në gjendje të mirë gjatë gjithë sezonit futbollistik. Në rast të verifikimi dhe/ose vlerësimit se fusha e lojës nuk po mirëmbahet në gjendjen e kërkuar, FSHF mund të urdhërojë klubin përkatës të zbatojë hapat për mirëmbajtjen e fushës së lojës të udhëzuara nga FSHF.
7. Çdo klub është i detyruar të garantojë gjendjen e përshtatshme të fushës së lojës përkatëse, për të mundësuar zhvillimin e ndeshjeve në shtëpi.

---

**Neni 60****Mbrojtja e fushës së lojës**

---

1. Në mënyrë që të mbrohet fusha e lojës, lojtarët dhe zyrtarët duhet të zbatojnë procedurat si më poshtë, në periodat kohore para, dhe pas ndeshjes, si dhe në pushim të ndeshjes:

- a) fusha e lojës nuk duhet të shfrytëzohet për nxemje deri 45 (dyzet e pesë) minuta përpara orarit të fillimit të ndeshjes;
  - b) nxemja për secilin ekip nuk duhet të zgjasë më shumë se 30 minuta;
  - c) zona e portierit nuk duhet të shfrytëzohet më shumë se 20 (njëzet) minuta, dhe shfrytëzohet vetëm për ushtrime për portierin;
  - d) për kryerjen e nxemjes, lojtarët e ekipeve pjesëmarrëse në ndeshje duhet të shfrytëzojnë vetëm hapësirën që kufizohet midis vijës së zonës së penaltisë dhe vijës së mesit të fushës;
  - e) të gjitha ushtrimet e qëndrueshmërisë dhe shpejtësisë do të kryhen vetëm jashtë fushës së lojës, paralel me vijën anësore të fushës dhe në anën e kundërt me pozicionimin e ndihmës së arbitrit anësor;
  - f) vetëm lojtarët rezervë të cilët nuk janë aktivizuar akoma në ndeshjen përkatëse, mund të kryejnë nxemje në fushën e lojës në pushimin e ndeshjes;
  - g) procesi i rikuperimit në përfundim të ndeshjes nuk mund të zgjasë më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) minuta.
2. Në fushën e lojës lejohet zhvillimi i vetëm 1 (një) seance stërvitore në javë, e cila mund të zhvillohet jo më vonë se 3 (tre) ditë përpara datës së ndeshjes zyrtare.

---

## **Neni 61                      Fushat artificiale**

---

1. Një ndeshje zyrtare e Kampionatit Kombëtar të Futbollit, për Femra mund të zhvillohet në një fushë loje me bar artificial, nëse fusha e lojës përkatëse ka përfutur çertifikatën e FIFA-s, të nivelit “1 Star”, ose “2 Star”.

---

## **Neni 62                      Stoli i rezervave**

---

1. Çdo klub duhet të vendosë në funksionim dy vende të ndryshme për stolat e rezervave në afërsi të fushës së lojës, për tu shfrytëzuar vetëm nga lojtarët, trajnerët, mjekët, dhe zyrtarët për secilin nga klubet pjesëmarrëse në ndeshje.
2. Stolat e rezervave duhet të emërtohen në mënyrë të dukshme me emërtimet “Vendasit”, dhe “Miqhtë”, duhet të kenë kontakt të drejt-përdrejtë me fushën e lojës, duhet të jenë vendosur të barazlanguara

nga mesi i fushës së lojës, duhet të jenë të mbuluara dhe duhet të zotërojnë të paktën 13 (trembëdhjetë) ndenjese për tu ulur.

3. Stoli rezervë i "ekipit udhëtues" ndodhet prapa Asistent Arbitri i Parë

---

### **Neni 63                    Zona e stolit të rezervave**

---

1. Zona e stolit të rezervave duhet të përfshijë gjatësinë e stolit të rezervave dhe duhet të zgjatet nga 1 (një) metër në secilën anë të stolit të rezervave, dhe në drejtim të fushës së lojës duhet të zgjatet deri sa të afrohet jo më shumë se 1 (një) metër nga vija anësore e fushës së lojës.
2. Kufizimi i zonës së stolit të rezervave duhet të vijëzohet në mënyrë të dukshme.
3. Asnjë person nuk duhet të përdorë ndonjë monitor ose pajisje të ngjashme brenda ose në afërsi të zonës së stolit të rezervave.

---

### **Neni 64                    Ndriçimi i fushës së lojës**

---

1. Nëse një ndeshje zyrtare do të zhvillohet me ndriçim artificial, klubi vendas duhet të garantojë një ndriçim me intensitet mesatar prej 800 (tetëqind) lux, dhe një intensitet minimal prej 500 (pesëqind) lux të matur në çdo pikë të fushës së lojës.
2. Përpara zhvillimit të ndonjë ndeshje zyrtare me ndriçim artificial, fusha e lojës përkatëse duhet verifikuar nga FSHF për përmbushjen e përcaktimeve në paragrafin (1) të këtij neni. Me verifikimin e suksesshëm, FSHF do të lëshojë çertifikatën përkatëse për zhvillimin e ndeshjeve me ndriçim artificial.

---

### **Neni 65                    Kushtet sanitare**

---

1. Çdo klub duhet të garantojë mbajtjen në funksionim të banjove të mjaftueshme për spektatorët në përputhje me kriteret si më poshtë:
  - a) banjot duhet të jenë të pastra dhe me kushte higjienike optimale;
  - b) mbahet në funksionim 1 (një) banjo për çdo 500 (pesëqind) spektatorë.
2. Mospërmbushja e përcaktimeve në paragrafin (1) këtu më sipër në këtë nen nga ndonjë klub, sanksionohet me gjobë me një vlerë prej 100,000 (njëqind mijë) lekë për çdo ndeshje zyrtare të zhvilluar pa përmbushur kushtet sanitare.

---

**Neni 66**                    **Hapësirat për invalidët**

---

1. Çdo klub duhet të sigurojë hapësira të përshtatshme dhe të mjaftueshme për spektatorët invalidë.

---

**Neni 67**                    **Ekranët e stadiumit**

---

1. Ekranët e instaluar në stadium me pamje në fushën e lojës, dhe/ose me pamje nga vendqëndrimi i spektatorëve, duhet të funksionojnë në përputhje me përcaktimet si më poshtë:
  - a) ekranët duhet të jenë të pozicionuar në mënyrë të tillë që të mos ndërhyjnë dhe të mos tërheqin vëmendjen e lojtarëve dhe arbitrave në fushën e lojës;
  - b) funksionimi i ekranëve duhet të administrohet nga një person i cili është i vetëdijshëm për kushtet e funksionimit të ekranëve (përcaktimet e këtij neni);
  - c) ekranët duhet të shfrytëzohen vetëm për:
    - i. të transmetuar pamje video të ndeshjes në kohë reale;
    - ii. të ritransmetuar pamje video të momenteve ose incidenteve pozitive të ndodhura gjatë ndeshjes;
  - d) ekranët nuk duhet të shfrytëzohen:
    - i. për të ritransmetuar pamje video të momenteve ose incidenteve negative ose të dyshimta të ndodhura gjatë ndeshjes;
    - ii. për të ritransmetuar pamje video të momenteve ose incidenteve që mund të vënë në diskutim ose në dyshim gjykimin e ndonjë zyrtari të ndeshjes përkatëse;
    - iii. për të transmetuar pamje video të zonës së stolit të rezervave;
    - iv. për të transmetuar pamje video të lojtarëve zëvendësues gjatë procesit të nxemjes derisa nuk është afishuar nga zyrtari i ndeshjes tabela e zëvendësimit;
    - v. për të transmetuar çfarëdo lloj pamjesh video gjatë ndeshjes të cilat mund të diskretitojnë, të çenojnë, të fyejnë, të denigrojnë figurën e FSHF-së, klubeve, zyrtarëve të ndeshjes, ose lojtarëve, ose të vënë në diskutim vazhdimësinë e ndeshjes përkatëse.

## **Kreu VII      Sistemi i Garës**

---

### **Neni 68      Ligjet e lojës**

---

1. Të gjitha ndeshjet do të luhen në përputhje me Ligjet e Lojës të lëshuara nga IFAB.

### **Seksioni 1.      Kampionati Kombëtar i Futbollit të Femrave**

---

#### **Neni 69      Emërtimi i Garës**

---

1. Gara emërtohet “Kampionati Kombëtar i Futbollit të Femrave”, sezoni futbollistik 2017 - 2018.

#### **Neni 70      Numri i fazave**

---

1. Kampionati Kombëtar i Futbollit për Femra gjatë sezonit futbollistik 2017– 2018 zhvillohet me dy faza.
2. Në fazën e parë dhe të dytë do të zhvillohen ndeshje midis klubeve të futbollit pjesëmarrëse në Kampionatin e Futbollit për Femra me sistem vajtje-ardhje në përputhje me skemën e përcaktuar në Shtojcën IV – Kalendarin e Ndeshjeve.

#### **Neni 71      Numri i klubeve pjesëmarrëse**

---

1. Gjatë sezonit futbollistik 2017 - 2018, në Kampionatin Kombëtar të Futbollit të Femrave do të marrin pjesë 11 (Njëmbëdhjetë) klube futboll.
  1. Vllaznia
  2. Kinostudio
  3. Apolonia
  4. Tirana As
  5. Bilisht Sporti
  6. Skenderbeu
  7. Juban Danja
  8. Teuta
  9. AAS
  10. Dajti
  11. Pogradeci

---

**Neni 72**                    **Klasifikimi**

---

1. Ekipi i cili fiton një ndeshje do të përfitojë 3 (tre) pikë; ekipi që barazon në një ndeshje do të përfitojë 1 (një) pikë; ekipi që humbet një ndeshje nuk përfiton asnjë pikë.
2. Rezultatet e ndeshjeve të zhvilluara regjistrohen nga Sektori i Garave, pranë FSHF-së. Gjithashtu përpilohet në mënyrë të vazhdueshme tabela e klasifikimit e cila duhet të përmbajë informacionin si më poshtë për çdo ekip pjesëmarrës në garë:
  - a) numrin e ndeshjeve të luajtura në sezonin përkatës;
  - b) numrin e ndeshjeve të fituara, të barazuara dhe të humbura si klub vendas në sezonin përkatës;
  - c) numrin e ndeshjeve të fituara, të barazuara dhe të humbura si klub mik në sezonin përkatës;
  - d) numrin e golave të shënuar dhe të pësuar në ndeshjet e luajtura në sezonin përkatës;
  - e) numrin e pikëve të grumbulluara në sezonin përkatës.
3. Renditja e ekipeve në tabelën e klasifikimit do të përcaktohet sipas numrit të pikëve të grumbulluara gjatë sezonit përkatës, ku ekipi që ka grumbulluar më shumë pikë renditet në krye dhe ekipi që ka grumbulluar më pak pikë renditet në fund të klasifikimit.
4. Nëse dy ose më shumë ekipe kanë grumbulluar të njëjtën sasi pikësh, renditja e tyre në tabelën e klasifikimit përcaktohet duke mbajtur në konsideratë kriteret si më poshtë:
  - a) pikët e grumbulluara në ndeshjet e zhvilluara midis ekipeve përkatëse;
  - b) diferenca e golave të shënuar dhe të pësuar në ndeshjet e zhvilluara midis ekipeve përkatëse;
  - c) diferenca e golave të shënuar dhe të pësuar gjatë Kampionatit Kombëtar të Futbollit, për Kampionatin e Futbollit të Femrave, sezoni futbollistik 2017-2018;
  - d) numri më i madh i golave të shënuar gjatë Kampionatit Kombëtar të Futbollit, për Femra, sezoni futbollistik 2017-2018;
  - e) me short.

---

**Neni 73**                    **Fituesi i Kampionatit**

---

1. Shpallet kampion i Kampionatit Kombëtar të Futbollit të Femrave klubi e cila renditet në krye të tabelës së klasifikimit në përfundim të sezonit përkatës.



2. Klubi i shpallur Kampion do të përfitojë trofetë e përcaktuar këtu në këtë rregullore.

## **Seksioni 2. Kupa e Shqipërisë e Futbollit të Femrave**

---

### **Neni 74 Emërtimi i Garës**

---

1. Gara emërtohet “Kupa e Shqipërisë” Futboli i Femrave, sezoni futbollistik 2017-2018.

---

### **Neni 75 Numri i Tureve**

---

1. Për sezonin 2017-2018 Kupa e Shqipërisë do të organizohet me 4 Ture, ku do marrin pjesë 11 (ekipe) skuadra të vendosura sipas renditjes së Kampionatit 2017-2018.

---

### **Neni 76 Klubet pjesëmarrëse dhe skema e ndeshjeve**

---

Për sezonin 2017-2018 Kupa e Shqipërisë do të organizohet me 4 Ture, ku do marrin pjesë 11 (ekipe) skuadra të vendosura sipas renditjes së Kampionatit 2016-2017. Ndeshjet do të luhen në shtëpinë e ekipeve që janë të renditura më poshtë në tabelën e klasifikimit.

- |                   |                    |
|-------------------|--------------------|
| 1. Vllaznia       | 7. Juban Danja     |
| 2. Apolonia       | 8. Skënderbeu      |
| 3. Fc. Kinostudio | 9. Dajti           |
| 4. AAS            | 10. Pogradeci      |
| 5. Tirana AS      | 11. Bilisht Sporti |
| 6. Teuta          |                    |

Turi Praeliminator 03.02.2018

Turi praeliminator do të zhvillohet sipas skemës së mëposhtme:

- (8-10) Skënderbeu - Pogradeci (Pogradec)  
(9-11) Dajti – Bilisht Sport (Maliq)

Turi praeliminator 10.02.2018

Ekipi që fiton nga çifti Skënderbeu-Pogradeci do të ndeshet me çiftin që del nga Dajti-Bilisht Sporti

Ndeshjet zhvillohen me eliminim me një takim direkt. Ndeshjet do të luhen në shtëpinë e ekipeve që janë të renditura më poshtë në tabelën e klasifikimit.

#### TURI I DYTË (datë 17.02.2018)

Turi i dytë do të zhvillohet sipas skemës së mëposhtme duke u bazuar përsëri tek renditja e kampionatit 2016 - 2017:

- (1-8) Vllaznia – Fituesia e çiftit të dy tureve paraeliminatore.
- (2-7) Apolonia – Juban Danja (Kompleksi Zmijani Shkodër)
- (3-6) Fc.Kinostudio – Teuta ( Aneksi Durres)
- (4-5) AAS – Tirana AS (Kompleksi Kamëz)

Ndeshjet zhvillohen me eliminim me një takim direkt. Ndeshjet do të luhen në shtëpinë e ekipeve që janë të renditura më poshtë në tabelën e klasifikimit.

#### TURI I TRETË (Datë 24.02.2018)

Fit.Çift 1-8 (Vllaznia - Fit.tureve paraelimin - Fit.Çiftit 3-6 (Kinostudio – Teuta)

Fit.Çift2-7 (Apolonia – Juban Danja) – Fit. Çiftit 4-5 (AAS – Tirana AS)

Ndeshjet zhvillohen me eliminim me një takim direkt. Ndeshjet do të luhen në shtëpinë e ekipeve që janë të renditura më poshtë në tabelën e klasifikimit.

#### TURI I KATËRT Finale (Datë 03.03.2018)

Fit.Çift 1-8 (Vllaznia – Fit. tureve paraelimin. - Fit.Çiftit 3-6 (Kinostudio – Teuta)

Fit.Çift2-7 (Apolonia – Juban Danja) – Fit.Çiftit 4-5 (AAS – Tirana AS)

Finalia do të zhvillohet midis ekipeve fituese të turit të tretë sipas çifteve të përcaktuara më sipër. Stadiumi ku do të luhet Finalia do të përcaktohet nga FSHF.

---

**Neni 77**                    **Kualifikimi**

---

1. Përcaktimi i Klubit të futbollit i cili do të kualifikohet për turin pasardhës të Kupës së Shqipërisë do të bëhet si më poshtë:
  - A. Në përfundim të ndeshjes kualifikohet skuadra fituese.
  - B. Në rastet kur në fund të 90 minutave të ndeshjes rezultati është i barabartë, për të nxjerrë skuadrën fituese do të aplikohen goditjet nga pika e penalltisë 5 (pesë) goditje për secilën skuadër.
  - C. Në rast se dhe pas gjuajtjeve të 5 goditjeve të penalltive kemi përsëri barazim atëherë do të kemi goditje të alternuara nga pika e penalltisë deri në momentin që një nga skuadrat nuk do të shënojë  
Shpallet fituese skuadra që shënon.

---

**Neni 78**                    **Pjesëmarrja në garat e UEFA-s**

---

1. Klubet/shoqatat e futbollit të cilat do të fitojnë të drejtën për të marrë pjesë në garat e organizuara nga UEFA, do të përcaktohen si më poshtë:
  - a) Klubi/shoqata e futbollit e cila shpallet kampion i Kampionatit Kombëtar të Futbollit të Femrave, për sezonin futbollistik 2017 – 2018, do të marrë pjesë në “UEFA Champions League Femra”.

---

**Neni 79**                    **Superkupa e Shqipërisë**

---

1. Superkupa e Shqipërisë do të luhet midis skuadrës kampione të Kampionatit Kombëtar të Futbollit të Femrave dhe skuadrës fituese të Kupës së Shqipërisë 2017-2018. Ndeshja finale e Superkupës do të zhvillohet 1 (një) javë përpara fillimit të sezonit futbollistik 2018-2019 në stadiumin që do të caktohet nga FSHF.
2. Në rast se një skuadër brenda një sezoni, shpallet Kampione e Kampionatit Kombëtar të Futbollit të Femrave dhe fituese e Kupës së Shqipërisë, atëherë Superkupa e Shqipërisë nuk do të zhvillohet por automatikisht është fituese ekipi që i ka fituar të dyja trofetë.
3. Ekipi pritës për ndeshjen finale të Superkupës së Shqipërisë do të përcaktohet me short të lirë.

## **Kreu VIII      Organizimi dhe Zhvillimi i Ndeshjeve**

---

### **Neni 80              Koha e zhvillimit të ndeshjeve dhe kalendari**

---

1. Datat dhe oraret e zhvillimit të ndeshjeve do të caktohen nga FSHF përpara fillimit të sezonit futbollistik përkatës. Kalendari do të shpallet jo më vonë se 14 (katërbëdhjetë) ditë përpara zhvillimit të ndeshjes së parë zyrtare të kampionatit ose garës përkatëse.
2. Përveç rasteve që përcaktohen këtu në këtë kre, të gjitha ndeshjet do të luhen në datën dhe orën e përcaktuar në kalendarin përkatës.
3. Përveç ndeshjeve të cilat do të transmetohen drejtëpërdrejtë në televizion, të gjitha ndeshjet e fundjavës do të luhen ditën e dielë.
4. E drejta e shfrytëzimit të emërimit të ndeshjes është pronë e FSHF, këtu përfshihet por nuk kufizohet, përdorimi i emërimit të ndeshjeve:
  - a) për vendosjen e basteve sportive;
  - b) për përpilimin e skedinave sportive.

---

### **Neni 81              Ndryshimi i datës së ndeshjeve**

---

1. FSHF ka të drejtën dhe fuqinë të ndryshojë datat e ndeshjeve në çdo kohë. Përpara ushtrimit të kësaj të drejte, FSHF do të konsultohet paraprakisht me klubet e përfshira në ndeshjen/et përkatëse, si dhe me klubet e tjera të cilat mund të ndikohen nga ndryshimi i datës së ndeshjes/ve.

---

### **Neni 82              Ndeshjet miqësore**

---

1. Asnjë klub nuk ka të drejtë të organizojë ndonjë ndeshje miqësore gjatë periudhës së sezonit futbollistik, në mënyrë të tillë që të ndikojë kalendarin e ndeshjeve të kampionatit.

---

**Neni 83**                    **Kampionatet dhe garat e tjera**

---

1. Përveç rasteve të miratimit me shkrim nga FSHF, asnjë klub nuk mund të marrë pjesë në ndonjë kampionat ose garë tjetër përveç garave më poshtë:
  - a) Kampionati Kombëtar i Futbollit Femra,
  - b) Kupa e Shqipërisë, FSHF.
  - c) Champions League Femra, UEFA;
2. Të gjithë klubet janë të detyruar të marrin pjesë në Kupën e Shqipërisë, të organizuar nga FSHF, përveç rasteve kur ndalohet nga ndonjë vendim i komisioneve juridike të FSHF-së. Nëse ndonjë klub refuzon të marrë pjesë në Kupën e Shqipërisë, sanksionohet me gjobë me një vlerë prej 100,000 (njqind mijë) lekë.
3. Kualifikimi për në garat e organizuara nga UEFA, mbështetet vetëm në meritën sportive duke garuar në garat dhe kampionatet kombëtare të organizuara nga FSHF. Klubet, të cilat kualifikohen për në garat e organizuara nga UEFA, duhet të aplikojnë për përfitim të licencës përkatëse të UEFA-s, në përputhje me manualin e licencimit të klubeve.

---

**Neni 84**                    **Shtyrja e një ndeshje**

---

1. Një ndeshje e kampionatit nuk mund të shtyhet në asnjë rast përveç rasteve më poshtë:
  - a) kur në datën e ndeshjes përkatëse klubi vendas ose klubi mik zhvillon ndeshje në një garë të lejuar si në Neni 84 - paragrafi (1), pikat (a), (b) dhe (c); ose
  - b) me miratimin ose urdhërin e arbitrit të ndeshjes përkatëse; ose
  - c) me urdhër me shkrim të FSHF-së.
2. Me shtyrjen e një ndeshje në përputhje me paragrafin (1), pikat (a), (b), dhe (c), këtu në këtë nen, klubi vendas duhet të njoftojë sa më parë FSHF-në, dhe kjo e fundit përcakton datën kur duhet riluajtur ndeshja përkatëse, në përputhje me këtë rregullore.

---

**Neni 85**                    **Dështimi në zhvillimin e ndeshjes**

---

1. Përveç rastit kur një ndeshje shtyhet ose braktiset në përputhje me Neni 85 - paragrafi (1), dhe asnjë nga klubet nuk është shkaktar, çdo

- klub që shkakton shtyrjen ose braktisjen e një ndeshje është në shkelje të kësaj rregulloreje, dhe ndaj këtij klubi do të ndërmerren sanksionet e përcaktuara në Kodin e Disiplinës Sportive, të FSHF-së.
2. Mos paraqitja e një ekipi në një takim zyrtar, do të ketë pasojat e mëposhtme:
    - a) Për aktivitetet [garat] me sistem eliminimi, takimi do të konsiderohet i humbur me rezultatin 3-0, si dhe eliminimi i tij.
    - b) Nëse kjo ndodh në një ndeshje finale, kjo finale do të zhvillohet ndërmjet finalistit dhe ekipit që është eliminuar nga ekipi që nuk u paraqit.
    - c) Në çdo rast, ekipi që nuk paraqitet, nuk do të marrë pjesë në edicionet e ardhshëm të këtij aktiviteti.
    - d) Në rastin e aktivitetit [garave] kur klasifikimi bëhet me pikë, ekipi që nuk paraqitet, e humb ndeshjen me rezultatin 3-0, si edhe i hiqen 3 pikë në klasifikim nga pikët e grumbulluara.
    - e) Në rastet kur ekipi e përsërit këtë veprim, përjashtohet nga aktiviteti dhe zbret në një kategori më poshtë.
  3. Në rastet kur ekipi përjashtohet nga aktiviteti, veprohet si më poshtë:
    - a) Nëse mos paraqitja bëhet kur ekipi ka kryer më pak se 50% ndeshjeve të planifikuara, do të shpallen të pavlefshme të gjitha pikët që ekipet e tjera kanë marrë në takimet direkte me të.
    - b) Nëse mosparaqitja bëhet kur ekipi ka kryer më shumë se 50% plus 1 (një) ndeshje të planifikuara, pikët e ndeshjeve të zhvilluara mbeten edhe për ndeshjet në vazhdim, sipas kalendarit t'u jepen pikët ekipeve që nuk janë ndeshur, me rezultatin 3-0.
  4. Në çdo rast mos paraqitja do të shoqërohet detyrimisht edhe me gjobë ndaj klubit apo shoqërisë përgjegjëse me 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

---

## **Neni 86                      Rilaujta e një ndeshje**

---

1. FSHF ka të drejtën të urdhërojë rilaujten e një ndeshje në zbatim të ndonjë vendimi të komisioneve juridike të FSHF-së.
2. Në zbatim të paragrafit (1), këtu më sipër në këtë nen, klubi që refuzon zbatimin e urdhërit të FSHF-së për rilaujten e ndonjë ndeshje ku klubi përkatës ka qenë pjesëmarrës, do të sanksionohet me humbje të ndeshjes përkatëse në tavolinë me rezultatin 3 – 0 (tre me zero), dhe me gjobë me vlerë prej 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

---

**Neni 87**                    **Delegati i ndeshjes**

---

1. FSHF do të emërojë një delegat ndeshje i cili do të marrë pjesë në çdo ndeshje të kampionatit, dhe klubi vendas është i detyruar t'i ofrojë një vend në stadium, si dhe mundësinë për të hyrë në çdo ambient të stadiumit, përfshirë këtu edhe në fushën e lojës.
2. Delegati i ndeshjes vepron si përfaqësues zyrtar i FSHF-së për ndeshjen ku ai është emëruar, dhe ai raporton për këtë ndeshje duke shfrytëzuar formularin 109 Raporti i Delegatit të Ndeshjes.
3. Shpenzimet e delegatit të ndeshjes paguhen nga FSHF.

---

**Neni 88**                    **Ekipi më i mirë**

---

1. Klubet janë të detyruar të përfaqësohen në fushën e lojës në çdo ndeshje me ekipin më të mirë.

---

**Neni 89**                    **Mosha minimale**

---

1. Një lojtare që nuk ka mbushur akoma moshën 14 (katërmëdhjetë vjeç) nuk mund të luajë ndonjë ndeshje të kampionatit, dhe nuk mund të federohet në ekipin e parë të asnjë klubi pjesëmarrës në kampionatet ose garat e organizuara nga FSHF.

---

**Neni 90**                    **Formulari i Ekipit**

---

1. Të paktën 1 (një) orë përpara fillimit të ndeshjes, një zyrtar i klubit (nga stafi tekniko sportiv) dhe kapiteni i parë i ekipit për secilin nga klubet që marrin pjesë në ndeshje, duhet të jenë të pranishëm në takimin që organizon arbitri për plotësimin e protokollit të ndeshjes, dhe duhet t'i dorëzojnë arbitrit, klubit kundërshtar dhe medias një kopje të Formularit të Ekipit, siç përcaktohet në Formularin e Ekipit, bashkëngjitur kësaj rregulloreje, dhe duhet të përmbajë informacionet si më poshtë:
  - a) numrat e fanellave dhe emrat e lojtareve (përfshirë lojtaret rezervë) të cilët do të marrin pjesë në ndeshje;
  - b) ngjyrat e fanellave që do të veshë ekipi, përfshirë dhe veshjen e portierit;

- c) emrat dhe pozicionin e punës për jo më shumë se 5(pesë) zyrtarë të klubit, të cilët do të qëndrojnë në bankinën e stolit të rezervave.
- Nëse ndonjë lojtare e formacionit të parë ose lojtare rezervë e shënuar në formularin e ekipit dëmtohet pas dorëzimit të formularit tek arbitri i ndeshjes, por nuk ka filluar akoma ndeshja, dhe nëse zyrtarët e ndeshjes binden se lojtarja përkatëse nuk mund të luajë dot gjatë ndeshjes përkatëse, atëherë emri i kësaj lojtareje mund të zëvendësohet me një lojtare tjetër, qoftë kjo si lojtare formacioni apo lojtare rezervë.
  - Asnjë lojtare që nuk ka emrin në formularin e ekipit, nuk mund të hyjë në fushën e lojës ose të qëndrojë në stolin e rezervave.

---

### **Neni 91                    Lojtaret rezervë**

---

- Në çdo ndeshje të kampionatit, klubi ka të drejtë të përfshijë jo më shumë se 7 (shtatë) lojtare rezervë në formularin e ekipit përkatës, nga të cilët vetëm 3 (tre) prej tyre mund të marrin pjesë në ndeshje në përputhje me përcaktimet në Ligjin 3, të Ligjeve të Lojës.
- Gjatë një ndeshje nuk mund të kryejnë nxemjen më shumë se 3 (tre) lojtare për secilin klub, në të njëjtën kohë rreth fushës së lojës.

---

### **Neni 92                    Fillimi i ndeshjes**

---

- Për ndeshjet e Kampionatit të Futbollit të Femrave, FSHF do të vendosë për orarin e fillimit të ndeshjeve sipas orarit diellor.

<b>2017</b>		<b>2018</b>	
<b>Muaji</b>	<b>Ora</b>	<b>Muaji</b>	<b>Ora</b>
Gusht	17:00	Janar	14:00
Shtator	16:00	Shkurt	14:00
Tetor	14:30	Mars	15:00
Nentor	14:00	Prill	16:00
Dhjetor	14:00	Maj	17:00
		Qershor	17:00

- Sipas udhëzimeve të UEFA-s asnjë ndeshje e Kampionatit Kombëtar nuk duhet të luhet në ditën që UEFA ka në program ndeshje të



kompeticioneve të saja, sipas kushteve të mëposhtme:

- a) Mund të luhet nëse ndeshja nuk trasmetohet në television as kombëtar dhe as ndërkombëtar.
  - b) Të ketë një diferencë prej të paktën 30 minuta nga përfundimi i një ndeshjeje dhe fillimit të ndeshjes tjetër.
  - c) Nëse një ndeshje do të duhet në të njëjtin orar, duhet të njoftohet paraprakisht UEFA për të marrë konfirmimin.
3. Çdo klub duhet të zbatojë me përpikmëri orarin e përcaktuar për zhvillimin e ndeshjes përkatëse ku klubi merr pjesë. Klubi vendas ka detyrimin të shpjegojë me shkrim pranë FSHF-së, nëse ndodhin vonesa në zbatimin e orarit të fillimit të ndeshjes.
4. Çdo klub që shkakton vonesën në fillimin e ndeshjes pa arsye objektive si në fillim të ndeshjes përkatëse apo edhe në fillim të pjesës së dytë të lojës:
- a) do të sanksionohet me gjobë me një vlerë prej 10,000 (dhjetë mijë) lekë, në verifikimin për herë të parë dhe vonesa nuk është më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) minuta;
  - b) dhe në rastin e verifikimit të përsëritur për herë të dytë ose më shumë brenda një periudhe prej 2 (dy) vjetësh nga verifikimi i shkaktimit të vonesës për herë të parë, ose në rastin e vonesës për më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) minuta, vonesa do të konsiderohet si refuzim dhe/ose braktisje e ndeshjes dhe do të sanksionohet në përputhje me përcaktimet e Kodit të Disiplinës Sportive të FSHF-së, në dëm të shkaktarit të vonesës përkatëse.
5. Çdo klub duhet të zbatojë me përpikmëri orarin e përcaktuar për zhvillimin e ndeshjes përkatëse ku klubi merr pjesë. Klubi vendas ka detyrimin të shpjegojë me shkrim pranë FSHF-së, nëse ndodhin vonesa në zbatimin e orarit të fillimit të ndeshjes.
6. Çdo klub që shkakton vonesën në fillimin e ndeshjes pa arsye objektive si në fillim të ndeshjes përkatëse apo edhe në fillim të pjesës së dytë të lojës:
- a) do të sanksionohet me gjobë me një vlerë prej 10,000 (dhjetë mijë) lekë, në verifikimin për herë të parë dhe vonesa nuk është më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) minuta;
  - b) dhe në rastin e verifikimit të përsëritur për herë të dytë ose më shumë brenda një periudhe prej 2 (dy) vjetësh nga verifikimi i shkaktimit të vonesës për herë të parë, ose në rastin e vonesës për më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) minuta, vonesa do të

konsiderohet si refuzim dhe/ose braktisje e ndeshjes dhe do të sanksionohet në përputhje me përcaktimet e Kodit të Disiplinës Sportive të FSHF-së, në dëm të shkaktarit të vonesës përkatëse.

---

**Neni 93                    Hyrja në fushën e lojës**

---

1. Ekipet pjesëmarrëse në një ndeshje do të hyjnë në fushën e lojës së bashku të udhëhequra nga arbitri i ndeshjes dhe ndihmësit e arbitrit, jo më vonë se 5 (pesë) minuta nga orari i fillimit të ndeshjes.

---

**Neni 94                    Topi zyrtar**

---

1. Në të gjitha ndeshjet zyrtare klubi vendas dhe/ose klubet pjesëmarrëse në ndeshjen përkatëse do të përdorin vetëm topin zyrtar të miratuar nga FSHF-ja, ose të jetë i çertifikuar me “FIFA Approved”.

---

**Neni 95                    Stoli i rezervave**

---

1. Në stolin e rezervave mund të qëndrojnë vetëm lojtaret dhe zyrtarët të cilët kanë emrin të shënuar në formularin e ekipit.
2. Çdo lojtar ose zyrtar i cili sanksionohet me largim nga ndeshja do të largohet menjëherë për në dhomën e zhveshjes dhe nuk ka të drejtë të qëndrojë në stolin e rezervave.

---

**Neni 96                    Zona e stolit të rezervave**

---

1. Trajneri ose manaxheri i klubit kanë të drejtë të japin udhëzime taktike për lojtaret në fushën e lojës duke qëndruar brenda vijëzimit të zonës së stolit të rezervave, dhe duke u kthyer menjëherë në stolin e rezervave.
2. Në zonën e stolit të rezervave është e ndaluar rreptësisht pirja e duhanit, gjatë zhvillimit të ndeshjes.

---

**Neni 97                    Kohëzgjatja e ndeshjes**

---

1. Në përputhje me përcaktimet e Ligjit 7, të Ligjeve të Lojës, kohëzgjatja e një ndeshje do të jetë 90 (nëntëdhjetë) minuta.
2. FSHF-ja mund të urdhërojë riluajtjen ose të konsiderojë të luajtur një

ndeshje e cila ka zgjatur më pak se 90 (nëntëdhjetë) minuta.

3. Pushimi midis dy pjesëve të lojës në një ndeshje do të jetë 15 (pesëmbëdhjetë) minuta.

---

### **Neni 98 Deklarimi i biletave**

---

1. Jo më larg se 10 (dhjetë) ditë nga zhvillimi i ndeshjes përkatëse, klubi vendas duhet të plotësojë dhe të dorëzojë pranë FSHF-së, Formularin 111 Deklarimi i Biletave, bashkëngjitur kësaj rregulloreje, në lidhje me numrin e biletave të shitura gjatë zhvillimit të ndeshjes përkatëse.

---

### **Neni 99 Sanksione për organizimin dhe zhvillimin e ndeshjeve**

---

1. Çdo klub që shkel përcaktimet në Neni 94 - dhe në Neni 99 do të sanksionohet me gjobë me një vlerë prej 20,000 (njëzet mijë) lekë për shkeljen për herë të parë; me gjobë me një vlerë prej 40,000 (dyzetmijë) lekë për shkeljen për herë të dytë; me gjobë me një vlerë prej 60000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë për shkeljen për herë të tretë, dhe në rastet e tjera do të sanksionohet në përputhje me përcaktimet e Kodit të Disiplinës Sportive të FSHF-së.

---

### **Neni 100 Standardet për organizimin dhe zhvillimin e ndeshjeve**

---

1. Ndeshjet do të organizohen dhe zhvillohen në përputhje me "Rregulloren për organizimin e ndeshjeve të futbollit nga klubet shqiptare", të lëshuar nga FSHF.

---

### **Neni 101 Regjistrimi audio/video i ndeshjeve**

---

1. Të gjitha ndeshjet zyrtare të Kampionatit Kombëtar të Futbollit, për Futbollin e Femrave, do të regjistrohen në audio/video. Regjistrimet përkatëse do të arkivohen pranë Sekretarisë së Përgjithshme të FSHF-së, dhe do të ruhen për një periudhë për jo më pak 10 (dhjetë) vjet.
2. Ndeshjet zyrtare regjistrohen në audio/video në përputhje me përcaktimet si më poshtë:
  - a) regjistrimi kryhet nga jo më pak se 3 (tre) video-kamera, dhe secila prej tyre regjistron një pistë audio dhe një pistë video;
  - b) regjistrimi audio/video përfundimtar duhet të përmbajë të paktën

- 4 (katër) pista audio/video, përkatësisht si në vijim:
- i. 3 (tre) pista audio/video nga secila prej video-kamerat;
  - ii. 1 (një) pistë audio/video, sinjal i kombinuar nga pistat e video-kamerave veç e veç;
- c) kohëzgjatja e regjistrimit, për secilën pistë fillon të paktën 10 (dhjetë) minuta përpara fillimit të ndeshjes, dhe përfundon jo më herët se 10 (dhjetë) minuta pas përfundimit të ndeshjes;
- d) regjistrimi përpilohet në dy kopje të njëjta, në format DVD, MPEG-2.
3. Klubet vendase janë të detyruara të kryejnë regjistrimin e të gjitha ndeshjeve zyrtare që zhvillohen në fushën e tyre të lojës, në audio/video në përputhje me përcaktimet në paragrafin (2), këtu më sipër në këtë nen.
4. Nëse e gjykon të arsyeshme, FSHF mund të kontrakttojë me të tretë shërbimin e regjistrimit audio/video të ndeshjeve zyrtare të Futbollit të Femrave, duke lidhur një kontratë shërbimi në përputhje me përcaktimet si më poshtë:
- a) regjistrimi kryhet në përputhje me përcaktimet në paragrafin (2), këtu më sipër në këtë nen;
  - b) aplikohen kushtet penale si në vijim:
    - i. nëse regjistrimi dorëzohet me vonesë, aplikohet një kusht penal prej 10,000 (dhjetë mijë) lekë për çdo ditë vonesë;
    - ii. nëse regjistrimi nuk dorëzohet, aplikohet një kusht penal prej 30,000 (tridhjetë mijë) lekë;
    - iii. nëse regjistrimi dorëzohet me mungesa në pistat audio/video, aplikohet një kusht penal prej 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë për çdo pistë audio/video të munguar; ky përcaktim nuk aplikohet në rastin kur nuk dorëzohet regjistrimi;
  - c) nëse pala që lidh kontratë shërbimi për regjistrimin audio/video të ndeshjeve, dështon në përmbushjen e ndonjë kushti të kontratës së shërbimit, FSHF i kërkon rregullimin e menjëhershëm të çështjes në dështim dhe jep afat jo më shumë se 14 (katërmëdhjetë) ditë; në rastin e dështimit në përmbushjen e ndonjë kushti të kontratës së shërbimit për herë të dytë, FSHF ndërpret në mënyrë të njëanshme kontratën e shërbimit;
  - d) nëse pala që lidh kontratë shërbimi për regjistrimin audio/video të ndeshjeve, dështon në xhirimin (regjistrimin) e ndonjë ndeshje, atëherë FSHF ka të drejtë të ndërpresë kontratën e shërbimit në mënyrë të njëanshme;

- e) pala që lidh kontratë shërbimi për regjistrimin audio/video të ndeshjeve duhet të depozitojë një garanci bankare në shumën që të mundësojë FSHF-në të sanksionojë rastet e shkeljes së përcaktimeve të kontratës së shërbimit përkatëse;
5. Klubet mike kanë të drejtë të regjistrojnë në audio/video, çdo ndeshje ku ato marrin pjesë si klube mike. Klubet mike duhet të shfrytëzojnë regjistrimet në audio/video të përfutuara, në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje.
6. Klubi vendas është i detyruar të garantojë integritetin e grupit të xhirimit (regjistrimit), si dhe është përgjegjës për ruajtjen fizike të anëtarëve dhe pajisjeve të grupit të xhirimit (regjistrimit). Shkelja e këtij përcaktimi, procedohet dhe sanksionohet si më poshtë:
- a) cënimi i ndonjë anëtari të grupit të xhirimit (regjistrimit), do të konsiderohet njësoj sikur të ishte cënuar një zyrtar ndeshje, në kuptim të Kodit të Disiplinës Sportive të FSHF-së, dhe klubi vendas do të sanksionohet njësoj siç përcaktohet në rastet e cënimit të zyrtarëve të ndeshjes;
- b) cënimi i ndonjë anëtari të grupit të xhirimit (regjistrimit) të klubit mik, do të konsiderohet njësoj sikur të ishte cënuar një zyrtar i klubit mik, në kuptim të Kodit të Disiplinës Sportive të FSHF-së, dhe klubi vendas do të sanksionohet njësoj siç përcaktohet në rastet e cënimit të zyrtarëve të klubit mik;
- c) kur nuk ka grup xhirimi (regjistrimi) të kontraktuar nga FSHF gjatë një ndeshje zyrtare, cënimi i ndonjë anëtari të grupit të xhirimit (regjistrimit) të klubit mik, do të konsiderohet njësoj sikur të ishte cënuar një zyrtar ndeshje, në kuptim të Kodit të Disiplinës Sportive të FSHF-së, dhe klubi vendas do të sanksionohet njësoj siç përcaktohet në rastet e cënimit të zyrtarëve të ndeshjes.
7. Ndeshjet zyrtare të regjistruara në përputhje me paragrafin (1) dhe (2), këtu më sipër në këtë nen, dorëzohen jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë nga momenti i zhvillimit të ndeshjes zyrtare, në dy kopje përkatësisht si më poshtë:
- a) një kopje dorëzohet pranë arbitrit të ndeshjes, i cili pasi e analizon dhe përpilon raportin përkatës e arkivon pranë sektorit të gjykimimit; dhe
- b) një kopje dorëzohet pranë arkivës së FSHF-së.
8. Kur ndeshjet regjistrohen nga pala e kontraktuar nga FSHF, sipas paragrafit (4), këtu më sipër në këtë nen, klubi vendas duhet të paguajë një tarifë solidariteti prej 25% (njëzet e pesë përqind) të kostos

përkatëse për regjistrimin e ndeshjes që merr pjesë klubi vendas.

9. Në rastet kur regjistrimin në audio/video të ndeshjes zyrtare e kryen FSHF, nëpërmjet grupit të xhirimit (regjistrimit) të kontraktuar sipas paragrafit (4), këtu më sipër në këtë nen, klubi vendas përkatës çlirohet nga detyrimi për regjistrimin e ndeshjes vetëm nëse njoftohet me shkrim nga FSHF, për marrjen përsipër të regjistrimit në audio/video të ndeshjes.

---

### **Neni 102            Lojtarët, trajnerët dhe zyrtarët e pezulluar**

---

1. Lojtarët, trajnerët ose zyrtarët të cilët janë sanksionuar me pezullim nga ndeshjet zyrtare, ose me përjashtim nga pjesëmarrja në garë, janë rreptësisht të ndaluar të marrin pjesë në ndonjë ndeshje zyrtare gjatë gjithë kohëzgjatjes së zbatimit të sanksionit përkatës, përfshirë këtu:
  - a) janë rreptësisht të ndaluar të udhëtojnë së bashku me ekipin;
  - b) janë rreptësisht të ndaluar të hyjnë ose të qëndrojnë në ambientet e brendshme të stadiumit, në dhomën e zhveshjes, në fushën e lojës, dhe/ose në stolin e rezervave;
2. Lojtarët, trajnerët ose zyrtarët të cilët shkelin përcaktimet në paragrafin (1), këtu më sipër në këtë nen, do të sanksionohen me gjobë me një vlerë prej 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë, si dhe me pezullim nga ndeshja për 2 (dy) ndeshje.

---

### **Neni 103            Ndërprerja e ndeshjes**

---

1. Kur ndeshja ndërpritet për shkak të veprimit të Forcës Madhore, siç përcaktohet në Neni 144 - Forca Madhore, këtu më poshtë në këtë rregullore, FSHF do të caktojë datën se kur do të riluhet ndeshja e ndërprerë.
2. Ndeshja e ndërprerë në zbatim të paragrafit (1), këtu më sipër në këtë nen, do të riluhet e plotë.
3. Kur ndeshja ndërpritet për shkak të dëmtimit ose mosfunksionimit të ndriçimit të fushës së lojës, ndeshja do të riluhet duke nisur nga minuta e ndërprerë.
4. Masat disiplinore dhe teknike të vendosura gjatë ndeshjes së ndërprerë qëndrojnë në fuqi.

---

**Neni 104****Zhvillimi i ndeshjes pa spektatorë**

---

1. Ndeshjet të cilat janë sanksionuar të luhen pa spektatorë, do të zhvillohen në përputhje me përcaktimet si më poshtë:
  - a) brenda rrethimit të stadiumit nuk duhet të hyjë dhe/ose të qëndrojnë asnjë person që nuk është zyrtar i klubeve pjesëmarrëse, zyrtar i ndeshjes, përfaqësues i autorizuar i FSHF-së, punonjës i policisë së shtetit, ose punonjës përgjegjës për ruajtjen e sigurisë në stadium;
  - b) në tribunën VIP të stadiumit mund të qëndrojnë vetëm nga 10 (dhjetë) zyrtarë ose persona VIP, për secilin nga klubet pjesëmarrëse në ndeshjen përkatëse;
  - c) portat e hyrjes për në tribunat e stadiumit duhet të jenë të mbyllura.
2. Klubi vendas që shkel përcaktimet në paragrafin (1), këtu më sipër në këtë nen do të sanksionohet me gjobë me një vlerë prej 20,000 (njëzet mijë) lekë, dhe me zhvillim të ndeshjes pa spektatorë për të paktën 2 (dy) ndeshje.

---

**Neni 105****Aktivizimi i lojtareve të huaj**

---

1. Gjatë një ndeshje zyrtare nuk mund të aktivizohen njëkohësisht në fushën e lojës më shumë se 3 (tre) lojtare me shtetësi të huaj.
2. Lojtaret që janë shqipëtare të Kosovës dhe të Maqedonisë nuk konsiderohen si lojtare të huaja.

---

**Neni 106****Vuvuzelat**

---

1. Gjatë zhvillimit të ndeshjeve zyrtare ndalohet rreptësisht përdorimi i vuvuzelave apo mjeteve të ngjashme me ato.
2. Në rastin e verifikimit të përdorimit të vuvuzelave ose mjeteve të ngjashme me ato, arbitri i ndeshjes do të zbatojë përcaktimet e parashikuara në Nenin 57 – Sjellja ofenduese dhe fair play, paragrafi (1), pika (d), të Kodit të Disiplinës Sportive, të FSHF-së.

## Kreu IX      Zyrtarët e Ndeshjes

---

### Neni 107      Emërimi i zyrtarëve të ndeshjes

---

1. Përpara fillimit të sezonit futbollistik përkatës FSHF, do të përpilojë dhe do të shpallë listën e arbitrave dhe ndihmës arbitrave që plotësojnë kushtet për t'u emëruar si arbitra të ndeshjeve të ardhshme të kampionatit.
2. FSHF ka të drejtën të heqë nga lista emrin e çdo zyrtari ndeshje në çdo kohë gjatë zhvillimit të sezonit futbollistik.
3. FSHF do të emërojë zyrtarët e ndeshjes të cilët do të arbitrojnë çdo ndeshje zyrtare.
4. Pavarësisht zbatimit të paragrafit (3), këtu më sipër në këtë nen, FSHF ka të drejtë të ndryshojë emërimin e zyrtarëve të ndeshjes deri 12 (dymbëdhjetë) orë përpara fillimit të ndeshjes përkatëse.
5. Asnjë zyrtar ndeshje i emëruar për arbitrimin e ndonjë ndeshje zyrtare nuk duhet të ndërmarrë ndonjë veprimtari tjetër në ditën e ndeshjes pa marrë më parë miratimin me shkrim nga FSHF.

---

### Neni 108      Detyrimet e zyrtarëve të ndeshjes

---

1. Çdo zyrtar ndeshje duhet të njohë dhe të përmbushë detyrimet dhe përgjegjësitë e tij duke nënshkruar një deklaratë ku merr përsipër zbatimin e përcaktimeve të:
  - a) Ligjeve të Lojës;
  - b) rregullat e Federatës Shqiptare të Futbollit;
  - c) deklarinim me vërtetësi dhe në mënyrë të paanshme të të gjitha shkeljeve të përcaktimeve të kësaj rregulloreje, dhe të Kodit të Disiplinës Sportive, për të cilat zyrtari përkatës konstaton personalisht gjatë ndeshjeve zyrtare ose verifikon gjatë këqyrjes së



- materialeve audio-video, të ndeshjeve ku ka marrë pjesë;
- d) këtë rregullore.
- Zyrtarët e ndeshjes të cilët nuk deklarojnë me vërtetësi dhe në mënyrë të paanshme shkeljet e verifikuara gjatë ndeshjeve ku marrin pjesë, ose neglizhojnë duke mos i deklaruar shkeljet që kanë konstatuar personalisht, do të sanksionohen me gjobë me një vlerë jo më pak se 500,000 (pesëqind mijë) lekë, dhe pezullim nga pjesëmarrja në ndeshje për një periudhë jo më pak se 1 (një) vit, për kundërvajtjen e parë, dhe do të sanksionohen me gjobë me një vlerë jo më pak se 1,000,000 (një milion) lekë, dhe pezullim nga pjesëmarrja në ndeshje për një periudhë jo më pak se 5 (pesë) vjet, për kundërvajtjen e përsëritur.
  - Gjatë zhvillimit të ndeshjeve zyrtare ku marrin pjesë si të emëruar, zyrtarët e ndeshjes janë të detyruar të mbajnë me vete nga një kopje të kësaj rregulloreje, dhe të Kodit të Disiplinës Sportive të FSHF-së.

---

#### **Neni 109 Shpenzimet e zyrtarëve të ndeshjes**

---

- Shpenzimet për zyrtarët e ndeshjeve në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në ndeshjet zyrtare ku janë emëruar do të përballohen nga FSHF.
- FSHF mund të shpërblejë zyrtarët e ndeshjes rast pas rasti mbështetur në performancën në përkushtimin për trajnimin, edukimin dhe zhvillimin e tyre individual.
- Asnjë klub, zyrtar klubi, lojtar, ose ndonjë person tjetër nuk duhet t'i ofrojë ose t'i japë ndonjë shumë parash ose ndonjë favor, ndonjë zyrtari ndeshje.

---

#### **Neni 110 Procedura përpara fillimit të ndeshjes**

---

- Përpara fillimit të një ndeshje zyrtare në të cilën arbitri është emëruar, ai duhet që:
  - së bashku me zyrtarët e tjerë të ndeshjes, të paraqiten në stadiumin përkatës jo më vonë se 90 minuta përpara orarit të caktuar për fillimin e ndeshjes;
  - vendos për gjendjen e fushës së lojës ku do të luhet ndeshja përkatëse, dhe:
    - nëse arbitri së bashku me vëzhguesin dhe delegatin e ndeshjes e vlerëson se fusha e lojës nuk përmbush kushtet për luajtjen e ndeshjes, urdhëron shtyrjen e ndeshjes, ose fillimin e lojës me vonesë derisa të përmbushen kushtet;

- ii. nëse arbitri së bashku me vëzhguesin dhe delegatin e ndeshjes e vlerëson të nevojshme, urdhëron vijëzimin e fushës;
  - c) pranon formularët e ekipeve në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje;
  - d) lejon ndryshimin e formularit të ekipeve në rastin e dëmtimit të ndonjë lojtareje përpara fillimit të lojës;
  - e) kontrollon dhe miraton bazën materiale e cila do të shfrytëzohet gjatë zhvillimit të ndeshjes përkatëse;
  - f) verifikon nëse klubi vendas ka vënë në gatishmëri një top loje të ngjyrosur me ngjyrë portokalli;
  - g) të veshë uniformën e udhëzuar nga FSHF, duke verifikuar nëse uniforma përkatëse nuk përkon me të njëjtat ngjyra të uniformave të klubeve pjesëmarrëse në ndeshje;
  - h) të verifikojë përputhshmërinë e uniformave të klubeve pjesëmarrëse në ndeshje me përcaktimet në këtë rregullore;
  - i) të verifikojë nëse uniformat e veshura nga mbledhësit e topave anës fushës, të mos përkojnë me ndonjë nga uniformat e veshura nga lojtarët e klubeve pjesëmarrëse në ndeshje; dhe, nëse uniformat përkojnë, atëherë urdhëron largimin e mbledhësve të topave nga zona përreth fushës së lojës;
  - j) përcakton vendosjen e ndihmës arbitrave;
  - k) verifikon dhe garanton se ndihmës arbitrat mbajnë flamurin përkatës të udhëzuar nga FSHF;
  - l) së bashku me ndihmës arbitrat udhëheq lojtarët për të hyrë në fushën e lojës jo më vonë se 5 (pesë) minuta përpara fillimit të ndeshjes;
2. Në zbatim të pikës (f), këtu më sipër në paragrafin (1), të këtij neni, në rast të verifikimit të mungesës së topit të lojës me ngjyrë portokalli, klubi vendas sanksionohet me gjobë me një vlerë prej 10,000 (dhjetë mijë) lekë.
  3. Në zbatim të pikës (a), këtu më sipër në paragrafin (1), e këtij neni, në rast të vonesës së zyrtarëve të ndeshjes, zyrtarët e ndeshjes kundërvajtës sanksionohen me gjobë me një vlerë prej 20,000 (njëzet mijë) lekë, secili.

---

**Neni 111                      Zbatimi udhëzimeve**

---

1. Lojtarët dhe zyrtarët e klubeve duhet të zbatojnë me përpikmëri çdo urdhër ose udhëzim të arbitrit të ndeshjes.

1. Arbitri i ndeshjes duhet të paraqesë protokollin e ndeshjes dhe duhet të raportojë me shkrim duke përdorur Raporti i Arbitrit të Ndeshjes, jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë pas përfundimit të ndeshjes përkatëse, pranë FSHF-së, duke dhënë informacion si më poshtë:
  - a) rreth kushteve të ambjenteve të vëna në dispozicion për zyrtarët e ndeshjes;
  - b) rreth mbërritjes me vonesë të ndonjë zyrtari të ndeshjes duke dhënë arsyet përkatëse;
  - c) rreth gjendjes dhe kushteve të fushës së lojës;
  - d) rrethanat e shkaktimit të vonesës për fillimin e ndeshjes përkatëse;
  - e) informacion nëse ndonjë nga ekipet pjesëmarrëse paraqitet me më pak se numrin e plotë të lojtarëve për zhvillimin e ndeshjes përkatëse;
  - f) rreth shfrytëzimit të fanellave rezervë nga ndonjëri prej klubeve pjesëmarrëse në ndeshje;
  - g) rreth dështimit të ndonjë ekipi për të hyrë në fushën e lojës nën udhëheqjen e arbitrit të ndeshjes, në përputhje me përcaktimet në këtë rregullore;
  - h) rreth masave ndëshkimore të vendosura ndaj lojtareve gjatë zhvillimit të ndeshjes;
  - i) rreth zëvendësimit të arbitrit të ndeshjes nga ndonjë ndihmës arbitër dhe shpjegimi për nevojën e kryerjes së këtij zëvendësimi;
  - j) rreth performancës së ndihmës arbitrave dhe ndonjë zyrtari ndeshje të katërt;
  - k) rreth shkeljes së përcaktimeve të kësaj rregulloreje nga ndonjë klub, lojtare, zyrtar, menaxher, apo zyrtarët e tjerë të ndeshjes;
  - l) rreth shkeljes së përcaktimeve të Kodit të Disiplinës Sportive nga ndonjë klub, lojtare, zyrtar, menaxher, spektator/ët, apo zyrtarët e tjerë të ndeshjes.
2. Arbitri i ndeshjes dhe zyrtarët e ndeshjes duhet të raportojnë me shkrim çdo shkelje të rregulloreve ose statuteve të FSHF-së, brenda 24 (njëzet e katër) orësh nga zhvillimi i ndeshjes përkatëse. Mosraportimi në kohë konsiderohet shkelje e kësaj rregulloreje, dhe sanksionohet në përputhje me paragrafin (6), këtu më poshtë në këtë nen.
3. Klubi vendas është i detyruar të paraqesë kopje të regjistruar të

ndeshjes në audio dhe video, në format DVD (ose ndonjë format tjetër të udhëzuar nga FSHF), pranë arbitrit të ndeshjes përkatëse dhe pranë FSHF-së, jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë nga momenti i zhvillimit të ndeshjes zyrtare.

4. Klubi mik ka të drejtën të regjistrojë zhvillimin e ndeshjes ku merr pjesë në audio dhe video. Klubi mik është i detyruar të përdorë materialin audio dhe video të regjistruar, vetëm për qëllime të analizave sportive brenda klubit, dhe/ose për prova materiale për çështje të trajtuara pranë komisioneve juridike.
5. Çdo klub që shkel përcaktimet në paragrafin (3) dhe paragrafin (4), këtu më sipër në këtë nen, në rastin e shkeljes për herë të parë do të sanksionohet me gjobë me një vlerë prej 10,000 (dhjetë mijë) lekë; në rastin e shkeljes për herë të dytë do të sanksionohet me gjobë me një vlerë prej 20,000 (njëzet mijë) lekë; në rastin e shkeljes për herë të tretë do të sanksionohet me gjobë me një vlerë prej 30,000 (tridhjetë mijë) lekë. Çdo shkelje e mëtejshme do të sanksionohet në përputhje me Kodin e Disiplinës Sportive, të FSHF-së.
6. Në zbatim të paragrafit (1), dhe (2), këtu më sipër në këtë nen, arbitri ose zyrtari i ndeshjes që nuk dorëzon protokollin e ndeshjes brenda afateve të përcaktuara në këtë rregullore, do të sanksionohet me gjobë me një vlerë prej 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë, dhe në rastin e përsëritur të shkeljes së afatit, do të sanksionohet me gjobë me një vlerë prej 100,000 (njëqind mijë) lekë, si dhe me pezullim nga pjesëmarrja në ndeshjet zyrtare për jo më pak se 6 (gjashtë) muaj.

## **Kreu X            Trajtimi Shëndetësor**

---

### **Neni 113            Emërimi i personelit mjekësor**

---

1. Çdo klub është i detyruar të punësojë një mjek për ekipin me kohë të pjesëshme, një mjek për spektatorët me kohë të pjesëshme, dhe një fizioterapist me kohë të plotë.

---

### **Neni 114            Kualifikimi i personelit mjekësor**

---

1. Mjeku i ekipit i emëruar nga klubi duhet të jetë profesionist i licencuar në organet kompetente. Mjeku i ekipit duhet të zotërojë një çertifikatë për ndërhyrje të ndihmës së shpejtë.
2. Mjeku i spektatorëve i emëruar nga klubi duhet të jetë profesionist i licencuar në organet kompetente. Mjeku i spektatorëve duhet të zotërojë një çertifikatë për ndërhyrje të ndihmës së shpejtë.
3. Fizioterapisti i emëruar nga klubi duhet të jetë profesionist i licencuar në organet kompetente. Fizioterapisti duhet të zotërojë një çertifikatë për ndërhyrje të ndihmës së shpejtë.

---

### **Neni 115            Zhvillimi profesional i vazhdueshëm**

---

1. Mjekët dhe fizioterapisti të emëruar nga klubi duhet të ndjekin të paktën 36 (tridhjetë e gjashtë) orë në vit programe të zhvillimit profesional, dhe duhet të mbajnë të dhënat përkatëse për ndjekien e këtyre programeve. Klubi duhet të vërë në dispozicion informacionin në lidhje me zhvillimin profesional të mjekëve dhe fizioterapistit të klubit në çdo kohë kur kërkohet nga inspektorët e autorizuar të FSHF-së.

## 1. Në çdo ndeshje zyrtare:

- a) çdo klub pjesëmarrës duhet të garantojë pjesëmarrjen e mjekut të ekipit, dhe klubi vendas duhet të garantojë edhe pjesëmarrjen e mjekut të spektatorëve. Mjeku i ekipit dhe mjeku i spektatorëve të klubit vendas duhet të jenë në gatishmëri për një kohë që përfshihet nga 2 (dy) orë përpara fillimit të ndeshjes, deri në 2 (dy) orë pas përfundimit të ndeshjes përkatëse;
- b) çdo klub pjesëmarrës duhet të garantojë pjesëmarrjen e fizioterapistit përkatës;
- c) mjeku/ët dhe fizioterapisti/ët e secilit prej klubeve pjesëmarrëse në ndeshje duhet të qëndrojnë në stolin e rezervave të ekipit përkatës;
- d) klubi vendas duhet të garantojë gatishmërinë e dy infermierëve të kualifikuar të cilët duhet të jenë të gatshëm të ndërhyjnë menjëherë në rastin e verifikimit të dëmtimeve të lojtarëve në fushën e lojës;
- e) asnjë person tjetër, përveç mjekut/ët dhe/ose fizioterapistit/ët e klubit përkatës, dhe/ose infermierët që përcaktohen në paragrafin (1), pika (d) të këtij neni, nuk mund të trajtojnë nga ana shëndetësore lojtaret ose zyrtarët e ndeshjes në fushën e lojës;
- f) klubi vendas duhet të mbajë në gatishmëri para ndeshjes, gjatë ndeshjes, dhe pas ndeshjes përkatëse, të paktën dy barrela dhe nga dy punonjës të trajnuar për secilën barrelë për të nxjerrë nga fusha e lojës lojtaret ose zyrtarët e ndeshjes të dëmtuar;
- g) klubi vendas duhet të mbajë në gatishmëri një dhomë të trajtimit mjekësor të pajisur me të gjitha mjetet e domosdoshme të udhëzuara herë pas here nga FSHF;
- h) klubi vendas duhet të garantojë vendosjen në gatishmëri të një autoambulance të ndihmës së shpejtë, së bashku me personelin mjekësor të ndihmës së shpejtë, brenda ambjenteve të stadiumit, në mënyrë që të kryhet transportimi i lojtareve ose zyrtarëve të ndeshjes të dëmtuar që kanë nevojë për trajtim në spital;

## 2. Në çdo ndeshje zyrtare klubi vendas duhet të paraqesë liçencat dhe çertifikatat e personelit përkatës mjekësor.

---

**Neni 117**      **Dëmtimet në kokë**

---

1. Çdo lojtare, e cila është e angazhuar në një ndeshje zyrtare, në ndonjë ndeshje tjetër apo në seanca stërvitore, që pëson një dëmtim në kokë dhe nxirret nga fusha e lojës, nuk është i lejuar që të rifutet në fushën e lojës derisa të kontrollohet nga mjeku i licencuar dhe të deklarohet se lojtarja përkatës është në gjendje të luajë.

---

**Neni 118**      **Të dhënat mjekësore**

---

1. Çdo klub duhet të kryejë ekzaminimet mjekësore për të gjithë lojtarët që ka nën kontratë si dhe për lojtarët e moshave në përputhje me përcaktimet dhe kërkesat në Shtojca V – Ekzaminimet Mjekësore ndaj Lojtareve, bashkëngjitur kësaj rregulloreje. Të dhënat mjekësore duhet të ruhen në ambjentet e klubit dhe duhet të vihen në dispozicion për inspektim çdo përfaqësuesi të autorizuar nga FSHF.
2. Kur kryhen negociata midis klubeve për transferimin e ndonjë lojtarja nga njëri klub tek tjetri, si edhe për huazimin e përkohshëm të ndonjë lojtari, klubi i cili zotëron të drejtën e regjistrimit të lojtares është i detyruar t'i japë të dhënat mjekësore klubit tjetër, nëse ky i fundit i kërkon të dhënat me shkrim.

---

**Neni 119**      **Sigurimi shëndetësor**

---

1. Gjatë gjithë kohës që një klub është i antarësuar në FSHF, klubi është i detyruar të garantojë sigurimin shëndetësor të lojtareve përkatës që ka nën kontratë.

## **Kreu XI      Financat**

---

### **Neni 120      Detyrimet financiare të pjesëmarrjes në garë**

---

1. Çdo klub pjesëmarrës në Kampionatin Kombëtar të Futbollit, për Femra, në sezonin futbollistik 2017 - 2018, është i detyruar të paguajë detyrimet financiare si më poshtë:
  - a) tarifën e masës ndëshkimore paralajmëruese, karton i verdhë, në shumën 500 (pesëqind) lekë, për çdo karton të verdhë të marrë, të pagueshme jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë, nga data e zhvillimit të ndeshjes kur është marrë kartoni i verdhë përkatës;
  - b) tarifën e masës ndëshkimore largim nga ndeshja, karton i kuq, në shumën 1,000 (një mijë) lekë, për çdo karton të kuq të marrë, të pagueshme jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë, nga data e zhvillimit të ndeshjes kur është marrë kartoni i kuq përkatës;
2. FSHF ka të drejtë të kërkojë nga klubet pagimin e tarifave të tjera shtesë të pjesëmarrjes në garë, në rastin e verifikimit të rritjes së shpenzimeve të organizimit dhe zhvillimit të garës.

---

### **Neni 121      Llogaritë bankare të klubeve**

---

1. Çdo klub duhet të deklarojë pranë FSHF-së, një llogari bankare, e cila duhet të jetë hapur në emër të klubit, duke depozituar Deklarimi i Llogarisë Bankare të Klubit, bashkëngjitur kësaj rregulloreje, të nënshkruar nga të paktën 2 (dy) zyrtarë të klubit.
2. Kjo llogari bankare do të shfrytëzohet për të paguar shumat që klubi përkatës duhet të përfitojë nga FSHF, në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje.



---

**Neni 122**      **Kontabiliteti**

---

1. Të ardhurat e përftuara nga klubet do të shpërndahen nëpër periudhat kontabile, në përputhje me standardet e kontabilitetit të përcaktuara nga legjislati shqiptar në fuqi.

---

**Neni 123**      **Fuqia për të ndaluar**

---

1. Nëse FSHF verifikon se ndonjë klub nuk ka kryer pagesat e detyrimeve ndaj ndonjë kreditori të përcaktuar në paragrafin (3), këtu më poshtë në këtë nen, atëherë FSHF ka të drejtën të zbresë dhe të ndalojë shumën përkatëse nga të ardhurat që FSHF do të shpërndante për klubin debitor, dhe të njëjtën shumë do t'ia paguajë kreditorit ndaj të cilit klubi debitor ka detyrime.
2. Në zbatim të paragrafit (1), këtu më sipër në këtë nen, kreditorë do të konsiderohen si më poshtë:
  - a) një klub tjetër; ose
  - b) FSHF;
  - c) çdo njësi sipërmarrëse që ushtron detyra të caktuara në funksion të ndonjë marrëveshje me FSHF-në.

---

**Neni 124**      **Pasqyrat financiare të klubeve**

---

1. Çdo klub duhet të paraqesë pranë FSHF-së, brenda datës 1 Mars, të çdo sezoni futbollistik, kopje të pasqyrave financiare të vitit kontabël paraardhës, ose nëse klubi e konsideron të arsyeshme dhe/ose kërkohet nga FSHF, kopje të pasqyrave financiare të grupit të shoqërive ku bën pjesë klubi përkatës, së bashku me raportin e ekspertit kontabël dhe raportin e drejtuesit të klubit përkatës (në çdo rast pasqyrat financiare duhet të jenë të audituara në përputhje me dispozitat e legjislati në fuqi).
2. Në zbatim të paragrafit (1), këtu më sipër në këtë nen, pasqyrat financiare duhet të përmbushin kushtet si më poshtë:
  - a) të përfshihen brenda bilancit kontabël, si llogari kontabël të veçanta, ose të raportohen në pasqyra të veçanta nga bilanci kontabël, shumat gjithsej të llogarive të arkëtueshme ose të pagueshme për tarifën e kompensimit për transferimin ose huazimin e lojtarëve, dhe kështu kontraktuale;

- b) tek pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve të përfshihet një ndarje analitike e zërave të të ardhurave siç janë shitjet e biletave, sponsorizimet, reklamat, të drejtat televizive, të ardhurat nga veprimtaria tregtare, dhe të ardhura të tjera, ose të përpilohet një pasqyrë e veçantë duke pasqyruar në mënyrë analitike kategoritë e të ardhurave si më sipër në këtë pikë.
3. Nëse raporti i ekspertit kontabël nuk përmban informacionin e mjaftueshëm për FSHF-në, atëherë klubi, pas kërkesës me shkrim të FSHF-së, është i detyruar të paraqesë informacione ose raporte të tjera sipas nevojave të FSHF-së.
  4. Në rast se klubi nuk përmbush afatin e përcaktuar në paragrafin (1), këtu më sipër në këtë nen, atëherë klubi përkatës sanksionohet me gjobë me vlerë prej 5,000 (pesë mijë) LEKË për çdo ditë vonesë.
  5. Nëse klubi nuk ka përmbushur detyrimin e përcaktuar në paragrafin (1), këtu më sipër në këtë nen, edhe pas 60 (gjashtëdhjetë) ditësh vonesë që prej datës 1 Mars, atëherë klubi sanksionohet me gjobë me vlerë prej 100,000 (një qind mijë) LEKË, si dhe i hiqet e drejta për të kryer federimin e lojtarëve të rinj për dy periudha transferimi të njëpasnjëshme.
  6. Klubit i jepet një afat përfundimtar prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh nga data 1 Mars, dhe nëse klubi nuk e përmbush këtë afat atëherë klubi sanksionohet me gjobë me vlerë prej 300,000 (treqind) mijë LEKË.

---

## **Neni 125            Planifikimi financiar**

---

1. Çdo klub duhet të paraqesë pranë FSHF-së, brenda datës 31 Mars, të çdo sezoni futbollistik, planifikimin financiar të vitit kontabël në vijim, ose nëse klubi e konsideron të arsyeshme dhe/ose kërkohet nga FSHF, planifikimin financiar të grupit të shoqërive ku bën pjesë klubi përkatës, ku përfshihen parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, parashikimin e fluksit të parasë, parashikimin e bilancit kontabël, si dhe raporte të tjera që kanë lidhje me planifikimin financiar.
2. Raporti dhe pasqyrat e planifikimit financiar duhet të përpilohen në përputhje me përcaktimet si më poshtë:
  - a) të përgatiten në përputhje me standardet kombëtare të kontabilitetit në fuqi;
  - b) të miratohen me shkrim nga bordi drejtues (organi drejtues më i lartë i klubit) i klubit përkatës;

- c) shpjegim me shkrim në lidhje me supozimet dhe risqet kryesore të marra në konsideratë gjatë hartimit të planifikimit financiar.
3. Në rast se klubi nuk përmbush afatin e përcaktuar në paragrafin (1), këtu më sipër në këtë nen, atëherë klubi përkatës sanksionohet me gjobë me vlerë prej 2,000 (dy mijë) LEKË për çdo ditë vonesë.
  4. Nëse klubi nuk ka përmbushur detyrimin e përcaktuar në paragrafin (1), këtu më sipër në këtë nen, edhe pas 60 (gjashtëdhjetë) ditësh vonesë që prej datës 1 Mars, atëherë klubi sanksionohet me gjobë me vlerë prej 50,000 (pesëdhjetë mijë) LEKË, si dhe i hiqet e drejta për të kryer federimin e lojtareve të reja për një periudhë transferimi.
  5. Klubit i jepet një afat përfundimtar prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditësh nga data 31 Mars, dhe nëse klubi nuk e përmbush këtë afat atëherë klubi sanksionohet me gjobë me vlerë prej 50,000 (pesëdhjetë) mijë LEKË.

---

**Neni 126**                      **Detyrimet tatimore**

---

1. Çdo klub duhet të deklarojë pranë FSHF-së, çdo 3 (tre) muaj duke filluar nga muaji përpara fillimit të sezonit futbollistik e në vazhdim, përmbushjen e detyrimeve tatimore që rrjedhin në zbatim të legjislacionit tatimor në fuqi. Së bashku me deklaratën, klubi duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore përkatëse në lidhje me detyrimet tatimore që klubi ka shlyer ose ka pa shlyer.
2. Me kërkesë të FSHF-së, çdo klub duhet të:
  - a) konfirmojë me shkrim, duke nënshkruar të paktën nga dy zyrtarë të klubit, nëse ka detyrime tatimore të pushyera ose jo;
  - b) lejojë organet tatimore përkatëse, nëpërmjet lëshimit të deklaratës me shkrim, të japin informacionin e kërkuar nga FSHF pranë këtyre organeve tatimore, në lidhje me situatën e detyrimeve tatimore të klubit.
3. Nëse FSHF verifikon se ndonjë klub nuk ka shlyer detyrimet tatimore duke tejkaluar afatet përkatëse për më shumë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike, atëherë FSHF do të sanksionojë klubin kundërvajtës me heqjen e të drejtës së federimit të lojtareve të reja për periudhën e transferimit pasardhës.
4. Përrjashtohen nga zbatimi i paragrafit (3), këtu më sipër në këtë nen, klubet të cilët vërtetojnë me shkrim si më poshtë:
  - a) se është lidhur një marrëveshje me shkrim midis klubit dhe

- organeve tatimore përkatëse në lidhje me shtyrjen e afatit për shlyerjen e detyrimeve tatimore; ose
- b) se klubi ka pretendime në lidhje me detyrimin tatimor përkatës, dhe për këtë çështje klubi ka filluar një procedim administrativ ose ka hapur çështje civile pranë gjykatës, duke paraqitur pranë FSHF-së dokumentacionin mbështetës përkatës.

---

**Neni 127**                      **E drejta për të inspektuar**

---

1. FSHF ka të drejtë të inspektojë vetë ose nëpërmjet ndonjë personi të autorizuar prej saj, të gjitha të dhënat dhe pasqyrat financiare dhe kontabile, për çdo klub që dyshon se mund të ketë shkelur ndonjë prej përcaktimeve të kësaj rregulloreje.

## **Kreu XII            Kontrolli i të Dhënave Personale**

---

### **Neni 128            Detyrimi për deklarimin e të dhënave personale**

---

1. Çdo klub është i detyruar të deklarojë të dhënat personale të personelit që punësohet pranë klubit përkatës, në përputhje me procedurën e përcaktuar këtu në këtë rregullore.
2. Çdo zyrtar i klubit, i cili është i punësuar ose do të punësohet nga klubi, duhet të pranojë dhe të deklarojë me shkrim, se i jep të drejtën FSHF-së që të kontrollojë, hetojë, dhe verifikojë të dhënat e tij personale.

---

### **Neni 129            Zyra e deklarimit të të dhënave personale**

---

1. Pranë FSHF-së, do të funksionojë Zyra e Deklarimit të të Dhënave Personale, e cila kryen funksionet si më poshtë:
  - a) pranon, trajton dhe arkivon deklaratat e të dhënave personale të plotësuara nga klubet;
  - b) shërben njësitë ose organet e tjera të FSHF-së, në lidhje me të dhënat personale të deklaruara nga personeli i klubeve të regjistruara pranë kësaj zyre;
  - c) kryen monitorimin e klubeve në përputhje me përcaktimet e Neni 133, këtu më poshtë në këtë rregullore.

---

### **Neni 130            Koordinatori i deklarimit të të dhënave personale**

---

1. Në zbatim të përcaktimeve në paragrafin (1), në Neni 129, çdo klub duhet të emërojë një zyrtar të vetin, i cili do të koordinojë procesin e deklarimit të të dhënave personale.

2. Emërimi i zyrtarit përkatës si koordinator i procesit të deklarimit të të dhënave personale kryhet duke plotësuar dhe dorëzuar pranë FSHF-së. Deklarimi i Koordinatorit të të Dhënave Personale, bashkëngjitur kësaj rregulloreje, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga dita e emërimit.
3. Koordinator i procesit të deklarimit përmbush funksionet si më poshtë:
  - a) garanton zbatimin e përcaktimeve të kësaj rregulloreje ose udhëzimeve të posaçme të FSHF-së, gjatë procesit të deklarimit të të dhënave personale të zyrtarëve të klubit;
  - b) nënshkruan formularët e deklarimit të të dhënave personale të depozituara pranë FSHF-së;
  - c) do të veprojë si pika kryesore e kontaktit midis klubit dhe FSHF-së për të gjitha çështjet që kanë lidhje me shërbimin e deklarimit të të dhënave personale.

---

**Neni 131                      Punësimi dhe emërimi i zyrtarëve**

---

1. Në zbatim të përcaktimeve në Neni 129, asnjë person nuk duhet të punësohet ose të emërohet si zyrtar i klubit derisa:
  - a) ajo të kryejë deklarimin e të dhënave personale duke plotësuar dhe nënshkruar formularin 116: Deklarimi i të Dhënave Personale, bashkëngjitur kësaj rregulloreje;
2. Koordinator i deklarimit të të dhënave personale, kontrollon të dhënat e deklaruara nga personi përkatës që kërkon të punësohet ose emërohet si zyrtar i klubit, duke verifikuar përputhshmërinë e tyre me përcaktimet e kësaj rregulloreje, ose përcaktime të tjera të udhëzuara nga FSHF.
3. Pas verifikimit të kryer në përputhje me paragrafin (2), këtu më sipër në këtë nen, koordinatori i deklarimit të të dhënave personale, dorëzon formularin përkatës pranë FSHF-së.

---

**Neni 132                      Monitorimi**

---

1. FSHF do të monitorojë klubet nëse janë në përputhje me përcaktimet e këtij kreu të rregullores, duke kryer vizita pranë ambjenteve të klubeve rast pas rasti gjatë sezonit futbolistik përkatës.
2. Çdo vizitë e kryer do të raportohet me shkrim tek klubi, ku kryhet vizita përkatëse.

3. Gjatë vizitave klubi duhet të vendosë në dispozicion të dhënat si më poshtë:
  - a) formularët e deklarimit të të dhënave personale të plotësuara dhe të dorëzuara pranë FSHF-së;
  - b) listën e personelit të punësuar nga klubi.

---

**Neni 133                      Ambjentet dhe akomodimi**

---

1. Klubet duhet të mbajnë në funksionim ambiente stërvitore për ekipet e moshave, brenda territorit të njësisë vendore ku është regjistruar klubi përkatës. Ambjentet dhe akomodimi minimal që duhet të mbajë në funksionim një klub janë si më poshtë:
  - a) të paktën 2 (dy) fusha stërvitore me përmasat minimale 90 (nëntëdhjetë) metra në gjatësi, dhe 60 (metra) në gjerësi;
  - b) ambiente të kontrollit dhe trajtimit shëndetësor të mjaftueshme;
  - c) dhoma zhveshje, nga 1 (një) dhomë për çdo grupmoshë;
  - d) duše dhe banjo të cilat shfrytëzohen vetëm nga lojtarët e ekipeve të moshave.
2. Klubet të cilat nuk përmbushin përcaktimet në paragrafin (1), këtu më sipër në këtë nen, do të sanksionohen me gjobë me vlerë prej 10,000 (dhjetë mijë) LEKË.
3. Me zbatimin e paragrafit (2), këtu më sipër në këtë nen, klubeve u vendoset një afat paralajmërues prej 270 (dyqind e shtatëdhjetë) ditësh, për përmbushjen e përcaktimeve të paragrafit (1), të këtij neni. Në rast të mos përmbushjes së përcaktimeve të paragrafit (1), këtu më sipër në këtë nen, pas përfundimit të afatit paralajmërues, klubi kundërvajtës sanksionohet me gjobë me vlerë prej 20,000 (njetzet mijë) LEKË.

---

**Neni 134                      Kriteret e personelit**

---

1. Personeli i punësuar për administrimin e ekipeve të moshave duhet të kryejnë të paktën 36 (tridhjetë e gjashtë) orë, programe trajnimi dhe kualifikimi çdo vit, për çdo punonjës të punësuar. Zhvillimi i programeve të trajnimit dhe të kualifikimit dokumentohet, dhe i vendoset në dispozicion delegatëve të FSHF-së gjatë kontrolleve përkatëse që kryen FSHF, në zbatim të kësaj rregulloreje.
2. Përcaktimet e paragrafit (1), këtu më sipër në këtë nen, zbatohen për personelin si më poshtë:

- a) edukatorët dhe mësuesit;
  - b) fizioterapistët dhe mjekët;
  - c) drejtuesit administrativ;
  - d) trajnerët.
3. Personeli minimal që duhet të punësojë një klub për zhvillimin e ekipeve të moshave është si më poshtë:
- a) 1 (një) punonjës administrativ, që kryen funksione administrative dhe mirëmban të dhënat dhe dokumentacionin që ka lidhje me ekipet e moshave, i punësuar me kohë të plotë;
  - b) 1 (një) fizioterapist,
  - c) 1 (një) edukator/mësues, që kryen funksione të mësimdhënies dhe edukimit për lojtarët e ekipeve të moshave;
  - d) 1 (një) mjek të kualifikuar dhe të licencuar, i punësuar me kohë të pjesëshme;
  - e) nga 1 (një) trajner, të punësuar me kohë të plotë ose me kohë të pjesëshme, për çdo 15 (pesëmbëdhjetë) lojtare të regjistruar;
  - f) 1 (një) trajner ose specialist për trajnimin e portierëve.
4. Trajnerët e punësuar duhet të jenë të pajisur të paktën me licencë profesionale “UEFA B” .
5. Klubet të cilat nuk përmbushin përcaktimet në paragrafet (1), (2), (3), dhe (4), këtu më sipër në këtë nen, do të sanksionohen me gjobë me vlerë prej 10,000 (dhjetë mijë) LEKË. Në çdo rast vendoset një afat për rregullim jo më shumë se 45 (dyzet e pesë) ditë.
6. Trajneri duhet të jetë anëtar i Shoqatës së Trajnerëve të miratuar nga FSHF në të kundërt nuk rregjistrohet

---

**Neni 135                      Programi stërvitor dhe edukues**

---

1. Çdo klub duhet të përgatisë dhe të mirëmbajë një program zhvillimi për ekipet e moshave që përmban trajnimin teknik dhe edukimin teorik të lojtareve. Programi duhet të mbështetet në udhëzimet e lëshuara kohë pas kohe nga FSHF.

---

**Neni 136                      Kriteret e trajnimit**

---

1. Kohëzgjatja minimale e seancave stërvitore të zhvilluara në 1 (një) javë gjatë sezonit futbollistik, duhet të jetë si më poshtë:
- a) për grupmoshat U8, dhe U10, duhet të kryhen 3 (tre) orë në javë



- të ndara në 2 (dy) seanca stërvitore;
- b) për grupmoshat U12, dhe U15, duhet të kryhen 5 (pesë) orë në javë të ndara në 3 (tre) seanca stërvitore;
  - c) për grupmoshat U17, dhe U19, duhet të kryhen 12 (dymbëdhjetë) orë në javë.

---

**Neni 137            Mirëqënia dhe mbarëvajtja e lojtarëve**

---

- 1. Klubet duhet të ekzaminojnë, të monitorojnë dhe të regjistrojnë treguesit kryesorë të rritjes dhe zhvillimit fiziologjik të lojtarëve të ekipeve të moshave, në përputhje me kriteret mjekësore të publikuara ose të udhëzuara nga FSHF, rast pas rasti.
- 2. Të dhënat e regjistruara për çdo lojtar individualisht, duhet të mirëmbahen nga klubet për një periudhë jo më pak se 10 (dhjetë) vjet. Këto të dhëna duhet t'u vihen në dispozicion delegatit/ve të autorizuar nga FSHF për kryerjen e kontrolleve ose monitorimit të klubeve.
- 3. Klubet që shkelin përcaktimet në paragrafet (1), dhe (2), këtu më sipër në këtë nen, sanksionohen me gjobë me një vlerë prej 20,000 (njëzet mijë) LEKË, për çdo rast të verifikuar.

---

**Neni 138            Monitorimi i ekipeve të moshave**

---

- 1. FSHF do të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme zhvillimin e veprimtarisë stërvitore dhe edukuese të ekipeve të moshave të klubeve pjesëmarrëse në Kampionatin Kombëtar të Futbollit, për Futbollin e Femrave.

## **Kreu XIII      Përcaktimet Përfundimtare**

---

### **Neni 139      Qëllimi i rregullores, mangësitë, dhe precedentët**

---

1. Kjo rregullore është e zbatueshme nga çdo subjekt që përshkruhet në përcaktimet e kësaj rregulloreje.
2. Nëse ka ndonjë mangësi në këtë rregullore, organet përkatëse do të marrin vendimet në përputhje me precedentët e krijuar më parë, dhe në mungesë të precedentëve, në përputhje me rregullat që ata mund të formulonin për çështjen në fjalë sikur të ishin legjislatorë.

---

### **Neni 140      Nënshkrimi i dokumentacionit**

---

1. Në të gjitha rastet që klubi dërgon pranë FSHF, ndonjë dokument, formular të përcaktuar sipas kësaj rregulloreje, korrespondencë, ose çdo komunikim tjetër me shkrim, duhet të jenë të nënshkuara nga persona të autorizuar nga klubi në përputhje me përcaktimet në Neni 10 - Përfaqësimi i klubeve, këtu më sipër në këtë rregullore.
2. Nënshkrimi i dokumentacionit do të konsiderohet i vlefshëm vetëm kur shoqërohet me vulën e shoqërisë, dhe dokumenti mban numrin e protokollit të klubit përkatës.

---

### **Neni 141      Zbatimi i sanksioneve**

---

1. Sanksionet e parashikuara këtu në këtë rregullore do të zbatohen në përputhje me përcaktimet përkatëse të kësaj rregulloreje, dhe në përputhje me përcaktimet e Kodit të Disiplinës Sportive, të FSHF-së.
2. Vendimet për vendosjen e sanksioneve në rast të shkeljeve të verifikuara do të merren në përputhje me përcaktimet e Kodit të Disiplinës Sportive, të FSHF-së.

3. Organet juridike do të fillojnë procedimet për vendim-marrje pas raportimit nga Sektori i Garave, nga zyrtarët e ndeshjes, ose nga palët e interesuara, në përputhje me përcaktimet e Kodit të Disiplinës Sportive, tës FSHF-së.

---

**Neni 142 Reduktimi i sanksioneve me gjobë**

---

1. Sanksionet me gjobë të parashikuara në këtë rregullore do të reduktohen për veprimtaritë futbolistike të kategorive të ndryshme si më poshtë:
  - a) për Kategorinë e Futbollit të Femrave vlerat e sanksioneve me gjobë të përcaktuara në këtë rregullore do të reduktohen në 1/3 (një të tretën).

---

**Neni 143 Forca madhore**

---

1. Në kuptim dhe në zbatim të kësaj rregulloreje, Forcë Madhore (force majeure), konsiderohet ndodhia e ngjarjeve si më poshtë:
  - a) akte të Zotit, siç janë:
    - (i) stuhitë ose rrebeshet të cilat bëjnë të papërshtatshme fushën e lojës për vazhdimin e ndeshjes;
    - (ii) shkarkesat elektrike (rrufe, vetëtima, dhe shkarkesa nga rrjeti i energjisë elektrike) që dëmtojnë në mënyrë të pariparueshme impiantin e ndriçimit të fushës së lojës;
    - (iii) tërmetet që dëmtojnë strukturat dhe impiantet e stadiumit ose fushës së lojës;
    - (iv) përmbytjet që tejkalojnë mundësitë e kontrollit nga sistemi i kanalizimeve publike;
  - b) akte të shtetit, siç janë:
    - (i) shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme;
    - (ii) urdhërat e policisë së shtetit për ndërprerjen e ndeshjes zyrtare;
  - c) akte terroriste.

---

**Neni 144 Mbartja e pezullimit nga ndeshja**

---

1. Pezullimi nga ndeshja mbartet nga një raund në një tjetër, nga një sezon në një sezon tjetër, dhe nga një garë ose kampionat në një garë ose kampionat tjetër të organizuar nga FSHF.

2. Pezullimi nga ndeshja që ka rezultuar nga marrja e disa masave ndëshkimore paralajmëruese (karton i verdhë) në ndeshje të ndryshme, nuk mund të mbartet nga një garë ose kampionat në një tjetër.

---

**Neni 145            Ndryshimet e rregullores**

---

1. Kjo rregullore mund të ndryshohet nga FSHF, rast pas rasti, nëpërmjet lëshimit dhe/ose shpalljes të qarkoreve përkatëse.
2. Ndryshimet hyjnë në fuqi 7 (shtatë) ditë pas lëshimit dhe/ose pas shpalljes së qarkores përkatëse.

---

**Neni 146            Zbatimi i rregullores**

---

1. Kjo rregullore hyn në fuqi në Gusht, 2017

Tiranë, Gusht 2017

Për Komitetin Ekzekutiv të FSHF-së

Presidenti  
Armand Duka

Sekretari i Përgjithshëm  
Ilir Shulku

### **Akt – Marrëveshje**

Kjo Akt-Marrëveshje (këtu e më poshtë marrëveshja) lidhet midis Palëve si më poshtë:

Federatës Shqiptare të Futbollit, me adresë në Tiranë, Rruga “Labinoti”, e regjistruar si Person Juridik pranë Gjykatës së shkallës së parë Tiranë, me Vendim Nr. \_\_\_\_\_, dt. \_\_/\_\_/\_\_\_\_\_, ligjërisht e përfaqësuar nga Presidenti, z.Armando Duka, e cila këtu e në vijim do të quhet FSHF.

Dhe

Klubit të Futbollit \_\_\_\_\_, i përfaqësuar nga z. \_\_\_\_\_, lindur më \_\_/\_\_/\_\_\_\_\_, në \_\_\_\_\_, Shqipëri, me rezidencë në \_\_\_\_\_, me shtetësi \_\_\_\_\_, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me dokument identifikimi letërnjoftim ID, me nr. \_\_\_\_\_, këtu e në vijim i quajtur KLUBI.

Palët bien dakort si më poshtë:

#### **I) Qëllimi dhe Kushtet e Përgjithshme të Marrëveshjes**

- i) Kjo marrëveshje rregullon ligjërisht marrëdhëniet midis palëve në këtë marrëveshje, gjatë zhvillimit të Kampionatit Kombëtar të Futbollit, për sezonin \_\_\_\_\_, për Kategorinë \_\_\_\_\_.
- ii) Pjesë përbërëse dhe e pandarë të kësaj marrëveshje janë:
  - a) Statuti dhe rregulloret e Federatës Shqiptare të Futbollit.
  - b) Kodi i Disiplinës Sportive të FSHF-së.
  - c) Rregullorja e Veprimtarisë Futbollistike, sezoni 2017-2018, Kampionati Kombëtar i Futbollit për Femra.
  - d) Statutet dhe Rregulloret e UEFA dhe FIFA.
  - e) Ligjet e Lojës të lëshuara nga IFAB.
- iii) Klubi pranon zbatimin me përpikmëri të statuteve dhe rregulloreve të përmendura më sipër për gjithçka që është në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi dhe legjislacionin sportiv në veçanti.

- iv) Klubi pranon autoritetin disiplinor të FSHF-së dhe i nënshtrohet vendimeve të organeve juridike të FSHF-së, si dhe të autoriteteve të futbollit të përmendura më sipër (UEFA dhe FIFA) për gjithçka që është nën juridiksionin e tyre.
  - a) Në zbatim të këtij paragrafi, klubi pranon vendosjen e sanksioneve financiare ndaj tij deri në vlerat e përcaktuara në rregulloret e FSHF-së, dhe në Kodin e Disiplinës Sportive të FSHF-së.
- v) Klubi merr përsipër dhe mban përgjegjësi për veprimet e kryera ose të mbetura në tentativë, nga zyrtarët, lojtarët, agjentët, përfaqësuesit dhe tifozët e vet përkatës, të cilat bien ndesh ose shkelin përcaktimet e dokumenteve rregulluese të përcaktuara në paragrafin (ii) këtu më sipër në këtë nen.

## **II) Kohëzgjatja e Marrëveshjes**

- i) Kjo marrëveshje hyn në fuqi më datë \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_\_\_, dhe lidhet për një periudhë deri në fillimin e sezonit futbollistik pasardhës.

## **III) Detyrimet dhe Përgjegjësitë e Klubit**

- i) Klubi mban përgjegjësi për zbatimin e përcaktimeve në Rregulloren e Veprimtarisë Futbollistike, Kampionati Kombëtar i Futbollit, për sezonin 2017-2018.
- ii) Klubi detyrohet të paguajë brenda afateve të përcaktuara në rregulloret përkatëse, ose afatet e vendosura rast pas rasti nga FSHF, të gjitha detyrimet financiare që rrjedhin nga përcaktimet e rregulloreve të FSHF-së, ose që rrjedhin nga vendimet disiplinore të organeve juridike për sanksionimin financiar të klubit.
- iii) Klubi detyrohet të ruajë emrin e mirë të FSHF-së dhe të mos kryejë asnjë veprim që mund të dëmtojë FSHF-në, veçanërisht para dhe gjatë veprimtarive në të cilat Klubi merr pjesë.
- iv) Klubi detyrohet të marrë pjesë në të gjitha ndeshjet e përcaktuara në kalendarin e shpallur në Rregulloren e Veprimtarisë Futbollistike, për sezonin 2017-2018, Kampionati Kombëtar i Futbollit të Femrave.

## **IV) Detyrimet dhe Përgjegjësitë e FSHF-së**

- i) FSHF mbulon me siguracion të gjitha risqet në lidhje me përgjegjësitë që ka FSHF për organizimin dhe zhvillimin e ndeshjeve zyrtare, siç përcaktohet në këtë rregullore. FSHF ka përgjegjësi për të mbuluar me siguracion:

- a) aksidentet e shkaktuara ndaj delegatit/ve të ndeshjes jashtë kohëzgjatjes së ndeshjes zyrtare përkatëse.
- ii) Nëpërmjet organeve të kontrollit të brendshëm, FSHF do të garantojë zbatimin me përpikmëri të përcaktimeve të Rregullores së Veprimtarisë Futbollitike, për sezonin 2017-2018, të Kampionatit Kombëtar të Futbollit për Femra, nga të gjithë punonjësit, zyrtarët (përfshirë këtu dizajnerin e arbitrave, arbitrat, kryevëzhguesin e arbitrave, vëzhguesit e arbitrave, delegatët e ndeshjes, dhe çdo person tjetër që përfaqëson FSHF-në, në ndeshjet zyrtare), agjentët, inspektorët ose përfaqësuesit e FSHF-së që ushtrojnë funksione në zbatim të kësaj rregulloreje, duke vënë para përgjegjësisë çdo shkelës ose kundërvajtës. Në zbatim të këtij paragrafi, punonjësit, zyrtarët, agjentët, inspektorët ose përfaqësuesit e FSHF-së që shkelin ndonjë përcaktim të kësaj rregulloreje, me vetëdije ose nga pakujdesia:
  - a) do të shkarkohen nga pozicioni i punës përkatëse;
  - b) do të ngarkohen me përgjegjësi materiale për pasojat që shkaktojnë shkeljet ose kundërvajtjet e tyre ndaj klubeve ose të tretëve.
- iii) FSHF do të garantojë kualifikimin profesional të të gjithë punonjësve, zyrtarëve (përfshirë këtu dizajnerin e arbitrave, arbitrat, kryevëzhguesin e arbitrave, vëzhguesit e arbitrave, delegatët e ndeshjes, dhe çdo person tjetër që përfaqëson FSHF-në, në ndeshjet zyrtare), agjentëve, inspektorëve ose përfaqësuesëve të FSHF-së që ushtrojnë funksione në zbatim të kësaj rregulloreje, duke kryer trajnime dhe provime (testime) ndaj personave të përmendur në këtë paragraf, në mënyrë të vazhdueshme, në lidhje me zbatimin e kësaj rregulloreje dhe rregulloreve të tjera të zbatueshme në lidhje me zhvillimin e Kampionatit Kombëtar të Futbollit të Femrave. Në zbatim të këtij paragrafi, FSHF ka përgjegjësi të skualifikojë çdo person që nuk i nënshtrohet provimeve (testimeve) në mënyrë të suksesshme.

**V) Dispozita Përfundimtare**

- i) Çdo shtesë, ndryshim ose anulim i ndonjë pjese të Marrëveshjes duhet të bëhet me shkrim nga të dyja Palët. Marrëveshjet me gojë nuk janë të vlefshme.
- ii) Kjo marrëveshje hartohet në dy kopje origjinale, nga një për secilën Palë.
- iii) Pavlefshmëria e ndonjë klauzole të veçantë nuk ndikon në vlefshmërinë e pjesës tjetër të marrëveshjes.

*Vendi dhe Data*

*Vendi dhe Data*

*Nënshkrimi i FSHF*

*Nënshkrimi i Klubit*



---

## **SHTOJCA II Kontratë Shërbimi e Lojtares**

---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. \_\_\_\_\_ Rep.

Nr. \_\_\_\_\_ Kol.

### **Kontratë punësimi**

e lidhur midis klubit të futbollit \_\_\_\_\_ dhe lojtares

\_\_\_\_\_

Kjo Kontratë Shërbimi (këtu e më poshtë Kontrata) lidhet midis Palëve si më poshtë:

SHOQËRISË “\_\_\_\_\_”, me adresë në \_\_\_\_\_, e regjistruar si Person Juridik pranë Gjykatës së shkallës së parë Tiranë, me Vendim Nr. \_\_\_\_\_, dt. \_\_\_\_\_, ligjërisht e përfaqësuar nga Administratori, \_\_\_\_\_, e cila këtu e në vijim do të quhet KLUBI.

Dhe

Lojtares \_\_\_\_\_,

e cila këtu e në vijim do të quhet LOJTARIA.

Palët bien dakort si më poshtë:

### **I) Qëllimi dhe Kushtet e Përgjithshme të Kontratës së Shërbimit**

- i) Kjo kontratë rregullon ligjërisht marrëdhëniet midis palëve në këtë kontratë punësimi.
- ii) Pjesë përbërëse dhe e pandarë të kësaj kontrate janë:
  - a) Statuti dhe rregulloret e Federatës Shqiptare të Futbollit.
  - b) Statutet dhe Rregulloret e UEFA-s dhe FIFA-s (ku përfshihen dhe Ligjet e Lojës të lëshuara nga IFAB).
  - c) Marrëveshjet kolektive të cilat mund të lidhen në të ardhmen.
  - d) Kodi i Etikës, Kodi i Sjelljes, Kodi i Veshjes, Kodi i Vlerave, Misioni dhe Vizioni, dhe rregulloret e Klubit.
- iii) Lojtaria pranon zbatimin me përpikmëri të statuteve dhe rregulloreve të përmendura më sipër për gjithçka që është në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi dhe legjislacionin sportiv në

veçanti. Lojtaria pranon se rregulloret e miratuara prej Klubit ju vunë në dispozicion dhe pasi i lexoi, ju shpjeguan përpara nënshkrimit të kontratës. Rregulloret e FSHF-së, UEFA-s FIFA-s, dhe rregulloret e Klubit, i janë vënë në dispozicion në selinë e Klubit.

- iv) Lojtaria pranon autoritetin disiplinor të Klubit dhe i nënshtrohet vendimeve të organeve të administrimit të Klubit që janë në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe rregulloret e futbollit, si dhe të autoriteteve të futbollit të përmendura më sipër (Federata Shqiptare e Futbollit, UEFA dhe FIFA) për gjithçka që është nën juridiksionin e tyre.

## **II) Kohëzgjatja e Kontratës**

- i) Kjo Kontratë lidhet për një periudhë kohe duke filluar nga data \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_, deri më datën \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_.
- ii) Vlefshmëria e kësaj Kontrate varet drejtpërdrejt nga kushtet si më poshtë:
  - a) Konfirmimin nga FSHF-ja, nese Lojtaria gëzon të drejtën të aktivizohet në veprimtaritë zyrtare të Klubit;
  - b) Rezultatet e kontrollit mjekësor.
- iii) Orët e punës së lojtares variojnë sipas kërkesës së arsyeshme të Klubit për të përmbushur detyrat e tij dhe Lojtares nuk i njihet e drejta të kërkojë shpërblim shtesë për punë të kryer jashtë orarit normal të punës.
- iv) Vendi i punës do të jetë në ambientet stërvitore dhe në ambientet e tjera të Klubit, dhe pavarësisht kësaj, Klubi ka të drejtë t'i kërkojë Lojtares të luajë dhe të kryejë detyrat e tij në çdo vend tjetër të përcaktuar nga Klubi.

## **III) Detyrimet e Përgjithshme të Lojtarit**

- i) Lojtaria do të mbajë përgjegjësi kontraktuale për përmbushjen e objektivave të ndryshëm të Klubit të vendosura dhe të shpallura para çdo veprimtarie futbollistike.
- ii) Lojtaria detyrohet të ruajë emrin e mirë të Klubit dhe të mos kryejë asnjë veprim që mund të dëmtojë Klubin, veçanërisht para dhe gjatë veprimtarive në të cilat Klubi merr pjesë.
- iii) Lojtaria është e detyruar të marrë pjesë në:

- a) Të gjitha ndeshjet, veprimtaritë dhe stërvitjet e Klubit (në veprimtaritë e parashikuara për të gjitha lojtarët, ashtu edhe për veprimtaritë ose stërvitjet e parashikuara individualisht për Lojtaren në veçanti).
- b) Të gjitha mbledhjet e lojtarëve dhe në çdo organizim tjetër me qëllim përgatitjen për ndeshje dhe veprimtari. Kjo do të zbatohet edhe në rastet kur pjesëmarrja e saj si lojtare ose lojtare rezervë nuk ishte parashikuar.
- iv) Në mënyrë të arsyeshme t'i nënshtrohet trajtimit atletik dhe terapeutik të udhëzuar prej personit të autorizuar nga Klubi.
- v) Të luajë duke shfrytëzuar aftësitë e tij më të mira gjatë gjithë kohës.
- vi) Të japë të gjitha autorizimet e nevojshme për lëshimin në favor të Klubit të të gjitha të dhënave të tij mjekësore dhe të tregojë të njëjtën gatishmëri gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj kontrate.
- vii) Të luajë futboll vetëm për Klubin, ose siç autorizohet nga Klubi, ose siç parashikohet nga Rregulloret e FIFA-s, UEFA-s dhe FSHF-së.
  - a) T'i nënshtrohet menjëherë ekzaminimeve mjekësore, nëse kjo i kërkohet nga Klubi dhe t'i nënshtrohet trajtimeve të tilla të përcaktuara nga këshilltarët mjekësorë të Klubit.
- viii) Të marrë pjesë në të gjitha udhëtimet brenda dhe jashtë vendit, duke përdorur mënyrën e transportit të organizuar nga Klubi.
- ix) Të tregojë kujdes gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, për të gjitha mjetet dhe pajisjet e dhëna në përdorim nga Klubi si dhe t'ia kthejë ato Klubit sipas rastit ose pas përfundimit të Kontratës.
- x) Të silltet në publik dhe në jetën private në mënyrë të tillë që të mos dëmtojë imazhin e Klubit, të FSHF-së dhe sportit të futbollit në përgjithësi.
- xi) Të mos bëjë asnjë koment me palë të treta mbi çështje që i përkasin Klubit. Lojtaria është e detyruar të ruajë konfidencialitetin e informacioneve që ka marrë dijeni gjatë veprimtarisë së saj pranë Klubit. Përcaktimi i informacionit konfidencial parashikohet në rregulloret dhe aktet e tjera të Klubit.
- xii) Të kërkojë miratimin me shkrim të presidentit në rast se dëshiron të transferohet pranë ndonjë ekipi (klubi) tjetër, si dhe të paguajë të gjitha detyrimet financiare, të cilat do t'i kërkohen nga klubi, si tarifën e kompensimit dhe detyrimet e tjera nëse përcaktohen në kontratë.

#### **IV) Mirëmbajtja dhe Përmirësimi i Gjendjes Fizike të Lojtares**

- i) Lojtarja merr përsipër të shfrytëzojë të gjithë talentin dhe gjendjen e saj fizike në të mirë të Klubit, të bëjë të gjitha përpjekjet për të mirëmbajtur dhe për të përmirësuar nivelin e gjendjes së tij fizike, mendore, dhe psikike. Në përgjithësi Lojtarja duhet të tregojë kujdes për të mos ndërmarrë asnjë veprim që mund të ulë efektivitetin e tij profesional.
- ii) Lojtarja duhet të mirëmbajë treguesit dhe parametrat e gjendjes fizike individuale në normat optimale të vlerësuara e të përcaktuara nga Klubi. Lojtarja njoftohet rast pas rasti për kërkesat e Klubit në lidhje me normat e parametrave dhe treguesve të gjendjes fizike që ai duhet të përmbushë.
- iii) Gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, Lojtarja heq dorë nga:
  - a) ushtrimi i ndonjë sporti ose aktiviteti, edhe gjatë periudhës së pushimeve, që mund të përbëjë rrezik për dëmtime fizike. Në veçanti ndalohet ushtrimi i sporteve të patinazhit, skive, snowboard, hedhjes me parashutë, kalërimit, motoçiklizmit;
  - b) ushtrimi i ndonjë sporti tjetër pa miratimin paraprak me shkrim prej Klubit.

#### **V) Përdorimi i Të Drejtave Personale të Lojtares**

- i) Lojtarja e autorizon Klubin të përdorë të drejtat e tij personale dhe t'i shfrytëzojë në mënyrë individuale apo kolektive. Të drejtat përfshijnë por nuk kufizohen në:
  - a) përdorimin e veshjeve dhe materialeve të tjera sportive sipas udhëzimeve të Klubit;
  - b) shpërndarjen e fotografive të Lojtares nëpërmjet medias ekzistuese ose të ardhme;
  - c) të drejtat mbi firmat, autografet dhe firmat e zakonshme sipas përcaktimeve të Klubit;
  - d) reklamat e ndryshme si dhe çdo lloj marketingu personal apo në kuadrin e grupit (për reklamimin e produkteve, personave e shërbimeve të ndryshme);
  - e) aktivitete dhe të tjera nëpërmjet të cilave Klubi mund të shfrytëzojë emrin dhe imazhin e lojtares.

## **VI) Kujdesi Shëndetësor**

- i) Klubi është i detyruar të kryejë me shpenzimet e veta sigurimin shëndetësor të lojtarit.
- ii) Përpara fillimit të çdo sezoni futbollistik Lojtarja është e detyruar të kryejë analizat shëndetësore për të verifikuar aftësinë e saj për të ushtruar sportin e futbollit dhe për të përmbushur veprimtarinë sportive pranë Klubit.
- iii) Lojtarja merr përsipër të zbatojë të gjitha udhëzimet mjekësore të diktuar nga mjekët e autorizuar nga Klubi, me qëllim mirëmbajtjen dhe përmirësimin e formës sportive në përputhje me përcaktimet në nenin IV (Mirëmbajtja dhe Përmirësimi i Gjendjes Fizike të Lojtarit), të kësaj marrëveshje.

## **VII) Detyrimet e Lojtares në Raste të Sëmundjeve dhe Aksidenteve**

- i) Nëse Lojtarja e ka të pamundur të marrë pjesë në veprimtaritë e Klubit, për shkak të pësimit të ndonjë sëmundje apo aksidenti, Lojtarja është e detyruar të njoftojë menjëherë Trajnerin e ekipit të parë të Klubit, dhe personelin administrativ të Klubit.
- ii) Lojtarja është e detyruar të paraqesë pranë administratës së Klubit të gjithë dokumentacionin mjekësor në lidhje me vlerësimin shëndetësor të kryer në rastin e pësimit të sëmundjes apo aksidentit përkatës, jo më vonë se dy (2) ditë nga pësimi i sëmundjes apo aksidentit.
- iii) Në rast se lojtarja do të bëhet e paaftë për të luajtur për arsye të një dëmtimi apo sëmundjeje (përfshirë sëmundjet ose çrregullimet mendore) Klubi duhet të paguajë lojtaren gjatë periudhës së paaftësisë ose kohëzgjatjes së kontratës (atë që është më e shkurtër) shumë e mëposhtme të shpërblimit për periudhat si më poshtë:
  - a) në rast dëmtimi të lojtares gjatë ndeshjeve, lojtarja do të marrë pagën bazë deri në fund të 7 (shtatë) muajve të parë të kohëzgjatjes së kontratës.

## **VIII) Sekret i Mjekësor**

- i) Lojtarja çliron nga përgjegjësia e konfidencialitetit shëndetësor, të gjithë mjekët dhe Klubin, në lidhje me informacionet e saj shëndetësore vetjake që janë thelbësore për ushtrimin e veprimtarisë sportive pranë Klubit.

## **IX) Detyrimet e Klubit**

- i) **Shpërblimi i Lojtares** – Për shërbimet e kryera ndaj Klubit, Lojtarja do të përfitojë pagën siç përcaktohen në Shtojcën 1 – Shpërblimi i Lojtares, bashkëngjitur kësaj Kontrate.
- ii) Klubi mund të zbresë nga shpërblimi i pagueshëm i Lojtares:
  - a) gjobat e vendosura ndaj Lojtares, sipas parashikimeve të kësaj Kontrate;
  - b) të gjitha shumat që Klubi ka paguar në favor të Lojtares me pëlqimin paraprak të këtij të fundit;
  - c) çdo shumë tjetër të cilat duhet të jenë të përcaktuara qartë se Lojtarja ia detyron Klubit;
  - d) shumat për zhdëmtimin e dëmeve të shkaktuara nga Lojtarja në dëm të pasurisë së Klubit, përfshirë këtu edhe dëmtimin e imazhit dhe/ose emrit të mirë të Klubit.
- iii) Gjatë kohëzgjatjes së kontratës, Klubi do të vërë në shërbim të Lojtares:
  - a) personel të kualifikuar për ndeshje dhe stërvitje;
  - b) vende të përshtatshme për lojë dhe stërvitje, si dhe infrastrukturën tjetër të nevojshme në përputhje me udhëzimet e FSHF-së;
  - c) kujdes mjekësor dhe terapeutik me karakter sportiv;
  - d) veshje sportive (përveç sigurimit të këpucëve të lojës);
  - e) programin stërvitor (përfshirë ndryshimet e mundshme);
- iv) Klubi pranon se nuk mund të bëjë politikë diskriminimi ndaj Lojtares.
- v) Klubi, në përputhje me rregullat e FIFA-s, pranon të lejojë Lojtaren kur ajo thirret në Ekipin Kombëtar.

## **X) Masat Disiplinore dhe Sanksionet**

- i) Në qoftë se Lojtarja shkel ndonjë nga detyrimet e tij të përcaktuara në këtë Kontratë, ose nuk përmbush objektivat e vendosura rast pas rasti nga Klubi, Klubi mund të aplikojë penaltetet e mëposhtme, krahas të gjitha gjobave dhe sanksioneve të parashikuara në rregulloret e Klubit.
  - a) Qortim.
  - b) Gjobë

- c) Përjashtim të përkohshëm nga ndeshjet zyrtare.
- d) Përjashtim të përkohshëm nga stërvitjet apo veprimtaritë e tjera të organizuara apo zhvilluara nga Klubi.
- e) Përjashtim nga Klubi.

**XI) Dopingu dhe Substancat e Ndaluar**

- i) Dopingu është përdorimi i substancave të përfshira në listën e substancave të ndaluara dhe përdorimi i metodave të ndaluara në listën e FSHF-së, UEFA-s, dhe FIFA-s.
- ii) Dopingu ose përdorimi i substancave të ndaluara është rreptësisht i ndaluar. Lojtarja që merr substanca të ndaluara ose inkurajon dopingun në çdo lloj mënyre, i nënshtrohet vendimit të Komisionit të Kontrollit dhe Disiplinës të FSHF-së ose organizatave ndërkombëtare, si të jetë rasti.
- iii) Konsumimi i alkoolit dhe duhanit është rreptësisht i ndaluar, dhe për këtë arsye Lojtarja do të jetë në kontrollin e vazhdueshëm të Klubit.
- iv) Lojtarja është e detyruar të lejojë Klubin dhe personelin e Klubit të kryejë ekzaminime sa herë që kërkohet prej Klubit.

**XII) Transferimi i Lojtares**

- i) Klubi ka të drejtë të transferojë të drejtën e federimit të Lojtares, tek një klub tjetër, brenda ose jashtë vendit, në përputhje me interesat e veta, duke respektuar të drejtat e Lojtares, të parashikuara në rregulloret e FSHF-së, UEFA-s, dhe FIFA-s.

**XIII) Përfundimi i Kontratës nga ana e Klubit**

- i) Klubi do të konsiderohet se e zgjidh kontratën me Lojtaren me shkak të ligjshëm duke njoftuar lojtaren me shkrim 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara, në rast se lojtarja:
  - a) gjendet fajtor për një shkelje të rëndë të ligjit;
  - b) nuk do të marrë parasysh çdo paralajmërim me shkrim të dhënë nga ana e Klubit;
  - c) është dënuar për një vepër penale për të cilën, dënimi konsiston në burgimin për të paktën një muaj ose më shumë.
- ii) Në rast se Klubi përfundon kontratën me lojtaren sipas paragrafit (i), këtu më sipër në këtë nen, Klubi duhet që brenda 7 (shtatë) ditëve pas kësaj të njoftojë Lojtaren me shkrim për të gjitha arsyet

e vendimit të marrë për zgjidhjen e kontratës.

- iii) Pagesa e lojtares gjatë periudhës së njoftimit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh do të kryhet menjëherë.

#### **XIV) Përfundimi i Kontratës nga ana e Lojtares**

- i) Lojtarja do të konsiderohet se e zgjidh kontratën me Klubin me shkak të ligjshëm duke njoftuar Klubin me shkrim 30 (tridhjetë) ditë përpara, në rast se Klubi:
  - a) do të gjendet fajtores për shkelje serioze dhe të vazhdueshme të kushteve dhe rrethanave të kësaj kontrate; ose
  - b) dështon në pagimin e ndonjë shpërblimi, ose pagesa të tjera, ose bonuse që i detyrohen Lojtares, sipas kësaj kontrate, për më shumë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga afati kur duheshin përmbushur detyrimet përkatëse.
- ii) Nëse klubi përmbush detyrimet e veta brenda periudhës së njoftimit prej 30 (tridhjetë) ditësh sipas paragrafit (i), këtu më sipër në këtë nen, atëherë Lojtarja nuk mund të zgjidhë këtë kontratë në mënyrë të njëanshme për shkak të ligjshëm.

#### **XV) Përfundimi i Kontratës**

- i) Kjo Kontratë përfundon në afatin e përcaktuar këtu më sipër (II/i – Kohëzgjatja e Kontratës).
- ii) Kjo Kontratë mund të përfundojë përpara afatit të përcaktuar këtu më sipër, me marrëveshje të shkruar midis Palëve.
- iii) Me përfundimin e Kontratës, Lojtarja është e detyruar të shlyejë të gjitha detyrimet që ka ndaj Klubit. Së bashku me detyrimet financiare do të paguhet dhe interesat përkatëse.
- iv) Me përfundimin e Kontratës, në çdo rast, Lojtarja detyrohet t'i kthejë Klubit çdo pronë (përfshirë edhe mjetet personale të dhëna në përdorim), si dhe të gjithë bazën materiale të dhënë në përdorim nga Klubi.

Vendi dhe Data

Vendi dhe Data



Nënshkrimi i Lojtares, dhe

Nënshkrimi i Klubit

nëse është e nevojshme,  
Nënshkrimi i Përfaqësuesit të saj.  
(Agjenti i Lojtares, Avokati, etj.)

Nënshkrimi i Agjentit (nëse ka)

Nënshkrimi i Përfaqësuesit Ligjor  
(për Lojtaret nën moshën 18 vjeç)

## SHTOJCA III Formularët

### Formulari 101

#### Lista e Zyrtarëve të Autorizuar për të Nënshkruar në Emër të Klubit të Futbollit

#### Lista e Zyrtarëve të Autorizuar për të Nënshkruar në Emër të Klubit të Futbollit

*klubi i futbollit*

*Drejtuar:* **Sekretarit të Përgjithshëm  
Federata Shqiptare e Futbollit**

Zyrtarët si më poshtë janë të autorizuar të nënshkruajnë dokumentacionin zyrtar, formularët, dhe çdo korrespondencë tjetër drejtuar Federatës Shqiptare të Futbollit, në emër të klubit si më sipër.

*Emri, Mbiemri*

*Pozicioni i punës*

*Nënshkrimi*

*Kufizimi i Autorizimit  
(nëse ka)*

*nënshkrimi i klubit*

*vendi dhe data*

## Formulari 102 Marrëveshja e Transferimit

### Marrëveshja e Transferimit

#### Palët

- Klubi që transferon të drejtën e federimit.
- Klubi që përfiton të drejtën e federimit.

#### Lojtari

Emri i lojtarit që i transferohet e drejta e federimit nga klubi që e transferon (pala 1.) tek klubi që e përfiton të drejtën e federimit (pala 2.).

#### Tarifa e kompensimit

Shuma gjithsej e pagueshme ndaj klubit që e transferon të drejtën e federimit (pala 1.), nga klubi që e përfiton të drejtën e federimit (pala 2.) është:

*shuma në shifra (ALL)*

*shuma në fjalë (ALL)*

Tarifa e kompensimit do të paguhet në përputhje me kushtet në vijim:

**Afati**

**Shuma**

<input type="text"/>	<input type="text"/>
<input type="text"/>	<input type="text"/>
<input type="text"/>	<input type="text"/>

#### Kushte të tjera

#### Agjentët

- Agjenti i Lojtarit:
- Agjenti i klubit që transferon të drejtën e federimit:
- Agjenti i klubit që përfiton të drejtën e federimit:

Nënshkrimi i autorizuar i klubit që transferon të drejtën e federimit

Nënshkrimi i autorizuar i klubit që përfiton të drejtën e federimit

Pozicioni

Pozicioni

Data, dhe vendi

Data, dhe vendi

## Formulari 103

### Marrëveshja e Transferimit të Përkohshëm (huazimi)

#### Marrëveshja e Transferimit të Përkohshëm (huazimi)

##### Palët

- Klubi që transferon përkohësisht të drejtën e federimit.
- Klubi që përfiton përkohësisht të drejtën e federimit.

##### Lojtari

Emri i lojtarit që i transferohet e drejta e federimit nga klubi që e transferon (pala 1.) tek klubi që e përfiton të drejtën e federimit (pala 2.).

##### Kohëzgjatja e transferimit të përkohshëm (huazimit)

data e fillimit

data e përfundimit

##### Tarifa e kompensimit

Shuma gjithsej e pagueshme ndaj klubit që e transferon të drejtën e federimit (pala 1.), nga klubi që e përfiton të drejtën e federimit (pala 2.) është:

shuma në shifra (ALL)

shuma në fjalë (ALL)

##### Kushte të tjera

##### Agjentët

- Agjenti i Lojtarit:
- Agjenti i klubit që transferon të drejtën e federimit:
- Agjenti i klubit që përfiton të drejtën e federimit:

Nënshkrimi i autorizuar i klubit që transferon përkohësisht të drejtën e federimit

Nënshkrimi i autorizuar i klubit që përfiton përkohësisht të drejtën e federimit

Pozicioni

Pozicioni

Data, dhe vendi

Data, dhe vendi

## Formulari 104

### Shpërblimet e Lojtares

### Shpërblimet e Lojtares

klubi i futbollit

Drejtuar: Sekretarit të Përgjithshëm  
Federata Shqiptare e Futbollit

#### Lojtari

#### Shpërblimet e lojtarit

Gjatë sezonit futbollistik të përfshirë në periudhën si më poshtë, lojtari i sipër shënuar ka përfituar shpërblimet në vijim:

<input type="text"/>	<input type="text"/>	Shumat
<i>data e fillimit</i>	<i>data e përfundimit</i>	
	të ardhura nga shpërblimi mujor	<b>A</b>
	të ardhura nga këstet kontraktuale	<b>B</b>
	të ardhura nga bonuset/premiot	<b>C</b>
	të ardhura të tjera	<b>D</b>
	taksa dhe tatime	<b>E</b>
	ndalesa disiplinore	<b>F</b>
	shuma gjithsej e arkëtuar nga lojtari (A + B + C + D - E - F)	<b>G</b>

#### Përfitime të tjera të lojtarit

përshkrim në fjalë

nënshkrimi i klubit

vendi dhe data

## Formulari 105

### Njoftimi i Numrave të Uniformave

#### Njoftimi i Numrave të Uniformave

*klubi i futbollit*

**Drejtuar:** Sekretarit të Përgjithshëm  
Federata Shqiptare e Futbollit

#### ***Numrat e fanellave***

Numrat e fanellave të lojtarëve të ekipit të parë të klubit tonë janë shpërndarë si më poshtë:

<b>Nr.</b>	<b>Fanella</b>	<b>Emër, Mbiemër</b>	<b>Nr.</b>	<b>Fanella</b>	<b>Emër, Mbiemër</b>
1			17		
2			18		
3			19		
4			20		
5			21		
6			22		
7			23		
8			24		
9			25		
10			26		
11			27		
12			28		
13			29		
14			30		
15			31		
16			32		

*nënshkrimi i klubit*

*vendi dhe data*

## Formulari 106

### Regjistrimi i Uniformave Zyrtare

---

#### Regjistrimi i Uniformave Zyrtare

*klubi i futbollit*

**Drejtuar:** Sekretarit të Përgjithshëm  
Federata Shqiptare e Futbollit

#### **Regjistrimi i fanellave**

Bashkëngjitur po ju paraqesim fanellat zyrtare (përfshirë fanellën rezervë, dhe fanellat e portierëve) me të cilat do të përfaqësohet ekipi ynë i parë në ndeshjet zyrtare për sezonin futbollistik:

Më poshtë paraqitet përshkrimi për secilën nga fanellat:

#### **Fanella Zyrtare**

Bluza:	<input type="text"/>
Mbathjet:	<input type="text"/>
Çorapet:	<input type="text"/>
Portieri:	<input type="text"/>

#### **Fanella Rezervë**

Bluza:	<input type="text"/>
Mbathjet:	<input type="text"/>
Çorapet:	<input type="text"/>
Portieri:	<input type="text"/>

#### **Fanella e Tretë (fakultative)**

Bluza:	<input type="text"/>
Mbathjet:	<input type="text"/>
Çorapet:	<input type="text"/>
Portieri:	<input type="text"/>

---

*nënshkrimi i klubit*

---

*vendi dhe data*

## Formulari 107

### Njoftimi i Uniformës Zyrtare, Klubit Vendas

---

#### Njoftimi i Uniformës Zyrtare, Klubit Vendas

*klubi i futbollit mik*

**Drejtuar:**

*klubit të futbollit vendas*

#### **Njoftimi i fanellës**

Më poshtë paraqitet përshkrimi i fanellës zyrtare që ekipi ynë do të mbajë gjatë ndeshjes që do të zhvillojmë kundër jush më datë:

#### **Lojtarët**

Bluza:

Mbathjet:

Çorapet:

#### **Portieri**

Bluza:

Mbathjet:

Çorapet:

---

*nënshkrimi i klubit*

---

*vendi dhe data*



## Formulari 108

### Regjistrimi i Përmasave të Fushës së Lojës

---

#### Regjistrimi i Përmasave të Fushës së Lojës

*klubi i futbollit*

**Drejtuar: Sekretarit të Përgjithshëm  
Federata Shqiptare e Futbollit**

#### ***Përmasat e Fushës së Lojës***

Përmasat e fushës së lojës në stadiumin si më poshtë, për sezonin futbollistik:

*sezoni futbollistik*

*emërtimi i stadiumit, adresa*

Janë si më poshtë:

**Gjatësia:**  *metra*

**Gjerësia:**  *metra*

---

*nënshkrimi i klubit*

---

*vendi dhe data*

- Formulari 109** - Raporti i Deleгатit të Ndeshjes
- Formulari 110** - Formulari i Ekipit
- Formulari 111** - Deklarimi i Biletave
- Formulari 112** - Raporti i Arbitrit të Ndeshjes
- Formulari 113** - Raporti i Zyrtarit të Ndeshjes
- Formulari 114** - Deklarimi i Llogarisë Bankare të Klubit
- Formulari 115** - Deklarimi i Koordinatorit të të Dhënave Personale
- Formulari 116** - Deklarimi i të Dhënave Personale



# KAMPIONATI I FEMRAVE SEZONI 2017-2018

## FAZA E PARË

<b>Java 1</b>	<b>30.09.2017</b>
Teuta	- Vllaznia
Juban Danja	- AAS
Pogradeci	- Apolonia
Dajti	- Bilisht Sport
Kinostudio	- Tirana AS

<b>Java 4</b>	<b>04.11.2017</b>
Teuta	- Vllaznia
Juban Danja	- AAS
Pogradeci	- Apolonia
Dajti	- Bilisht Sport
Kinostudio	- Tirana AS

<b>Java 2</b>	<b>07.10.2017</b>
Vllaznia	- Kinostudio
Apolonia	- Teuta
AAS	- Pogradeci
Skenderbeu	- Dajti
Bilisht Sp.	- Juban Danja

<b>Java 5</b>	<b>11.11.2017</b>
Vllaznia	- Kinostudio
Apolonia	- Teuta
AAS	- Pogradeci
Skenderbeu	- Dajti
Bilisht Sp.	- Juban Danja

<b>Java 3</b>	<b>14.10.2017</b>
Pogradeci	- Bilisht Sport
Teuta	- AAS
Juban D.	- Skenderbeu
Kinostudio	- Apolonia
Tirana AS	- Vllaznia

<b>Java 6</b>	<b>18.11.2017</b>
Pogradeci	- Bilisht Sport
Teuta	- AAS
Juban D.	- Skenderbeu
Kinostudio	- Apolonia
Tirana AS	- Vllaznia

<b>Java 7</b>	<b>25.11.2017</b>
Teuta	- Juban Danja
Kinostudio	- Dajti
Tirana AS	- Skenderbeu
Vllaznia	- Bilisht Sport
Apolonia	- AAS

<b>Java 9</b>	<b>09.12.2017</b>
Kinostudio	- Pogradeci
Tirana AS	- Juban Danja
Vllaznia	- Dajti
Apolonia	- Skenderbeu
AAS	- Bilisht Sport

<b>Java 8</b>	<b>02.12.2017</b>
Skenderbeu	- Vllaznia
Dajti	- Tirana AS
Juban Danja	- Kinostudio
Pogradeci	- Teuta
Bilisht Sport	- Apolonia

<b>Java 10</b>	<b>16.12.2017</b>
Skenderbeu	- AAS
Dajti	- Apolonia
Juban Danja	- Vllaznia
Pogradeci	- Tirana AS
Teuta	- Kinostudio

<b>Java 11</b>	<b>23.12.2017</b>
Tirana AS	- Teuta
Vllaznia	- Pogradeci
Apolonia	- Juban Danja
AAS	- Dajti
Bilisht Sp.	- Skenderbeu

### KLASIFIKIMI

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_
4. \_\_\_\_\_
5. \_\_\_\_\_
6. \_\_\_\_\_

7. \_\_\_\_\_
8. \_\_\_\_\_
9. \_\_\_\_\_
10. \_\_\_\_\_
11. \_\_\_\_\_



# KAMPIONATI I FEMRAVE SEZONI 2017-2018

## FAZA E DYTË

<b>Java 12</b>	<b>2018</b>
Bilisht Sport	- Dajti
AAS	- Juban Danja
Apolonia	- Pogradeci
Vllaznia	- Teuta
Tirana AS	- Kinostudio

<b>Java 15</b>	<b>2018</b>
Pogradeci	- Skenderbeu
Juban Danja	- Dajti
Tirana AS	- Apolonia
Kinostudio	- AAS
Teuta	- Bilisht Sport

<b>Java 13</b>	<b>2018</b>
Dajti	- Skenderbeu
Kinostudio	- Vllaznia
Teuta	- Apolonia
Pogradeci	- AAS
Juban Danja	- Bilisht Sp.

<b>Java 16</b>	<b>2018</b>
Dajti	- Pogradeci
Skenderbeu	- Teuta
Bilisht Sport	- Kinostudio
AAS	- Tirana AS
Apolonia	- Vllaznia

<b>Java 14</b>	<b>2018</b>
Skenderbeu	- Juban D.
Bilisht Sport	- Pogradeci
AAS	- Teuta
Apolonia	- Kinostudio
Vllaznia	- Tirana AS

<b>Java 17</b>	<b>2018</b>
Kinostudio	- Skenderbeu
Teuta	- Dajti
Pogradeci	- Juban Danja
Vllaznia	- AAS
Tirana AS	- Bilisht Sport

<b>Java 18</b>	<b>2018</b>
Juban Danja	- Teuta
Dajti	- Kinostudio
Skenderbeu	- Tirana AS
Bilisht Sport	- Vllaznia
AAS	- Apolonia

<b>Java 21</b>	<b>2018</b>
AAS	- Skenderbeu
Apolonia	- Dajti
Vllaznia	- Juban Danja
Tirana AS	- Pogradeci
Kinostudio	- Teuta

<b>Java 19</b>	<b>2018</b>
Vllaznia	- Skenderbeu
Tirana AS	- Dajti
Kinostudio	- Juban D.
Teuta	- Pogradeci
Apolonia	- Bilisht Sport

<b>Java 22</b>	<b>2018</b>
Teuta	- Tirana AS
Pogradeci	- Vllaznia
Juban Danja	- Apolonia
Dajti	- AAS
Skenderbeu	- Bilisht Sp.

<b>Java 20</b>	<b>2018</b>
Pogradeci	- Kinostudio
Juban Danja	- Tirana AS
Dajti	- Vllaznia
Skenderbeu	- Apolonia
Bilisht Sport	- AAS

### KLASIFIKIMI

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_
4. \_\_\_\_\_
5. \_\_\_\_\_
6. \_\_\_\_\_
7. \_\_\_\_\_
8. \_\_\_\_\_
9. \_\_\_\_\_
10. \_\_\_\_\_
11. \_\_\_\_\_

## SHTOJCA V Ekzaminimet mjeksore ndaj Lojtareve

A) HISTORIKU PERSONAL FUTBOLLISTIK		
1.	Numri gjithsej i ndeshjeve të luajtura gjatë sezonit futbollistik të mëparshëm	Vjetore (të rekomanduara)
2.	Këmba që përdor më mirë	
3.	Pozicioni në fushë	
B) HISTORIKU DHE TRASHËGIMIA MJEKËSORE E LOJTARIT		
1.	<p>Historiku i familjes (gjenerata e parë, si prindërit, vëllezërit dhe motrat)</p> <p>a) Hipertensioni;  b) Gjendja e zembrës;  c) Probleme kardiovaskulare të enëve të gjakut;  d) Diabeti;  e) Alergjitë, asma;  f) Kancerët, sëmundje të gjakut;  g) Probleme muskulare dhe të kyçeve kronike;  h) Probleme hormonale.</p>	Vjetore (të detyrueshme)
2.	<p>Historiku mjekësor i lojtarit</p> <p>i) Problemet e zembrës, aritmitë;  j) Alergjitë, asma;  k) Infeksionet e përsëritura;  l) Sëmundjet kryesore;  m) Dëmtimet kryesore të cilat shkaktojnë shtrimin në spital, ose pengojnë lojtarin të luajë për më shumë se 1 (një) muaj.</p>	Vjetore (të detyrueshme)
3.	<p>Shqetësimet dhe problemet aktuale</p> <p>n) Simptoma të dhimbjeve në përgjithësi (muskulare, artikulationet);  o) Dhimbje gjoksi, aritmitë;  p) Simptoma të gripit, kollë;  q) Rënie në peshë, humbje e oreksit;  r) Pagjumësi;  s) Probleme ose shqetësime gastrointestinal.</p>	Vjetore (të detyrueshme)

<b>4.</b>	<b>Trajtimi mjekësor</b> a) Diagnoza dhe trajtimi mjekësor aktual që po i nënshtrohet lojtari; b) Lista e ilaçeve dhe mjekimeve që po merr lojtari; c) Suplemente ushqimore që po merr lojtari; d) Edukimi i lojtarit në lidhje me Kodet Anti-Doping.	<b>Vjetore (të detyrueshme)</b>
<b>5.</b>	<b>Vaksinimi</b> e) Të dhënat në lidhje me vaksinimin aktual të lojtarit; f) Vaksinimi kundër tetanosit, dhe hepatitit A dhe B.	<b>Vjetore (të detyrueshme)</b>
<b>C) EKZAMINIMI MJEKËSOR I PËRGJITHSHËM I LOJTARIT</b>		
<b>1.</b>	<b>Gjatësia</b>	<b>Vjetore (të detyrueshme)</b>
<b>2.</b>	<b>Pesha</b>	
<b>3.</b>	<b>Tensioni i gjakut</b>	
<b>4.</b>	<b>Koka dhe qafa (sytë, hunda, veshët, dhëmbët, gryka, dhe gjendrat tiroide)</b>	
<b>5.</b>	<b>Gjendrat limfatike</b>	
<b>6.</b>	<b>Gjoksi dhe mushkëritë (kontroll me stetoskop, elasticiteti i toraksit)</b>	
<b>7.</b>	<b>Zemra (zhurmat, puls, aritmitë)</b>	
<b>8.</b>	<b>Abdominali</b>	
<b>9.</b>	<b>Enët e gjakut (puls periferik, zhurmat kardiovaskulare)</b>	
<b>10.</b>	<b>Inspektim i lëkurës</b>	
<b>11.</b>	<b>Sistemi nervor (reflekset, problem ndjesore)</b>	
<b>12.</b>	<b>Sistemi muskular (dobësitë, atrofia)</b>	
<b>D) EKZAMINIME TË VEÇANTA KARDIOVASKULARE</b>		
<b>1.</b>	<b>Elektrokardiogram (ECG 12-elektroda)</b>	<b>Vjetore (të detyrueshme)</b>
<b>2.</b>	<b>Ekokardiografi</b>	
<b>E) EKZAMINIMET LABORATORIKE</b>		
<b>1.</b>	<b>Gjaku komplet (hemoglobina, hematokrit, eritrocitet, leukocitet, trombocitet)</b>	<b>Vjetore (të detyrueshme)</b>
<b>2.</b>	<b>Analiza e urinës (niveli i sheqernave, dhe proteinave)</b>	



<b>F)</b>	<b>EKZAMINIMET ORTOPEDIKE DHE FUNKSIONALE</b>	
1.	Shtylla kurrizore: inspektim dhe ekzaminime funksionale (ndjeshmëria, dhimbjet, lëvizshmëria)	Vjetore (të detyrueshme)
2.	Shpatullat (dhimbjet, lëvizshmëria, dhe qëndrueshmëria)	
3.	Legeni, ijet, kofshët (dhimbjet, lëvizshmëria)	
4.	Gjunjët (dhimbjet, lëvizshmëria, qëndrueshmëria)	
5.	Këmba e poshtme (dhimbjet, tendina e akilit)	
6.	Thembra dhe shputa e këmbës (dhimbjet, lëvizshmëria, dhe qëndrueshmëria)	
7.	Elasticiteti dhe testet e fortësisë së muskujve	Vjetore (të rekomanduara)
8.	Fuqia muskulare	
9.	Testi i balancimit të muskujve (testi SOLEC)	
<b>G)</b>	<b>EKZAMINIMET RADIOLOGJIKE DHE ME ULTRATINGUJ</b>	
	Nëse nevojitet nga ekzaminimet mjekësore mund të kryhen ekzaminime radiologjike ose me ultratinguj. Në çdo rast radigrafitë e kryera duhet të mirëmbahen në dosjen mjekësore të lojtarit.	